



Nxënësit  
shqiptarë  
humbën  
mundësinë e parë



Simbolet  
e Xhakës  
dhe Shaqirit  
**Mundësia  
e dënimit**



# Koha

www.koha.mk



**KOHA për  
sport**

**EDITORIAL**

**Borxhi i maqedonasve ndaj shqiptarëve**



Shteti si projekt ku të gjithë duhet të investojnë dijet dhe mundësitë për një të ardhme më të mire, duhet të jetë preokupim parësor, sepse shteti mund ta ketë edhe emrin e babes tënd dhe asgjë të mos hyj në punë nëse vazhdon të vegjetosh pa ide e projekte që do ta bënin arsimin, ekonominë, bujqësinë, kulturën shumë më ndryshe se ç'janë tani.

**KULTURË**

**Zbardhja e një periudhe të errët për shqiptarët**

**GLOBI**

**Shpërthim në Gjermani, 25 të lënduar**

25 persona janë lënduar, katër nga ta rëndë, pas një shpërthimi që ka shkatërruar një bllok të apartamenteve në qytetin Wuppertal të Gjermanisë. Shpërthimi ka ndodhur pak pas mesnatës së kaluar, përderisa shkaktari mbetet ende i paqartë.



## SHIFAT E SHËRBIMEVE PUBLIKE

# QYTETARËT TË PAKËNAQUR



**Anketa rajonale për shërbimet publike, po ashtu ka arritur të zbulon se vetëm një e treta e qytetarëve të Ballkanit Perëndimorë, gjatë dy viteve të kaluar ka hasur në mirëkuptimin në administratën e tyre shtetërore, të cilat i kanë pranuar vërejtjet dhe rekomandimet e tyre gjatë kohës së shfrytëzimit të shërbimeve administrative**

## Shekerinska iu shkruan kolegëve në NATO

Pas arritjes së marrëveshjes me Greqinë, ministrja e Mbrojtjes, Radmilla Shekerinska u dërgoi letër ministrave të mbrojtjes të 29 vendeve anëtare të NATO-s, në të cilën prej tyre kërkon mbështetje që Maqedonia në Samitin e Aleancës në korrik të marrë ftesë për anëtarësim në NATO. Siç kumtoi Minsitria e Mbrojtjes, me disa prej tyre Shekerinska ka pasur edhe biseda telefonike në të cilat i janë transmetuar urime për marrëveshjen e arritur dhe është shprehur

mbështetje për anëtarësim të Maqedonisë në NATO. Në letrën drejtuar kolegëve të vet në Aleancë, Shekerinska thekson: "Ju shkruaj pas arritjes së marrëveshjes historike rreth kontestit për emrin me Greqinë. Kjo pengesë për integrimin tonë euroatlantik është mënjanuar. E kërkoj mbështetjen tuaj që Maqedonia të marrë ftesë për anëtarësim të barabartë në NATO në Samitin e ardhshëm. Nevojitet trimëri, leadership dhe diplomaci që të arrihet ky qëllim – nga të



dyja palët. Populli ynë është i bashkuar dhe pa hamendje në dëshirën për t'u bërë pjesë e NATO-s

dhe BE-së, me mbështetje konskuate nga mbi 75 për qind të qytetarëve tanë".



## EDITORIAL

BORXHI I MAQEDONASVE  
NDAJ SHQIPTARËVE

Emin AZEMI

**Shteti si projekt ku të gjithë duhet të investojnë dijet dhe mundësitë për një të ardhme më të mire, duhet të jetë preokupim parësor, sepse shteti mund ta ketë edhe emrin e babes tënd dhe asgjë të mos hyj në punë nëse vazhdon të vegjetosh pa ide e projekte që do ta bënin arsimin, ekonominë, bujqësinë, kulturën shumë më ndryshe se ç'janë tani.**

Të vërtetat për Maqedoninë nuk i ka shkrua një dorë e vetme. Autorë, diplomatë e gjeografë të ndryshëm, sa here që kanë vizituar këtë pjesë të Europës Juglindore, shpesh janë ndalur edhe në atë që dikur quhej Maqedonia otomane, pastaj Srpska Banovina, Maqedonia e Titos, e deri te Maqedonia e pavarur, pas viteve 90-të, dhe janë munduar të gjejnë shprehje sa më adekuate për ta përshkruar atë si një "parking i gabuar", në të cilin lakmitarë të hapur e të fshehur kanë vizituar ambicjet e tyre në hartën e pretendimeve e synimeve territorial. Dora e zgjatur e ideologut dhe patriotit Hasan Prishtina drejtuar disa përfaqësuesve të lëvizjes revolucionare maqedonase në fillimet e shekullit të kaluar, për një veprim të bashkërenduar në favor të zgjidhjes së çështjeve të hapura nacionale të shqiptarëve dhe maqedonasve, ngeli si një mision i papërfunduar për shkak të ndikimeve shoviniste ballkanike në politikën e vetëvendosjes së popujve. Vetëdija politike e nacionale e maqedonasve atëbotë kishte një prirje vasaliteti kundrejt ideologjive bullgare dhe ende nuk ishte krijuar bazamenti i mjaftueshëm për vendimmarrje autonome. Ky qe edhe shkaku pse maqedonasit nuk arritën të krijojnë ngrehinën e tyre shtetformuese dhe kjo u bë vetëm pas Luftës së Dytë Botërore me ndihmën e Titos. "Maqedonia e Titos" ishte në fakt lindja e një kombi që do të merrte më vonë atributet nacionale të formimit kulturor, gjuhësor e etno-psikologjik. Partizanët maqedonas kishin qenë pjesë e pandarë e ekspeditave ndëshkuese në viset shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe shumë prej tyre komandat e pushkatimit i shoqëronin me zellin e pakursyer të lojalitetit dhe vardisjes së gërditshme kundrejt Beogradit dhe politikës antishqiptare të Serbisë. Në çizmet e një lojaliteti të tillë ishin futur edhe dhjetat police maqedonas në fillim të viteve tetëdhjetë, teksa po merrnin pjesë, bashkë me serbët, në "shuarjen e kundërrivolucionit" në Kosovë, në kuadër të të ashtuquajturës "aradhë federative e përbashkët policore", ku kërbaci dhe kondaku i maqedonasve në Ferizaj, Prishtinë, Podujeve e gjetiu po shtypte pamëshirshëm në protesta e demonstrata fytyrat njoma të studentëve dhe rinisë kosovare

Shqiptarët asnjëherë nuk u kuptuar drejt nga maqedonasit. As atëherë nga Hasan Prishtina, kur kishte gjasa për një koalicion shqiptaro-maqedonas, as tani në Prespë, ku statusi i shqiptarëve shkruhet me formulime apodiktike, maqedonasit sërish mendojnë se shqiptari i lirë dhe i barabartë është kanosje për qenien e tyre. Ende nëpër protesta dominon fryma pezhorative për shqiptarët dhe kjo nuk ka mundur të krijohet brenda natës. Urrejtja ndaj shqiptarëve, përpos që është e pakuptimtë, është edhe mjerane në zanafillën saj psikologjike, sepse shpreh radiografinë e një konstrukti mental e shpirtëror që historikisht është treguar vasal ndaj mohuesve, kurse tepër agresiv ndaj bashkëpunuesve. Edhe ky refuzim që i bëhet tani Marrëveshjes më të re Shkup-Athinë nuk e ka në thelb patriotizmin e kulluar, por më tepër ka urrejtje dhe refuzim. Asnjëherë nëpër rrugët e Shkupit nuk pati protesta kundër mohuesve të identitetit maqedonas, që nuk ishin të paktë në këto dekada, por përkundrazi, kishte protesta kundër kërkesës së shqiptarëve për arsim të lartë, kundër kërkesës së shqiptarëve për zyrarizim të statusit të barabartë të gjuhës shqipe në të gjithë nivelet e administratës dhe pushtetit. Kjo nevojë irracionale për të protestuar kundër barazisë dhe lirisë së tjetrit dhe për të heshtur kur të mohohet emri, gjuha, kisha flet për natyrën hermafrodite të këtij homosapiensi me shumë dilema të pazgjidhura në kokë.

Shteti si projekt ku të gjithë duhet të investojnë dijet dhe mundësitë për një të ardhme më të mire, duhet të jetë preokupim parësor, sepse shteti mund ta ketë edhe emrin e babes tënd dhe asgjë të mos hyj në punë nëse vazhdon të vegjetosh pa ide e projekte që do ta bënin arsimin, ekonominë, bujqësinë, kulturën shumë më ndryshe se ç'janë tani.

Djema, borxhin ndaj  
Kosovës e keni la

"Tash, duhet me folë drejtë. Nuk kam pasë zemër me e pa lojën Zvicër—Serbi. Bile, bash në atë kohë e lash me u pa me Ambasadorin e Norvegjisë në SHBA. Dojsa me më kalu koha diqysh. Edhe veq me e pa rezultatin në fund. Cilido qoftë. Ja, po e pranoj, nuk jam aspak e fortë, së paku jo sa ata djem në fushë të futbollit. Diqysh, më vike keq për ta. Më vike keq, e ndjeja dhimbje se bartnin mbi supe një barrë që ndoshta nuk ju takon. Më vike keq që ju ra hise atyre me e vëndosë drejtësinë. Me fitu aty ku unë e shumë të tjerë e kemi për detyrë me fitu, po shpesh nuk ia kemi dalë.

Djema, borgjin ndaj Kosovës e keni la. Sa të jem gjallë kam me e kujtu ditën e djeshme. Faleminderit. Përulësisht.", ambasadorja e Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Vlora Çitaku përmes një statusi në rrjetet sociale ka falënderuar Xhakën e Shaqirin për emocionet që i kanë sjellë gjithë kombit shqiptar atë mbrëmje.

Boris Jekh gazetari sloven që  
përkrahu shqiptarët

"Iku gazetari Boris Jekh që kishte guximin ta përkrahte heret kërkesën e shqiptarëve për Republikë të Kosovës. Gazetarin e famshëm sloven, korrespondentin e Dellos, i cili ka vdekur sot, e njoha në vitin e largët 1982, atëherë kur edhe unë sikur edhe ai po bëja punën e korrespondentit të Gazetës Rilindja në Beograd. U njohëm dhe pastaj për katër vite me radhë punuam bashkë, në vitet kur Kosova po përballej me sulmet më të mëdha të nacionalistëve serbë në institucionet republikane e federative të atëhershme, pas demonstratave të vitit 1981 kur shqiptarët në Kosovë kishin kërkuar haptas barazi dhe statusin e Kosovës Republikë.

Miku dhe kolegu i atëhershëm sloven Boris Jekh ishte i vetmi nga dhjetra e dhjetra gazetarë nga e gjithë Jugosllavia, me të cilët po përcillnim ngjarjet politike për ato që po ndodhnin në Kosovë, i cili e kishte guximin intelektual e njerëzor tua thoshte hapur kolegëve të tjerë se Kosovës i takon me të drejtë Statusi i Republikës. Ai kundërshtonte masat e dhunshme që aplikoheshin ndaj shqiptarëve nga pushteti i kohës dhe jo rrallë polemizonte ashpër me kolegët serbë për padrejtësitë që u bëheshin shqiptarëve në ato kohë të vështira. Isha i privilegjuar në at kohë që ta njoh dhe ta kem mik një koleg si ai i cili profesionin e gazetarit e nisi dhe e përfundoi në gazetën slovene Dello, kolumnet javore të të cilit lexoheshin çdo të shtunë me interesim. Ishte ndër gazetarët më të guximshëm slovenë edhe në përkrahjen e pavarësisë së Sllovenisë. Qoftë i përrjetshëm kujtimi për emrin e tij që la si gazetar dhe si njeri", ka shkruar në profiling e tij në Facebook, ish gazetari i Rilindjes dhe konsuli aktual i Kosovës në Slloveni, Gani Mulliqi.

## MEDIACitate

"Rambuje e  
dytë" për  
zgjidhjen  
Kosovë-Serbi

Ditë më parë në mediat serbe u përhapën lajmet se për zgjidhjen Kosovë-Serbi, do të mund të organizohet një "Rambuje e dytë".

Sipas atyre raportimeve në një konferencë të tillë do të merrnin pjesë edhe shtete e fuqishme, duke përfshirë Rusinë, Kinën e Amerikën.

Por deri më tani gjitha këto kanë mbetur vetëm në kuadrin e spekulimeve.

Për një "Rambuje të dytë", konkretisht nuk ka dashur të përgjigjet as kryetari i Partisë Liberal Demokratike në Serbi, Cedomir Jovanoviq.

Ai ka theksuar se së pari duhet të ketë pajtimin ndërmjet të gjitha shteteve të Ballkanit, çka sipas tij do të ndikonte në stabilitetin edhe të Evropës

"Ne duhet të bëjmë rendin tonë të ditës me Podgoricën, Prishtinën, Shkupin, Sarajevën. Duhet të themi se nuk ka asgjë nga Serbia evropiane nëse Bosnja mbetet e pakënaqur, nëse marrëdhëniet me Shkupin, Podgoricën e Prishtinën nuk përmirësohen", tha fillimisht Jovanoviq.

"Sa për ndryshimin e formatit dhe futjen e Amerikës e Rusisë në bisedimet me Serbinë nuk kam asgjë për të thënë, përveç se do të ishte naivë të besonit se janë tema të vërta për mua", tha Jovanoviq për Danas.

Duke folur për një zgjidhje përfundimtar ndërmjet dy shteteve, politikani serb theksoi se Kosova e Serbia duhet të gjejnë modelin e paqes. Ndryshe Jovanoviq është nga politikanët e rralë serbë që e pranon Kosovën e pavarur, madje kohë më parë kishte realizuar një vizitë në Prishtinë.

(Lajmi.net, 24 qershor)

NËSE NUK  
E KENI DITUR...

## Kush e solli për herë të parë futbollin në Shqipëri?

Për herë të parë në Shqipëri, futbollin u lajtu në vitet 1908-1909 në Shkodër. Revista Leka e vitit 1934 i kushton një artikull ardhjes së futbollit në Shqipëri me titullin "Foot-balli, kur filloi m'u njoftë e m'u përhapë në Shqipëri". Artikulli nuk ka autor megjithatë nga ajo që shkruhet në të lë të kuptohet se autori ka qenë vetë një nga ata studentë që ka lajtuar për herë të parë futbollin në Shqipëri, duke qenë se ishte student i kolegjit Saverian, nga ku dolën

themeluesit e shoqatës e të revistës që boton artikullin.

E në këtë artikull shkruhet se ishte kleriku maltez A.Gatt Rutter ai i cili e solli këtë lojë (top e kamë) në Shqipëri në vitet 1908-1909 dhe ua mësoi studentëve të kolegjit Saverian në këtë qytet. E në këtë rast, artikulli evidenton se profesori u përball me vështirësi për t'ua futur këtë lojë në zemër shqiptarëve për faktin se kjo lojë kërkonte kolektivitet, pra bashkëpunim e koordinim.



SFIDAT E SHËRBIMEVE PUBLIKE

# QYTETARËT TË PAKËNAQUR

Anketa rajonale për shërbimet publike, po ashtu ka arritur të zbulon se vetëm një e treta e qytetarëve të Ballkanit Perëndimorë, gjatë dy viteve të kaluar ka hasur në mirëkuptimin në administratën e tyre shtetërore, të cilat i kanë pranuar vërejtjet dhe rekomandimet e tyre gjatë kohës së shfrytëzimit të shërbimeve administrative



Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 24 qershor- Qeveritë e Ballkanit Perëndimor gjatë dy viteve të fundit përmes iniciativave të ndryshme kanë bërë përpjekje për thjeshtëzimin e procedurave administrative për nevojat e qytetarëve edhe të bizneseve. Ky konstatim është përmendur në anketën rajonale të Institutit për politikë evropiane (IPE), ku thuhet se rreth 48 për qind e qytetarëve të Ballkanit Perëndimorë, gjatë viteve të kaluar kanë hasur në nisma dhe përpjekje të qeverive të tyre për ta ndryshuar cilësinë e shërbimeve publike. Në bazë të të dhënave që i siguroar ky IPE-ja, qytetarët e Kosovës (57 për qind prej tyre) janë shprehur se organet shtetërore brenda dy viteve të kaluar kanë tentuar të bëjnë ndryshime sa i përket shërbimeve publike që ato i ofrojnë. Kur jemi te qytetarët e Bosnje dhe Hercegovinës, sipas anketës së titulluar "Perceptimi publik për shërbimet administrative në vendet e Ballkanit Perëndimorë", vetëm 28 për qind prej tyre vlerësojnë se Qeveria e tyre mundohet apo ka bërë ndryshimet në sferën e shërbimeve publike. Të dhënat tjera të siguroar nga kjo anketë kur bëhet pyetje për Maqedoninë, thuhet se 51 për qind e qytetarëve të anketuar janë pro-

noncuar se në kuadër të Qeverisë ekziston vullnet për përmirësimin e shërbimeve publike.

"Zbulimi i cili më tepër të habitë dhe i cili njëkohësisht paraqet sfidë të vazhdueshme është perceptimi i shumicës së qytetarëve se mungojnë mekanizmat që ju lejojnë qytetarëve ta shprehin mendimin e tyre për kualitetin e shërbimeve që i ofrojnë shteti për institucioneve të tyre. Nëse flasim në përgjithësi për këtë çështje, atëherë kjo anketë e ka vërtetuar faktin se ekzistojnë dallime të mëdha mes disa shteteve nga Ballkani Perëndimorë, sa i përket këndvështrimit të qytetarëve për sigurimin e shërbimeve publike", thotë Simonida Kacarska, drejtore shë e IPE-së.

Anketa rajonale për shërbimet publike, po ashtu ka arritur të zbulon se vetëm një e treta e qytetarëve të Ballkanit Perëndimorë, gjatë dy viteve të kaluar ka hasur në mirëkuptimin në administratën e tyre shtetërore, të cilat i kanë pranuar vërejtjet dhe rekomandimet e tyre gjatë kohës së shfrytëzimit të shërbimeve administrative. Siç thuhet në anketë vetëm 13 për qind të qytetarëve të Bosnje dhe Hercegovinës janë deklaruar se institucione të caktuar bëjnë orvatje

për përmirësimin e shërbime në fjalë, respektivisht këtë mendimin e ndajnë 44 për qind të qytetarëve të Shqipërisë, dhe 29 për qind e qytetarëve të Maqedonisë. Krahas këtij qëndrimi, një e treta e popullatës në rajon pajtohet se si shfrytëzues të shërbimeve publike, ato kanë pasur mundësi ta japin mendimin e tyre kur bëhet fjalë për cilësinë apo kualitetin shërbimeve administrative. Përkthyer në shifra i bie se vetëm 15 për qind e banorëve të Bosnje dhe Hercegovinës kanë pasur rastin ta japin këtë mendim, tutje në Maqedoni vetëm 36 për qind të qytetarëve të anketuar u është dhënë mundësia të japin vlerësimin për cilësinë e shërbimeve publik, gjegjësisht në Kosovës, këtë të drejtë e kanë shfrytëzuar 38 për qind e qytetarëve.

"Nëse mungojnë mekanizmat që sigurojnë informacion kthyesë, atëherë është e pamundur që cili do pushtet të di se çfarë mendojnë qytetarët për çështje të caktuara të sigurimit të shërbimeve dhe cilat avancime vlerësojnë se janë të duhura. Megjithatë, të dhënat flasin se qeveritë e rajonit nuk kujdesen për nevojat e qytetarëve, që mund të jetë rezultat i kapaciteti të ulët (të dobët), por gjithashtu mund të jetë tregues se mungon

kuptimi i qeverive për ndërtimin e këtyre mekanizmave të besimit", thekson Kacarska.

Ndryshe, kjo anketë ka zbuluar se në rajon ekziston shkallë e ulët e vetëdijes publike për qasje deri te "e-shërbimet", respektivisht vetëm 19 për qind e qytetarëve të BH i shfrytëzojnë këto shërbime. Përdërisa në Maqedoni mbi 50 për qind e qytetarëve i përdorin ofertat për shërbime publike që mundësohen përmes internetit. Drejtuesit e IPE-së ku flasin për këto risi, shprehen se për për tu brengosur është fakti i cili vërteton diskrapancë të madhe mes përgatitjes për t'i shfrytëzuar "e-shërbimet" dhe pranimi të atyre shërbimeve.

Hulumtimi i realizuar, ka konstatuar se 35 për qind e të anketuarave që kanë njohur për "e-shërbimet", thonë se gjatë dy viteve të kaluara "çdoherë" kanë arritur t'i realizojnë me sukses kërkesat e tyre të parashtruara on-line Kjo për qind lëviz mes 23 dhe 47 për qind në Shqipëri dhe Serbi. Ndryshe, vetëm një e katërta e të anketuarave, rreth 26 për qind e qytetarëve të Ballkanit Perëndimorë, kanë deklaruar se shoqëria civile është përfshirë në procesin e monitorimit të ofritit të shërbimeve publike.



## Zaev: Referendumi për emrin do të ketë sukses

Detyrë patriotike është e secilit politikan, posaçërisht e secilit kryeminsitër, të kujdeset për interesat e qytetarëve të cilët ia dhanë besimin dhe për interesat e shtetit. Jam i gatshëm për lider-ship, të kryesoj në të gjitha proceset që do të thonë siguri, prëforcim i pozitave ndërkombëtare të Maqedonisë, por edhe të rajonit. Ndjehem i përmbushur, sepse u shërbej qytetarëve dhe shtetit dhe punoj në realizimin e një vizioni të madh, mirë për të gjithë, theksoi kryeminsitri Zoran Zaev në një intervistë për gazetën beogradase "Politika", duke u përgjigjur në pyetjet se si ndihet pas "revolucionit politik" të arritur me laps dhe nënshkrim të Marrëveshjes së Prespës me Greqinë.

"Nëse marrim konfirmim, erga omnes të identitetit dhe gjuhës sonë maqedonase, nëse përcaktimi gjeografik Veriore që e shtuam në emrin tonë Maqedoni na i hapë rrugët drejt BE-së dhe NATO-s, nëse marrëveshja e vendosë vendin tonë Maqedoninë në hartën e shteteve në botë në nivel dinjitoz, me identitet tërësisht të mbrojtur, për shekuj me radhë, nëse kjo marrëveshje do të thotë për Greqinë qetësi dhe konfirmim se nuk kemi kurfarë pretendime territoriale apo të tjera ndaj rajonit gjeografik Maqedoni që është në anën greke, atëherë e vetmja që mund të themi se e humbën të dyja palët është sqima që e kanë treguar deri në uljen në tryezë të kryesive të reja politike të shteteve", potencon kryeminsitri Zaev, duke u përgjigjur në pyetjen se kush fitoi, e kush humbi me emrin e ri Republika e Maqedonisë Veriore. Plotësisht, thekson Zaev, ne u liuam nga guri, e humbëm gurin që vendit tonë 25 vite e tërhiqte nga poshtë.

"Maqedonia dhe Greqia fituan së pari kryesi politike të cilat janë të gatshme të sjellin vendime dinjitoze dhe inkurajuese për të mirën e qytetarëve të vet, ndërsa tani fituan njëra në tjetrën edhe mike dhe fqinje të mirë, ndërkaq botës i dhuruan guxim, se nëse ekzistojnë qëllime të mira dhe dëshirohet, ka zgjidhje për çdo çështje. Me marrëveshjet e shtetit tonë me Bullgarinë dhe Greqinë, Maqedonia fitoi të tanishmen dhe siguroi të ardhmen, e siguroi premtimin e të parëve të vet, maqedonasit të kenë shtet të vetin, të respektuar dhe ndërkombëtarisht të njohur", thotë Zaev.

## Shkup, arrestohen 9 protestues

Të paktën 9 persona kanë përfunduar në pranga gjatë protestave të së shtunës në Shkup. Sipas policisë personat në fjalë kanë qenë të maskuar dhe kanë hedhur gurës drejt policisë.

Nga Ministria e Punëve të Brendshme thonë se kundër personave të arrestuar do të pasojnë masat adekuate.

"Gjatë protestave dje në Shkup,

para ndërtesës së Kuvendit në orën 21:40 disa persona të maskuar kanë filluar me hedhjen e gurëve drejt kordonit të policisë, ndërsa më pas janë larguar drejt "Zhena Park". Pas marrjes së masave për mbajtjen e rendit dhe qetësisë publike janë arrestuar nëntë persona, tek të cilët janë gjetur mjete piroteknike dhe mjete tjera", thuhet në njoftimin e MPB-së.





# NË MAQEDONI, QENDRA TRANSITORE E JO KAMPE REFUGJATËSH

Në Maqedoni, në dy qendrat transitorë për strehimin e migrantëve, atë në Gjevgjeli përgjatë kufirit me Greqinë dhe Tabanovc përgjatë kufirit me Serbinë, qëndrojnë vetëm 30 migrantë, kryesisht nga Siria dhe Iraku.

Organizatrat që në fokus kanë ndihmën e migrantëve thonë se në terren kanë vërejtur lëvizje të ndjeshme të migrantëve, por numri atyre që përdorin Maqedoninë si shtet për të arritur në vendet e Bashkimit Evropian, mbetet shumë i vogël.

“Në terren ka lëvizje të migrantëve, por nuk është ndonjë numër i madh që mund të paraqesë shqetësim se rritet numri i migrantëve në Maqedoni. Pas mbylljes së Rrugës Ballkanike, migrantët për të arritur në vendet e BE-së zgjedhin vendet fqinje, Shqipërinë, Malin e Zi dhe Bosnjën e Hercegovinën”, thotë për Radion Evropa e Lirë, Sedat Rushiti nga organizata humanitare NUN.

Nga ana tjetër, Ministri i Punëve të Brendshme i Maqedonisë, Oliver Spasovski gjatë kësaj jave është shprehur se Maqedonia e ka bërë të qartë se në territorin e saj



ka vetëm qendra transitorë, ku mund të strehohen për një afat të shkurtër kohor migrantët të cilët mund të kalojnë nëpër territorin e Republikës së Maqedonisë, siç ishte gjatë periudhës së kaluar.

“Nuk shohim arsye ai qëndrim të ndryshojë, absolutisht se ne mund të bashkëpunojmë, bashkërisht të mbrohemi nga vala e mundshme e emigrantëve. Megjithatë, Maqedonia nuk mund të jetë vend ku do të kemi kampe të përbashkëta dhe këtu të qëndrojnë për një afat më të gjatë”, ka thënë Spasovski.

Këto reagime vijnë pasi Austria dhe Danimarka kanë hedhur idenë për hapjen e kampeve të refugjatëve, kërkesë kjo që paraprakisht është hedhur poshtë nga vendet e

Bashkimit Evropian. Këto dy shtete kanë kërkuar që migrantët të transferohen në Evropë, por në shtetet që nuk janë në BE, duke mos precizuar se në cilat shtete.

Organizatrat joqeveritare, të cilat fokus kanë ndihmën e migrantëve thonë se shtetet e Ballkanit Perëndimor shihen si vende ku mund të ngriten të ashtuquajturat kampe “në Evropë, por jashtë Bashkimit Evropian”.

Jasmin Rexhepi nga organizata joqeveritare LEGIS, e cila vepron në terren për të ndihmuar migrantët, për Radion Evropa e Lirë thotë se është më se e qartë se qëllimi i migrantëve nuk janë vendet e Ballkanit Perëndimor, aq më pak Maqedonia.

“Edhe sikur të ndërtohen kapa-

citete për strehimin e migrantëve ato do të mbeten të zbrazëta, sepse gjatë komunikimit që kemi ne si organizatë me migrantët mësojmë se migrantët të cilët largohen nga vendet e prekura nga lufta, siç është Siria Iraku apo Afganistani, madje dhe shtetet e Afrikës Veriore, në asnjë mënyrë nuk dëshirojnë të mbeten në Maqedoni. Si synim kanë vendet e BE-së”, thotë Rexhepi, duke shtuar se nëse insistohet që migrantët të ndalohen në Maqedoni, ashtu siç synon Austria dhe Danimarka, kjo do të jetë në kundërshtim me konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

“Madje për këtë gjë, Evropa është shumë e vetëdijshme”, thotë tutje Rexhepi.



## Ahmeti: Shqiptarët do ta vulosin referendumin

Kreu i BDI-së Ali Ahmeti është i bindur se shqiptarët do t'i përgjigjen pozitivisht referendumin eventual, i cili sipas paralajmërimeve do të mbahet në vjeshtë.

Ahmeti ka theksuar se zgjidhja e emrit është e një rëndësie të madhe, pasi në këtë mënyrë sigurohet ardhmëria e Maqedonisë. “Unë mendoj që shqiptarët janë të përgjegjshëm, e dinë rëndësinë e kësaj çështjeje kaq të madhe të ardhmen e shqiptarëve të Maqedoni dhe vendit dhe do t'i përgjigjen pozitivisht referendumin, do të jenë pjesëmarrës, vulosës të një procesi jashtëzakonisht të rëndësishëm mbi të ardhmen mbi perspektivën, por edhe njëherë kontribuues të mëdhenj të paqes, stabilitetit dhe sigurisë dhe ardhmërinë e këtij vendi – tha Ali Ahmeti, kryetar i BDI-së.



## Pompeo i kërkon Francës: Maqedonia të ftohet në NATO

Sekretari amerikan i shtetit, Mike Pompeo ka kërkuar nga Franca që të zhbllokojë anëtarësimin e Maqedonisë në NATO dhe në BE. Pompeo ka kërkuar nga ministri i Jashtëm francez, Jean-Yves Le Drian që të mbështet zgjerimin e NATO-së përmes ftesës ndaj Maqedonisë për t'u bashkuar me aleancën, përfshi fillimin e bisedimeve për anëtarësim në BE. E gjithë kjo vjen pas nënshkrimit të marrëveshjes Maqedoni-Greqi, për çështjen e emrit.

## Çizhov: Pranimi i Maqedonisë në NATO do të jetë gabim me pasoja

Përfaqësuesi i përhershëm i Rusisë në BE, Vlladimir Çizhov, në një intervistë për gazetën greke “Kathimerini”, shpreson që zgjidhja e çështjes së emrit midis Athinës dhe Shkupit do të kontribuon në stabilitetin e rajonit, ndërsa theksoi se pranimi i Maqedonisë në NATO do të ishte një “gabim me pasoja”.

“Sigurisht, ne nuk do të hedhim bomba bërthamore. Siç thashë, çdo vend ka të drejtë të marrë vendime dhe të bëjë gabimet e veta. Por ka gabime, që kanë pasoja”, tha Çizhov, duke iu përgjigjur pyetjes për reagimin rus, në rast të pranimit të mundshëm të Maqedonisë në NATO, përcjell Telegrafi Maqedoni.

Në intervistë të cilën e përcjell Sputnik, ai thotë se marrëveshja mes Maqedonisë dhe Greqisë është çështjeje që është dashur të zgjidhet më herët, pasi sipas tij, të dy vendet duhet të kenë bashkëpunim fqinjësor. “Kjo marrëveshje, në shpresojmë që do ta forcojë stabilitetin e Ballkanit dhe bashkëpunimin midis dy vendeve, por



nuk duhet parë si justifikim për qasje të shpejtë të fqinjët tuaj në aleancën ushtarake”, tha ambasadori rus.

## GREKËT KUNDËR MARRËVESHJES SHKUP-ATHINË

Greqia nuk e kundërshton integrimin Evropian dhe Euroatlantik të Maqedonisë, që paraqet përbushjen e pjesës së detyrimeve sipas marrëveshjes për zgjidhjen e kontestit për emrin.

Ministri grek Kocias ka konfirmuar se e ka marrë notën nga Ministria e Punëve të Jashtme e Maqedonisë se marrëveshja është ratifikuar.

“Në zyrën time diplomatike, i kemi gati letrat. Unë zgjodha ta



nënshkruaja letrën të dielën ndërsa të hënën në mëngjes t'i dërgojë në Bashkimin Evropian dhe NATO”, ka thënë Kocias.

Por, në anën tjetër, reagimet e qytetarëve ndaj nënshkrimit së

marrëveshjes Athinë-Shkup vazhdojnë, pasi një plan i ri për tubim dhe protestë është planifikuar për Maqedoninë në Selanik.

Organizatorët thonë se pas mbledhjes tubimi do të vazhdojë përpara konsullatës të SHBA, IRJM dhe zyrat e SYRIZA, shkruan gazeta greke TA NEA.

Ndërkohë është kryer edhe një sondazhi i ri në Greqi mbi marrëveshjen Tsipra-Zaev. Sipas rezultateve të hulumtimit të kryer në të

gjitha qarqet e lindore, qendrore dhe perëndimore për “Maqedonia Veriore”, 86% e të anketuarve ishin kundër marrëveshjes.

Bazuar në anketën, 86% e të anketuarve thonë marrëveshje të keqe, në krahasim me 12% që mendojnë se është mirë.

Në të njëjtën sondazh, 83% besojnë se çështja nuk është zgjidhur, por marrëveshja e ka rënduar atë duke e bërë problemin më keq.



REGJISTRIMI I NXËNËSVE NË SHKOLLAT E MESME

# NXËNËSIT SHQIPTARË HUMBËN MUNDËSINË E PARË

Nga 17.590 të cilët konkurruan në paraqitjen e parë, ia kanë dalë të regjistruhen vetëm 11.697 nxënës. Firo është shënuar më tepër te shqiptarët dhe më pak se maqedonasit. Konkretisht te paralelet shqipe janë regjistruar vetëm 54 për qind nga numri që kanë konkurruar, ndërsa te maqedonasit mbi 71 për qind



sa shkollat e këtyre drejtimeve nuk do të kenë gjithashtu as të drejtën të ulin për 10 pikë kriteret e regjistrimit në paraqitjen e dytë të regjistrimit të nxënësve për këtë afat i cili do të jetë më 28 qershor. Të gjitha shkollat tjera, mund të zbrisin për 10 pikë kriterin e regjistrimit të tillë.

Sidoqoftë, nga 17.590 të cilët konkurruan në paraqitjen e parë ia kanë dalë të regjistruhen vetëm 11.697 nxënës në nivel të të gjitha shkollave dhe drejtimeve të arsimit të mesëm. Në këtë pikë, duket se shqiptarët janë ata që më së tepërmi e kanë humbur mundësinë e parë të regjistrimit. Të dhënat zyrtare të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës (të përpunuara nga rezultate e regjistrimit të nxënësve nëpër shkollat), vërtetojnë se firo më e madhe e regjistrimit është shënuar në paralelet me mësim në

gjuhën shqipe. Konkretisht, në kuadër të numrit të nxënësve që kanë konkurruar për paralelet shqipe janë dorëzuar 4.433 dokumente, ndërsa janë regjistruar 2.401 nxënës. Pra janë regjistruar 54 për qind e atyre që kishin konkurruar. Ndërkaq te nxënësit maqedonas kjo përqindje është shumë më e lartë, mbi 71 për qind. Të dhënat e njëjta flasin se gjatë paraqitjes së paralelet me mësim në gjuhën maqedonase kishin konkurruar 12.872 nxënës dhe së 9.167 prej tyre tanimë veç janë regjistruar. Për paralelet në gjuhën turke është gjithashtu e ulët shkalla e regjistrimit (41 për qind). Nga 266 nxënës që kanë konkurruar, janë regjistruar vetëm 110. Në kategorinë e vendeve për përsëritësit, të gjithë ata që i kishin dorëzuar dokumentet (19 nxënës) e kanë regjistruar sërish vitin 2018/2019, si nxënës të citit të parë të arsimit të mesëm.

Faji, sigurisht që nuk mund t'ju faturohet vetëm nxënësve, pasi edhe atëherë kur i dorëzojnë dokumentet për një drejtim i cili nuk korrespondon me pikët e nevojshme me Konkurs, atë përsëri nuk janë fajtorët e vetëm. Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) deri tani nuk ia ka dalë të gjejë partnerët nëpër shkollat dhe asociacionet e prindërve dhe nxënësve me qëllim të gjetjes së mekanizmit për orientimin sa më të mirë të nxënësve, por edhe për afrimin e interesave të MASH-it me interesat e nxënësve, apo të krijimit të politikave efektive të regjistrimit të nxënësve. Për paralelet me mësim në gjuhën maqedonase, ndryshon puna. E parë, për paralelet në këtë gjuhë jepen shumë më tepër paralele se sa është realisht numri i nxënësve kandidatë, për 64 për qind të gjysmë maturantëve maqedonase, në konkursin jepen 68 për qind të ven-

deve, kurse për 32 për qind të shqiptarëve, në Konkurs jepen 29 për qind e vendeve. Pra, të parët kanë shumë më tepër mundësi zgjedhje se sa të dytët. Një tjetër element i disfavorshëm për nxënësit shqiptarë është edhe mungesa e traditës së hapjes së paraleleve shqipe në shkollat dhe drejtime të caktuara dhe paralelisht kësaj mungese e sensibilizimit të tyre para gjysmë-maturantëve dhe prindërve të tyre.

Mbingarkesa e shkollave është gjithashtu problem i cili nuk ka si të mos reflektohet edhe në fyronë e regjistrimit. Në gjimnazin e vetëm në gjuhën shqipe në Shkup, në "Zef Lush Marku", propozohet të formohen 16 paralele apo dy herë më shumë se në gjimnazet maqedonase: "Nikolla Karev", "Orce Nikollov", "Rade Jovčevski Korçagin", "Georgi Dimitrov" apo "Josip Broz Tito". Në të gjitha këto gjimnaze pa përjashtim, regjistrimi ka përfunduar pasi janë plotësuar të gjithë vendet e paraleleve të planifikuara me Konkurs. Për nxënësit shqiptarë përveç se në "Zef Lush Marku" regjistrimi nuk ka përfunduar edhe në Shkollën e Mesme "Sara" ku janë dhënë katër paralele të drejtimit gjimnaz dhe dy ekonomik. Megjithatë, nuk duhet harruar se kjo është shkollë rurale dhe frekuenca e nxënësve shembullorë nuk mund të jetë në nivele të njëjta me ato të shkollave urbane.

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 24 qershor – Jo të gjithë ata nxënës të cilët dorëzojnë dokumentet ia dalin të regjistruhen në shkollat që kanë synuar herën e parë. Një pjesë e mirë e tyre do të duhet të provojnë sërish regjistrimin në paraqitjen e dytë pasi rezultat e paraqitjes së parë që u publikuan javën e shkuar tregojnë se rreth 6 mijë kandidatë nuk ia kanë dalë të regjistruhen ose sepse nuk i kanë plotësuar kushtet e regjistrimit ose sepse nuk ka pasur vend për ta në shkollat ku janë drejtuar. Rastet e mungesës së vendeve janë shënuar kryesisht në arsimin gjimnaz, mjekësisë dhe ekonomi, ndër-

HAPI I PARË KONKRET PAS SHUMË VITESH PRMETIME

## FILLOJNË PUNIMET PËR HAPJEN E BULEVARDIT BLLAGOJA TOSKA

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 24 qershor – Komuna e Tetovës me rrënimin e disa objekteve të cilat janë shpronësuar ka filluar punimet për hapjen e bulevardit "Blagoja Toska" që është një kërkesë e kahmotshme e qytetarëve të Tetovës pasiqë hapja e këtij bulevardi do të kontribuonte në rregullimin e kaosit të komunikacionit në qytetin e Tetovës. Bulevardi "Blagoja Toska" ishte premtim edhe i kryetarëve të mëparshëm të komunës së Tetovës por edhe i kryetarës së tanimshme Teuta Arifit si në mandatin e parë poashtu edhe në mandatin e dytë të sajë, mirëpo deri më tani nuk ishte ndërmarrë asnjë hap konkret në hapjen e tij për shkak të hapjes e këtij bulevardi ka një kosto të madhe, sepse do të duhet të rrenohen edhe disa shtëpi njëkohësisht dhe të zgjidhe disa çështje pronësore juridike. Nga Sektori për tokë ndërtimore dhe komunikacion pranë komunës së Tetovës shprehen se në këtë mandat hapja e këtij bulevardi do të jetë prioritet. Sipas tyre, faza e parë



e punimeve në drejtim të hapjes së bulevardit tanimë ka filluar, por rrenohen disa objekte ku toka në të cilat ata ishin ndërtuar deri më tani është shpronësuar. Nga komuna informuan se po punohet intezivisht në shpronësimin e tokës së mbetur nga pronarët të tjerë procedurë kjo e cila pritet të zgjasë deri në fund të këtij viti dhe më pas të fillohet me fazat tjera të hapjes së këtij bulevardi. "Ky është vetëm fillimi për hapjen e këtij bulevardi,

ndërsa shpresojmë që deri në fund të vitit të përfundojë procesi i shpronësimit me të gjithë pronarët dhe vitin tjetër të fillojë ndërtimi i trasës së rrugës nëse eventualisht nuk ka ndonjë pengesë shtesë", tha Arsim Nuredini udhëheqës i Sektorit për tokë ndërtimore dhe komunikacion pranë komunës së Tetovës. Mos përfundimi i projektit për hapjen e bulevardit "Blagoja Toska" që ishte një ndër prioritetet e komunës së Tetovës në

mandatin e parë e ka sjellë këtë rrugë në një gjendje të mjerueshme ku përveç ujit dhe baltës që grumbullohet në disa pjesë të kësaj rruge, lëvizjen e lirë të banorëve e vështirësojnë edhe makinat e parkuara të cilat urrën tek pjesa poshtë spitali i Tetovës e kanë shndërruar në parkim. Në fazën e dytë gjatë procesit të eksplorimit do të rrenohen 19 objekte në këtë bulevard. Përndryshe, arsyetimi i autoriteteve të komunës së Tetovës për mosrealizimin e këtij projekti ka qenë ndërtimet pa leje që janë në procedurë legalizim. Bulevardi "Blagoja Toska" fillon të unaza tek ish restorant Mema dhe përfundon tek stadiumi i qytetit, ky bulevard është një arteriet kryesore të qytetit të Tetovës hapja e të cilit do të lehtësonte qarkullimin e automjeteve dhe njerëve një pjesë tjetër të qytetit. Banorët disa herë kanë thënë se ejanë të gatshëm që të bëjnë marrëveshje me komunën për kompensim por edhe ata disa herë janë shprehur skeptik rreth seriozitetit të komunës për të realizuar

deri në fund këtë projekt i cili gjithsesi sipas autoriteteve të komunës së Tetovës ka kosto të lartë për realizim. Në ndërkohë, organet kompetente të komunës së Tetovës kanë mbyllur rrugën që lidhte bulevardin e Ilindenit me spitalin e Tetovës në afërsi të urrës së lumit Shkumbin. Nga komuna e Tetovës thonë se se kjo rrugë është mbyllur për të lehtësuar qarkullimin e komunikacionit në këtë pjesë. Në bazë të planit gjeneral urbanistik dhe në koordinim me organet kompetente pjesa e rrugës tek xhamia e larme që shkon për tek spitali i qytetit është rrugë e mbyllur andaj ne realizuam aksionin për lehtësimin e qarkullimit në komunikacion pasiqë në këtë pjesë të udhëkryqit nuk ka pasur mundësi tjetër që do të rregullonte komunikacionin, e vetmja mënyrë e zgjidhjes së problematikës në lëvizjen e makinave ka qenë mbyllja e rrugës sipas planit gjeneral urbanistik të qytetit. Nga komuna nënvizuan se më gjerësisht në lidhje me mbylljen e kësaj rruge do të prononcohen të hënën.



Në vend të 12 laboratorëve qendrorë të analizave të gjakut, siç qëndron në tenderin e reagentit, Qeveria vendos të zvogëlojë numrin e tyre në tetë dhe më tej të centralizojë laboratorët. Dy laboratorë qendror do të jenë në Shkup ku do të bëhet analiza e gjakut e të gjitha spitaleve, klinikave dhe qendrave mjekësore në qytete. Përveç në Shkup qendra laboratore do të jenë në Manastir, Kumanovë, Shtip, Ohër, Strumicë dhe Tetovë

Koha Delvina KËRLUKU

Shkup, 24 Qershor -Përveç laboratorëve të gjakut, qeveria centralizon edhe depot, kështu që nga 120 depo për reagentë (një substancë ose përzjerje për përdorim në analizat kimike ose reagime të tjera), tenderi i ri parasheh vetëm tetë prej tyre. Nuk do të ketë largim të laboratorëve të tjerë, por transferimet, sipas Ministrisë së Shëndetësisë, janë të mundshme.

Në vend të 12 laboratorëve qendrorë të analizave të gjakut, siç qëndron në tenderin e reagentit, Qeveria vendos të zvogëlojë numrin e tyre në tetë dhe më tej të centralizojë laboratorët. Dy laboratorë qendror do të jenë në Shkup ku do të bëhet analiza e gjakut e të gjitha spitaleve, klinikave dhe qendrave mjekësore në qytete. Përveç në Shkup qendra laboratore do të jenë në Manastir, Kumanovë, Shtip, Ohër, Strumicë dhe Tetovë.

Për zëvendës ministrin e shëndetësisë Asim Musa, nuk dihet arsye pse pikërisht në këto qendra zhvendosen depot. I pyetur nga gazeta "Koha", pse në Ohër e jo në Strugë, ai thotë se jo pa qëllim ndodhin këto strategji. Ai është i mendimit që nuk do të vendosen

CENTRALIZIMI I LABORATORËVE TË GJAKUT DHE DEPOVE

## PO KTHEHEMI 30 VITE PRAPA, THONË PROFESIONISTËT



Asim Musa

**"Unë do të mundohem që të mos bëhet një investim në Ohër, por nëse bëhet do të jetë edhe në Ohër edhe në Strugë edhe në Çair edhe në qendrën Klinike Universitare, pastaj edhe në Gostivar si në Tetovë. Por, të gjitha argumentet janë të bëhet në Strugë dhe jo në Ohër, sepse numri i shërbimeve është shumë më i madh në laboratorin e Strugës se sa atë të Ohrit. Unë do ti mbroj argumentet e mia, nëse janë në plan 8 depo, le të bëhen 12. Dhe për këtë do të luftoj deri në fund"**

këto depo në disa qytete të përcaktuara. "Unë vij nga Struga dhe është e qëlluar pyetja juaj, unë do të mundohem që të mos bëhet një investim në Ohër, por nëse bëhet do të jetë edhe në Ohër edhe në Strugë edhe në Çair edhe në qendrën Klinike Universitare, pastaj edhe në Gostivar si në Tetovë. Por, të gjitha argumentet janë të bëhet në Strugë dhe jo në Ohër, sepse numri i shërbimeve është shumë më i madh në laboratorin e Strugës se sa atë të Ohrit. Unë do ti mbroj argumentet e mia, nëse janë në plan 8 depo, le të bëhen 12. Dhe për këtë do të luftoj deri në fund", thotë Musa, zëvendës ministër i Shëndetësisë. Sipas tij ministri Filipçe ka dëgjuar reagimet, por ai personalisht me Ministrin Filipçe nuk ka patur një bashkëbisedim

direkt. Musa mbetet këmbëngulës se nuk mund të bëhet Ohri qendër laboratorike, kur në Strugë ka kirurgji shumë funksionale, që i duhen 24 orë, në çdo moment analiza gjaku. Ai thotë se në Strugë poashtu është spitali i hemo-dializës, ku kërkohet analiza urgjente, që janë të ndryshme nga ato të kirurgjisë, nevojja urgjente sidomos gjatë stinës së verës, për shkak të dehidritimit të fëmijëve, ku reparti i pediatriisë do të ketë nevojë për analiza urgjente, që poashtu janë lloj tjetër i analizave, ku të gjitha këto analiza kur bëhen bashkë, përbejnë një laborator, pra një depo.

Ndryshe, mbi 300 aparate për analiza që janë marrë me tenderin e fundit para tre viteve në Maqedoni, do të shpërndahen sipas nevojës,

në vendet e destinuar. Ndërsa, me tenderin e ri nga firma e paraparë, Ministria pret falas 112 pajisje të reja dhe shërbimi do të jetë pa pagesë. Siç ka njoftuar edhe më herët ministri Filipçe, pacientët nuk do të dëmtohen. Por, në vendet e tyre të banimit do të bëjnë analiza që nuk janë bërë më parë dhe do të dërgohen në laboratorët qendrorë, ndërsa rezultatet do të merren në Shkup, të njëjtën ditë ose më së voni ditën tjetër.

Me centralizimin e laboratorëve, kursimet do të jenë nga 10 në 20 përqind. Në reagimet e ekspertëve profesional thuhet se nuk do të plotësohen nevojat e pajisjeve të vogla dhe do të vendosen vetëm për raste të shpejta, të jashtëzakonshme dhe kjo do të jetë e mjaftueshme. Ndërsa analizat urgjente të gjakut do të bëhen vetëm pasdite. Pajisjet e vogla portative (mbartshme) nuk i plotësojnë nevojat për të gjitha analizat, por Ministria e Shëndetësisë nuk do ti blejë ato sepse janë shumë të shtrenjta. Shumë mjekë, ekspertët profesional, kundërshtojnë këtë vendim, i të cilët pretendojnë se ky lloj i centralizimit do të na kthejë 50 vjet prapa.

## Shëndetësinë publike dhe private, të ketë trajtim të barabartë

Shkup, 22 qershor—Trajtim të barabartë gjatë ndarjes së subvencioneve shtetërore si për shëndetësinë publike dhe shëndetësinë privat që kanë të nënshkruara marrëveshje me Fondin për Sigurim Shëndetësor të Maqedonisë (FSSHM) si dhe t'ju jepet mundësia që edhe institucione të jera të shëndetësisë private të nënshkruajnë marrëveshje me FSHM-në. Këto kërkesa deri te Qeveria e Maqedonisë i bëri publike Lidhja e Odës ekonomike të Maqedonisë (LOEM).

Borislav Jovanovski, anëtar i Bordit udhëheqës të institucioneve shëndetësore private në Maqedoni pas konsultimeve të bëra me anëtarët e grupacionit të shëndetësisë private në drejtim të rritjes së cilësisë së shërbimeve mjekësore të cilët kërkojnë nga Qeveria aktuale të përkrah financiarisht edhe shëndetësinë private në Republikën e Maqedonisë.

„Të dhënat e fundit për rrjetin shëndetësor në Maqedoni të publikuara nga Ministria e për momentin 70 për qind e institucioneve shëndetësore nga numri i përgjithshëm në vend janë private dhe dallimi është vetëm se institucionet private shëndetësore janë të themeluara nga persona privat ndërsa institucionet shëndetësore publike janë pronë e Qeverisë së Maqedonisë. Mirëpo si shëndetësia publike dhe ajo private kryejnë shërbime të njëjta derisa janë nënshkruar të marrëveshjes me Fondin e Sigurimit megjithatë nuk janë të barabartë para ligjit sepse investimet që janë bërë në shëndetin publik këto 25 vitet e fundit janë më para nga Buxheti i Maqedonisë ndërsa deri më sot shteti aspak nuk ka financuar shëndetësinë private edhe përkundër faktit se nga sektori privat i shëndetësisë në buxhet derdhen më shumë para në buxhet se sa nga shëndetësia publike" deklaroi Josifovski në takimim e fundit me përfaqësues të mediave. (Z.V.)

## DEL NË TREG ILAÇI MË I RI OKREVUS

### Shpresë e re për njerëzit me sklerozë të shumëfishtë



Shkup, 24 qershor - Në tregun e Maqedonisë është hudur ilaçi më i ri Okrevus (ocrelizumab) për trajtimin e sklerozës të shumëfishtë (MS). Kjo sëmundje konsiderohet akoma si e pashërueshme dhe mjekët përpichen ta trajtojnë duke ngadalësuar përparimin e saj, si edhe duke trajtuar simptomat. Ilaçet e deritanishme që janë përdorur për të ndaluar ose ngadalësuar përparimin e sëmundjes dhe për të lehtësuar krizat, kanë qenë të paktë. Kompania farmaceutike "Roch Macedonia", që ka prodhuar ilaçin "Okrevus" do të mundësojë pacientëve tanë që në treg ta gjejnë ilaçin për të lehtësuar sëmundjen dhe avanci-

min e aftësisë së kufizuar. Okrevus është ilaç efektiv dhe lehtëson trajtimin e sëmundjes, dhe pranohet një herë në çdo gjashtë muaj me ushqim artificial, pa testet rutinore.

Aleksandra Ivanovska, drejtore e "Roch Macedonia" thotë se paraqitja e ilaçit Okrevus në Maqedoni nga ekspertë nënkupton një avancim të rëndësishëm në trajtimin dhe fillimin e një epoke të re për pacientët me sklerozë të shumëfishtë. Ajo sqaron se Okrevus tashmë është miratuar në më shumë se 60 vende të botës, si në Amerikën e Veriut, Amerikën e Jugut, Lindjen e Mesme, Evropë, Australinë, Zvicër dhe vende të tjera. Numri i pacientëve të trajtuar më këtë ilaç shkon mbi 40,000 pacientë. Ivan

Barbov, drejtor i Klinike Universitare të Neurologjisë në Shkup informon se skleroza e shumëfishtë prek më shumë se 2.5 milion njerëz në botë, ndërsa në Maqedoni numri i njerëzve me MS është më i madh se 1.200. Mosha e pacientëve që preken më shumë nga kjo sëmundje është ndërmjet 20-40 vjeçare. Ndërkaq, specialisti i neurologjisë Barbov, thotë se multiskleroza është një sëmundje kronike që e bën njeriun të paafte, me pasoja për shëndetin, lëvizshmërinë e dobët dhe mospërfshirjen e pacientëve në aktivitetet ditore dhe punësim, por edhe një barrë e madhe në familje dhe shoqërinë në tërësi. Ai shton se me ndihmën e ilaçit të ri, sot mund ta kontrollojmë përparimin e së-

mundjes. Klinika e Neurologjisë në Shkup, aktualisht trajton 409 pacientë me MS, shumica e të cilëve janë me terapi të nivelit të parë (interferon) - 372 pacientë, ndërsa 37 në terapinë e nivelit të dytë.

Okrevusi pranohet dy herë në vit, udhëzojnë mjekët, pa nevojën e monitorimit të posaçëm, gjë që gjë shmang trajtimin e tyre çdo ditë ose çdo javë. Mirëpo specialistët e neurologjisë apelojnë që për ta ofruar ilaçin në dispozicion për të gjithë njerëzit me MS duhet angazhimi i të gjithëve. Okrevus është ilaçi i parë dhe i vetëm i aprovuar për trajtimin e personave me forma recidive të sklerozës së shumëfishtë dhe kryesisht të sklerozës së shumëfishtë progresive. Ilaçi është aprovuar në

Maqedoni në prill të këtij viti nga ana e Agjencisë për barnat dhe pajisjeve mjekësore, dhe në sajë të menaxhimit dhe ekipit profesional në Klinikën e Neurologjisë në Shkup dhe autoritetet shëndetësore kanë iniciuar procedurën për prokurimin e mjekësisë të trembëdhjetë pacientë me MS. Farmacia "Roch Macedonia", është angazhuar që të ketë bashkëpunim me Klinikën e neurologjisë, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Fondin për Sigurim Shëndetësor të Maqedonisë, si dhe të gjitha institucionet e tjera relevante në sigurimin e një modeli të përshtatshëm dhe të çmimeve fleksibile.

Çmimin e ilaçit Okrevus pritet ta caktojë Ministria e Shëndetësisë. (D.K)




## Burgoset politikani rumun për korrupsion

Liviu Dragnea, kryetar i Dhomës së Ulët të parlamentit rumun dhe praktikisht njeriu që tërheq të gjitha flijet e politikës në vend, është dënua me tre vjet e gjysëm heqje lirie për abuzim me postin.

Vendimi nuk ka hyrë ende në fuqi dhe lideri i partisë socialdemokrate ka të drejtën e apelit. Por ndërkohë ai ka nisur ta humbasë mbështetjen në radhët e partisë së tij dhe kjo mund t'ia lëkundë këmbët te mbiquajturit "Baroni i Rumanisë".

Lëvizja e Gjykatës së Lartë



kundër 55 vjeçarit lidhej me akuzat e krijimit të vendeve fiktive të punës për anëtarët e partisë së tij. Dragnea është dënua një herë

për manipulim zgjedhesh ndaj nuk bëhej dot kryeministër. Por si kryetar i partisë në pushtet, praktikisht qeverinë e ka pasur ai në dorë.

Shefja e ekzekutivit Viorica Dancila, thonë opinionistët, "e hedh vallen" siç e do Dragnea. Por shpërdorimi i pushtetit tani po i kthehet në boomerang dhe për këtë meritat i ka shoqëria civile. Që prej fillimit të 2017-tës, rumunët dalin të protestojnë rregullisht nëpër rrugë dhe duket se rezistenca e tyre demokratike po jep rezultat.



## Përdhunohej e vritet politikania gjermanesë

Një vajzë gjermane 28 vjeçare është vrarë në Spanjë. Bëhet fjalë për Sophia Loesche, ish-presidente e të rinjve të Partisë Socialdemokrate gjermane dhe zëvendës presidentja aktuale e SPD në Bavari. Trupi i saj u gjet nga policia spanjolle në Asparrena, në Vendet Baske. Në trupin e vajzës janë gjetur shenja dhune. Tetë ditë më parë familja bëri denoncimin e vajzës. Policia gjermane kishte nxjerrë një mandat ndërkombëtar dhe e kishte përqendruar vëmendjen në Spanjë, ku mendohej se ishte vajza. Guardia Civile spanjolle ka arrestuar në Jaen, në Andalusi, një kamionist maroken 41 vjeçar. Mbi të mund të ketë një mandat arresti ndërkombëtar dhe konsiderohet i dyshuari kryesor. Në hetimet paramendohet që Sophia është përdhunuar dhe më pas vrarë nga kamionisti maroken.

## Gjendet i vdekur tifozi i Messit



Trupi i një tifozi 30-vjeçar të Lionel Messit, i cili ishte zhdukur menjëherë pas humbjes turpëruese të Argjentinës ndaj Kroacisë të enjten në Kupën e Botës, është gjetur në një lum sot në mëngjes.

Trupi i Dinu Alex, i cili vinte nga Arumanoor – një fshat i vogël në brigjet e Lumit Mee-nachil në Indi – u gjet i vdekur në lumin.

Alex ishte zhdukur që prej humbjes së Argjentinës në ndeshjen e dytë të fazës grupore kundër Kroacisë në Kupën e Botës në Rusi. Alex, i cili kurrë nuk ka luajtur futboll, i ka ndjekur ndeshjet e ligave të mëdha dhe ka qenë tifozi i flakët i Messit. Ai punonte si llogaritar në një firmë private dhe u kishte thënë kolegëve para ndeshjes se Argjentina do të fitonte dhe se heroi i tij do të shënonte.

## Kush desh t'i bëjë atentat Feriz Dervishit?

Mistria e Punëve të Brendshme nuk ka ende detaje të reja pas bastisjes së shtëpive në fshatin Çerkez të Kumanovës, por dhe shoqërimit në polici të personave me iniciale N.B dhe I.B., stëpitë e të cilëve u bastisë dje, pasi të enjten shpërtheu një bombë në automobilin e këshlltarit të BDI-së, Feriz Dervishi.

Nga MPB thanë vetëm se procedura e hetimeve vazhdon dhe po punohet në zbardhjen e plotë të rastit. Gjatë ditës së sotme, të pakapshëm ishin edhe nga prokuroria.

Siç njoftoi Ministria e Brendshme, gjatë bastisjes së ditës së djeshme janë gjetur armë të ndryshme të zjarrit dhe fishekë, shkruan Shenja.

Pas dokumentimit të plotë të rastit do të pasojnë kallëzime penale përshkak të dyshimit të ba-



zuar për kryerjen e veprës penale "Mbajtja e paautorizuar, prodhim i armëve dhe mjeteve shpërthyes" të cilët dënohen në pajtueshmëri me Kodin Penal.

Jozyrtarisht, personat që janë bastisur dhe janë marrë në pyetje nga policia kanë pasur histori

zënke me Feriz Dervishin, këshilltarin në Kumanovë vetura e së cilës ishte shënjestër e një sulmi me bombë një ditë më parë. Deri tani policia nuk ka informuar nëse ngjarja e fundit ka të bëjë me mosmarrëveshje që kanë pasur palët edhe më parë.

## Sulmohet fizikisht ish deputeti i LSDM-së, Stojko Paunoski

Të shtunën në mbrëmje në Tetovë nga disa persona është sulmuar fizikisht ish deputeti i LSDM-së, Stojko Paunoski.

Ai nëpërmjet rrjetit social facebook bëri të ditur se fillimisht djali i tij është sulmuar fizikisht para hyrjes së ndërtesës ku ai jeton, përcjell Portalb.mk.

"Pa asnjë arsye, duke ardhur në shtëpi djali im u sulmua para hyrjes së ndërtesës ku jetojmë nga një grup shqiptarësh që ishin nën ndikimin e alkoolit dhe drogës. Ishte vajza ajo që më zgjoi, pasi që kishin parë ngjarjen nga tarraca dhe unë si prind zbrita ta mbroj djalin tim me ç'rast u sulmova edhe unë. Rasti është paraqitur në polici dhe personat që na



sulmuan tani më janë arrestuar", shkruan Paunoski në facebook. Ai madje bëri të ditur që nuk dëshiron që rasti të politizohet dhe se për të gjitha mediat që shkruajnë të pavërteta dhe shpifje do të ngrëhet akt padi.



## Digjen të gjalla shumë kafshë në një fermë në Bërvenicë

Të shtunën pasdite ka shpërthyer zjarr në një fermë në Bërvenicë të Tetovës. Komandanti i zjarrfiksave Uka Aliti thekson se nga zjarri ka shumë humbje kafshësh, duke përfshirë lopë dhe derra. "Zjarr i madh në një fermë në Bërvenicë ku ka shumë humbje kafshësh nga zjarr i tmershëm. Ne jemi ende duke shpëtuar meqenëse ka shumë lopë dhe derra", thekson Uka Aliti. Policia po bën hetime për shkakun dhe gjithçka që lidhet me shpërthimin e zjarrit.

## Mbajti peng djalin dhe goditi me sëpatë edhe dy policë

Të tjera detaje janë zbuluar nga ngjarja e ndodhur mbrëmë në lagjen "30 vjetori" të Beratit, ku një 42-vjeçar dhunoi psikologjikisht e mbajti peng të birin në banesë. Policia e Beratit ka zbuluar se "Shtetasi Admir Duro gjithashtu kundërshtoi me forcë punonjësit e policisë për tju shmangur shoqërimit, duke i goditur me sëpatë e sende të forta,

për pasojë u dëmtuan lehtë dy efektivë policie". 42-vjeçari i divorcuar, Miri Duro, jetonte së bashku me djalin adoleshent Albert Duro. Pas divorcit ish-bashkëshortja është larguar në Itali, duke e lënë djalin në kujdestari të të atit. Mirëpo 42-vjeçari për shkak të problemeve psikike ushtronte dhunë ndaj të birit, dhe prej 3 ditësh e mbante atë të lidhur

dhe pa ushqim. Kanë qenë të bërtiturat e 17-vjeçarit që kanë tërhequr vëmendjen e fqinjëve, të cilët kanë njoftuar policinë. Pas marrjes së denoncimit, policia me ndihmën e zjarrfikësve ndërhyr në banesë dhe shpëtuan 17-vjeçarin, i cili u dërgua për kontroll në spital dhe ndodhet në gjendje të rënduar psikike.





Në bazë të nenit 156, 157, 158, 159, 160 dhe 164-b të Ligjit për mbrojtje shëndetësore (Gazeta Zyrtare e RM nr. 43/12, 145/12, 87/13, 39/14, 43/14, 10/15, 154/15, 192/15, 17/16 dhe 37/16), Pëliqimi për punësim nga Ministria e financave nr. 18-6495 nga 06.06.2018 dhe 18-2259/2, 18-2264/2 dhe 18-2258/2 nga 26.02.2018 dhe 18-3212/2 nga 16.03.2018, Vendimit për publikim të shpalljes publike nr. 03-663/12 nga data 21.06.2018, u.d. Drejtori i IPSH KLINIKA UNIVERSITARE PËR NEUROKIRURGJI – SHKUP, publikon:

#### SHPALLJE PUBLIKE

për punësimin e 1 (një) doktor të medicinës specializant për neurokirurgji dhe 6 (gjashtë) motra medicinale me kohë të pacaktuar

1. IPSH KLINIKA UNIVERSITARE PËR NEUROKIRURGJI – SHKUP, ka nevojë për punësimin e:

- 1 (një) doktor të medicinës – specializant për neurokirurgji me kohë të pacaktuar dhe
- 2 (dy) motra medicinale me kohë të pacaktuar
- 3 (tre) motra medicinale me kohë të pacaktuar
- 1 (një) motra medicinale me kohë të pacaktuar

2. Kandidatët duhet ti plotësojnë **kushtet e përgjithshme** të vërtetura me Ligjin për mbrojtje shëndetësore:

- të jetë shtetas i RM,
- të jetë i moshës së rritur,
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore, dhe
- të mos jetë shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,

3. Përveç kushteve të përgjithshme të vërtetura me ligj kandidatët duhet ti plotësojnë edhe kushtet e **posaçme në vijim**:

#### Për kandidatin nga pika 1.1

- të ketë të mbaruar arsim të lartë me së paku 240 kredi sipas SETK apo shkalla VII/1- Fakulteti i medicinës

- provim të dhënë profesional
- licencë për punë
- suksesin e arritur për të gjitha lëndët të të gjitha cikleve të studimeve universitare të cilat i ka mbaruar kandidati të më së paku tetë (në tekstin e mëtejshëm: sukses mesatar) dhe

- në mënyrë aktive të njohë një nga tre gjuhët që shfrytëzohen të Unionit Evropian (angleze, gjermane apo frënge) në nivel B2 sipas kornizës së përbashkët Evropiane e referencës e gjuhës, mësimi dhe vlerisimi (Common European Framework of Reference for Languages: Learning, Teaching, Assessment) (në tekstin e mëtejshëm: CEFR dhe të posedojë certifikatë të pranuar ndërkombëtarisht të pranuar të dhënë nga testator oficial evropian, anëtar i shoqatës ALTE të testatorëve të nivelit B2 CEFR, gjegjësisht ELTS me 5-6 pikë, FCE, BEC, ILEC, IKFE, BULATS, apo TOEFL PBT me së paku 500 pikë, TOEFL CBT me së paku 175 pikë apo TOEFL IBT me së paku 60 pikë ose DELF, TCF, TEF, ose Goethe-Zertifikat, TestDaF.

- Kandidatët të kenë të filluar specializimin për neurokirurgji dhe të parashtrorë dokument me çka do të shihet se për momentin kanë filluar specializimin për neurokirurgji

- me dhe pa përvojë pune

njohja e gjuhës së huaj nga pika 3, përveç se me certifikata të njohura ndërkombëtare ose certifikata të përdorura ndërkombëtarisht, dëshmohej edhe me vërtetim për mbarim të ciklit të parë, të dytë ose të tretë të studimeve në një prej 200 fakulteteve më lartë të radhitura në Shanghai Ranking – ARWU (Academic Ranking of World Universities) të një prej tre gjuhëve më së shpeshti të përdorura të Bashkimit Evropian (angleze, frënge, gjermane), për të cilat studime kandidati posedon diplomë të nostrifikuar.

#### Për kandidatin nga pika 1.2

- Arsim sipëror të mbaruar 180 kredi – studime të mbaruar profesionale për motër medicinale

- Provim të dhënë profesional dhe
- Përvojë pune nga sfera e neurokirurgjisë në kohëzgjatje prej së paku 3 muaj
- Njohje të një prej tre gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (angleze, frënge, gjermane), edhe atë me posedim të certifikatës së njohur ndërkombëtarisht të dhënë nga testatori zyrtar evropian, anëtar i Shoqatës ALTE të testatorëve evropian, ose certifikatë nga institucion ndërkombëtar për njohje të një prej tre gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (angleze, frënge, gjermane) të nivelit A1 të CEFR, gjegjësisht BULATS ose Apts, ose TOEFL PBT me së paku 310 pikë, TOEFL CBT me së paku 35 pikë ose TOEFL IBT me së paku 10 pikë, ose DELF, TCF, TEF ose Gete Certifikatë.

#### Për kandidatin nga pika 1.3

- Arsim të mesëm të mbaruar të medicinës
- Provim të dhënë profesional dhe
- Përvojë pune nga sfera e neurokirurgjisë në kohëzgjatje prej së paku 3 muaj

#### Për kandidatin nga pika 1.4

- Arsim të mesëm të mbaruar të medicinës

- Provim të dhënë profesional dhe
- Përvojë pune nga sfera e medicinës në kohëzgjatje prej së paku 2 vjet
- 4. Me fletëparaqitjen kandidatët janë të obliguar ti dorëzojnë dokumentet në vijim:

#### Për kandidatin nga pika 1.1

- Fletëparaqitje me të dhëna për kontakt
- Biografi të shkurtë (CV)
- Diplomë me sukses mesatar
- Njohja e gjuhës së huaj dëshmohej me dorëzimin e një prej certifikatave të njohura ndërkombëtare ose certifikatave të përdorura ndërkombëtare: BULATS, CAE, IELTS, FCE, BEC, PET, KET, ILEC, TOEFL PBT, TOEFL CBT, TOEFL IBT për gjuhën angleze, gjegjësisht DELF, DALF, TCF, TEF, BULATS për gjuhën frënge, gjegjësisht Gete Certifikatë (Goethe-Zertifikat), TestDaF dhe BULATS për gjuhën gjermane ose certifikatë tjetër të njohur ndërkombëtare të dhënë nga testatori zyrtar evropian, anëtar i shoqatës ALTE të testatorëve evropian ose organizatave të tjera ndërkombëtare të B2 nivelit të Kornizës së përbashkët referuese evropiane për mësim, ligjërimit dhe vlerësim të gjuhëve (CEFR).

- Kandidatët të cilët kanë përfunduar ciklin e parë, të dytë ose të tretë të studimeve nga sfera e shkencave të medicinës në një prej 100 fakulteteve më të mirë të radhitura të Shanghai Ranking-ARWU (Academic Ranking of World Universities) nuk duhet të përbushin kushtet e posaçme të pikës 3 të kësaj shpallje, dhe as për punësimin e tyre nuk realizohet procedura e selektimit të kandidatit.

- Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, original ose kopje të vërtetuar në noter,

- Certifikatë të mjekut jo më të vjetër se 6 muaj, original ose kopje të vërtetuar në noter;

- Certifikatë se nuk është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, original ose kopje të vërtetuar në noter

- Certifikatë për fakultet të mbaruar të medicinës, në original ose kopje të vërtetuar në noter

- Certifikatë për provim të dhënë profesional, original ose kopje të vërtetuar në noter

- Licencë për punë, original ose kopje të vërtetuar në noter

- Dokument nga Katedra e kirurgjisë pranë Fakultetit të medicinës ose Fakulteti i medicinës – drejtimi për specializime, me çka dëshmohej se kandidati për momentin është në specializim për neurokirurgji – në original ose kopje të vërtetuar në noter.

#### Për kandidatin nga pika 1.2

- Fletëparaqitje me të dhëna për kontakt

- Biografi të shkurtë (CV)

- Dëshmi për kryerjen e Arsimit sipëror – drejtimi i motër medicinale/teknik medicinal profesional studime 180 kredi sipas SETK (original ose kopje të vërtetuar në noter)

- Dëshmi për provim të dhënë profesional, (original ose kopje të vërtetuar në noter)

- Dëshmi për përvojë pune (original ose kopje të vërtetuar në noter)

- Certifikatë të mjekut për gjendjen e përgjithshme shëndetësore, jo më të vjetër se 6 muaj, (original ose kopje të vërtetuar në noter);

- Certifikatë të shtetësisë, (original ose kopje të vërtetuar në noter)

- Certifikatë se nuk është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, jo më të vjetër se 6 muaj (original ose kopje të vërtetuar në noter)

- Njohja e gjuhës së huaj dëshmohej me dorëzimin e një prej certifikatave të njohura ndërkombëtare ose certifikatave të përdorura ndërkombëtare: BULATS, CAE, IELTS, FCE, BEC, PET, KET, ILEC, TOEFL PBT, TOEFL CBT, TOEFL IBT për gjuhën angleze, gjegjësisht DELF, DALF, TCF, TEF, BULATS për gjuhën frënge, gjegjësisht Gete Certifikatë (Goethe-Zertifikat), TestDaF dhe BULATS për gjuhën gjermane ose certifikatë tjetër të njohur ndërkombëtare të dhënë nga testatori zyrtar evropian, anëtar i shoqatës ALTE të testatorëve evropian ose organizatave të tjera ndërkombëtare të B2 nivelit të Kornizës së përbashkët referuese evropiane për mësim, ligjërimit dhe vlerësim të gjuhëve (CEFR).

#### Për kandidatin nga pika 1.3

- Fletëparaqitje me të dhëna për kontakt

- Biografi të shkurtë (CV)

- Dëshmi për kryerjen e Shkollës së mesme mjekësore (SHMM) për motër edhe atë Dëftesat nga të gjitha 4 (katër) vitet në të cilat është i theksuar suksesi i arritur në SHMM për çdo vit veçmas (original ose kopje të vërtetuar në noter)

- Dëshmi për provim të dhënë profesional, (original ose kopje të vërtetuar në noter)

- Dëshmi për përvojë pune (original ose kopje të vërtetuar në noter)

- Certifikatë të mjekut për gjendjen e përgjithshme shëndetësore, jo më të vjetër se 6 muaj, original ose kopje të vërtetuar në noter;

- Certifikatë të shtetësisë, (original ose kopje të vërtetuar në noter)

- Certifikatë se nuk është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, jo më të vjetër se 6 muaj (original ose kopje të vërtetuar në noter)

#### Për kandidatin nga pika 1.4

- Fletëparaqitje me të dhëna për kontakt

- Biografi të shkurtë (CV)

- Dëshmi për kryerjen e Shkollës së mesme mjekësore (SHMM) për motër edhe atë Dëftesat nga të gjitha 4 (katër) vitet në të cilat është i theksuar suksesi i arritur në SHMM për çdo vit veçmas (original ose kopje të vërtetuar në noter)

- Dëshmi për provim të dhënë profesional, (original ose kopje të vërtetuar në noter)

- Dëshmi për përvojë pune (original ose kopje të vërtetuar në noter)

- Certifikatë të mjekut për gjendjen e përgjithshme shëndetësore, jo më të vjetër se 6 muaj, original ose kopje të vërtetuar në noter;

- Certifikatë të shtetësisë, (original ose kopje të vërtetuar në noter)

- Certifikatë se nuk është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, jo më të vjetër se 6 muaj (original ose kopje të vërtetuar në noter)

**Kandidatët që kanë mbaruar arsimin përkatës jashtë vendit duhet të parashtrorë:**

- Diplomë të nostrifikuar me arsim përkatës
- Dokument për ekuivalencë të notave të dhënë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës

5. Komisioni për përzgjedhje të punëtorit shëndetësor me arsim sipëror bën përzgjedhjen e kandidatit në bazë të kriterëve në vijim:

-Mesataren e suksesit që kandidati ka arritur në institucionin për arsim sipëror – që mbanë 40 pikë

Pjesa/provimi kualifikues jepet para Komisionit për përpilimin e testeve, i formuar nga Ministria e shëndetësisë së Republikës së Maqedonisë. Provimi kualifikues, që mbanë gjithsej 60 pikë, përbëhet prej 2 (dy) pjesëve edhe atë:

-Pjesa profesionale (test) – që bartë 40 pikë dhe

-Njohja një prej gjuhëve të huaja (angleze, frënge dhe gjermane) – që mbanë 20 pikë

5.1 Komisioni për përzgjedhje të punëtorit shëndetësor me arsim të mesëm ose arsim të lartë bën përzgjedhjen e kandidatit në bazë të kriterëve në vijim:

-Mesatarja e suksesit që kandidati e ka arritur në arsimin mesëm, gjegjësisht në institucionin për arsim sipëror që bartë 50 pikë dhe

-Pjesa (testi) profesional që bartë 50 pikë.

Komisionin për përpilimin e testeve sipas të cilave jepet provimi profesional e formon Ministria e shëndetësisë së Republikës së Maqedonisë. Kandidatët do të informohen për ditën e dhënies së pjesës profesionale.

6. Orari i punës 40 orë në javë dhe neto pagesa bazë::

- për kandidatin nga pika 1.1 është 29.575,00 denarë

- për kandidatin nga pika 1.2 është 22.314,00 denarë

- për kandidatin nga pika 1.3 është 18.421,00 denarë

- për kandidatin nga pika 1.4 është 18.421,00 denarë

7. Afati për paraqitje në shpalljen publike është 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit.

8. Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, i pakompletuar dhe i parregulluar nuk do të merret parasysh nga ana e komisionit për selektim të kandidatëve

9. Pas selektimit të realizuar të kandidatëve të paraqitur për doktor të medicinës dhe motër medicinale të cilët i plotësojnë kushtet nga shpallja publike, do të realizohet provim kualifikues në pajtim me nenin 160 nga Ligji për mbrojtje shëndetësore.

10. Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e tërësishëm të nevojshëm dhe telefoni për kontakt të dorëzohen deri në IPSH KLINIKA UNIVERSITARE PËR NEUROKIRURGJI – SHKUP rr. “Nënë Tereza” nr. 17, përmes postës ose në arkivin e IPSH KLINIKA UNIVERSITARE PËR NEUROKIRURGJI – SHKUP, me shenjë për Shpallje publike për punësim.

IPSH KLINIKA UNIVERSITARE PËR NEUROKIRURGJI – SHKUP

Në bazë të nenit 241 paragrafi (1) të Ligjit për siguri në komunikacion rrugor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 169/15, 226/15, 55/16, 11/18 dhe 83/18) dhe nenit 50 të Rregullores për mënyrën e realizimit të provimeve për vozitje dhe kriterëve të përafërta në lidhje me kushtet hapësimore dhe pajisjeve materiale-teknike dhe informatike të qendrave për provim dhe mbajtjes së evidencave në lidhje me realizimin e provimeve për vozitje, si dhe mënyrën e dhënies dhe marrjes së licencës për qendër provimi, formën dhe përmbajtjen e formularit të licencës për qendër të provimit (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 139/16), Ministria e punëve të brendshme shpallë

## KONKURS PUBLIK

### PËR ZGJEDHJE TË SUBJEKTEVE JURIDIKE PËR MARRJE TË LICENCËS PËR QENDRA PROVIMI SHKUP DHE STRUMICË

**I.** Të drejtë për pjesëmarrje në konkursin publik për zgjedhje të personit juridik për marrje të licencës për Qendra për provim Shkup dhe Kumanovë (në tekstin e mëtejshëm: “konkurs publik”) ka çdo subjekt juridik, i cili i plotëson kushtet e parapara për punë me nenin 244 paragrafi (1) të Ligjit për siguri në komunikacionin rrugor, gjegjësisht:

- Të ketë kuadër profesional;
- Të ketë organizim të punës;
- Të ketë hapësira të rregulluara të pajisura me pajisje të posaçme (kamera) dhe kapacitete materiale-teknike;
- Të ketë autodrom komunikacioni (poligon) në seli dhe filiale në pronësi të së njëjtës qendër ose me qira, që përbushë kushtet e parashtruara dhe elementet e komunikacionit dhe ato teknike;
- Të ketë pajisje informatike për kryerje të punëve të nevojshme dhe
- Të ketë makina (personale ose me qira) të kategorive për të cilat qendra për provim është e autorizuar të kryejë testimin e kandidatëve për vozitës në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Krahas kushteve të theksuara me ligj, subjektet juridike duhet të përbushin edhe kriteret më të përafërta të përcaktuara me nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Rregullores për mënyrën e realizimit të provimeve për vozitës dhe kriteret më të përafërta në lidhje me kushtet hapësimore dhe pasjeve materiale-teknike dhe informatike të qendrave për provim, mbajtje të evidencave në lidhje me provimet e realizuara për vozitës dhe për formën dhe përmbajtjen e licencës për qendër për provim, gjegjësisht:

- Qendra për provim duhet të posedojë hapësira dhe pajisje materiale-teknike të nevojshme për kryerje të punëve të organizimit dhe realizimit të provimeve për vozitës për kandidatët për vozitës në pronë të qendrës për provim ose me qira.
- Në selinë e qendrës për provim duhet të ketë hapësira të posaçme për punë administrative të referentëve dhe komisioneve të provimeve, hapësirë për punë të udhëheqësit, hapësirë për punë të kontrollorit dhe të punësuarve të tjerë në qendrën për provim.
- Paraqitjen e provimit për vozitës kandidatët e bëjnë në hapësira të posaçme për paraqitje (vende për paraqitje), të cilat mund të jenë në pronësi të qendrës për provim ose me qira, të pajisura me pajisje informatike për paraqitje.
- Në selinë e qendrës për provim dhe në filialet e saj duhet të ketë hapësira të posaçme për mbajtjen e pjesës teorike të provimit për vozitës që sigurojnë kushtet për realizim të pjesës teorike të provimit për vozitës për së paku 30 kandidatë dhe të cilat duhet të jenë të pajisura me pajisje përkatëse informatike për realizim të pjesës teorike të provimit për vozitës për së paku 30 kandidatë për vozitës dhe të njëjtat mund të jenë në pronësi të qendrës për provim ose me qira. Në hapësirat duhet të vendoset edhe pajisja për video monitorim, e cila mundëson provim procesim të realizimit të pjesës teorike të provimit për vozitës. Për sigurimin e video monitorimit, hapësira (klasa) duhet të jetë e pajisur me kamera të cilat në pajtim me dimensionet dhe karakteristikat e hapësirës do të mundësojnë video xhirime kualitative që mundësojnë

njohje të kandidatëve për vozitës dhe komisionit të provimit, nga procesi i tërësishëm i realizimit të pjesës teorike të provimit për vozitës me mundësi për arkivim dhe dokumentim të materialit të xhiruar.

- Hapësira për realizim të pjesës teorike të provimit për vozitës (klasa) duhet të jetë me sipërfaqe prej së paku 1,5 m<sup>2</sup> për kandidatë për vozitës, gjegjësisht së paku pesë m<sup>2</sup> për komisionin e provimit, të pajisur me një tavolinë pune, një tabelë shkollore dhe mjete shkollore me mundësi për qartësim të mënyrës së realizimit të pjesës teorike të provimit për vozitës, ngrohje përkatëse, ventilim, ndriçim dhe pajisje sanitare.

- Qendra për provim duhet të posedojë pajisje informatike dhe aplikacione të licencuara përkatëse softuerike që mundësojnë realizim të provimit për vozitës, si dhe qasje për shfrytëzim të aplikacioneve për realizim të dhënies elektronike të pjesës teorike të provimit për vozitës dhe lidhje interneti në seli të qendrës për provim dhe në filialet prej së paku 4 mb/s të përshtatshëm kryesisht për dhënie elektronike të pjesës teorike të provimit për vozitës.

**II.** Numri minimal i komisioneve për provim për rajonin e qendrës për provim në Shkup, me vend për provim në Shkup, vende për provim në komunën Qendër, Karposh, Çair, Aerodrom dhe Gazi Babë, është së paku shtatë komisione për provim.

Numri minimal i komisioneve për provim për rajonin e qendrës për provim në Strumicë, me vend për provim në Strumicë, filiale dhe vende për provim në Radovish, Gjevgjeli dhe Vallandovë, vende për paraqitje në Strumicë, Radovish, Gjevgjeli dhe Vallandovë, është së paku tre komisione për provim.

**III.** Pjesëmarrësit në konkursin publik duhet të parashtrorë kërkesë dhe dokumente për përbushjen e kushteve për kryerje të punëve të qendrës për provim në pajtim me ligjin, në afat prej 25 ditëve nga dita e publikimit të konkursit publik, deri në Ministrinë e punëve të brendshme, rr. “Dimçe Mirçev” nr. 9, 1000 Shkup.

**IV.** Zgjedhja e subjekteve juridike i cili do të marrë licencë për Qendër për provim Shkup dhe Strumicë do të kryhet nga pjesëmarrësit e paraqitur në konkursin publik të cilët i plotësojnë kushtet nga pjesa e I të këtij konkursi publik, nga ana e Komisionit të Ministrisë së punëve të brendshme e formuar në pajtim me nenin 50 paragrafi (2) e Regullores për mënyrën e zbatimit të provimit për vozitës dhe kriteret e përafërta në lidhje me kushtet hapësimore dhe materiale-teknike dhe pajisje informatike të qendrave për provim dhe mbajtjen e evidencave në lidhje me provimet e zbatuara për vozitës si dhe për formën dhënies dhe marrjes së licencës për qendër për provim, formën dhe përmbajtjen e formularit të licencës për qendër për provim.

**V.** Në afat prej 15 ditë nga zbatimi për zgjedhjen e subjektit juridik, Ministria e punëve të brendshme do ta autorizojë Qendrat për provim Shkup dhe Strumicë në pajtim me organizimin e njësish përkatëse organizative-Sektoret për punë të brendshme të Ministrisë edhe atë Qendër për provim me seli në Shkup dhe Strumicë.

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME



# TAKSA NË RRUGËN E KOMBIT, SA DO PAGUAJNË MAKINAT DHE AUTOBUSËT?



Duke filluar nga data 17 shtator e këtij viti do të nisë zbatimi i kalimit kundrejt tarifës në aksin rrugor Milot-Morinë. Skema lehtësuese tarifore e pagesave për përdoruesit e rrugës në aksin Milot-Morinë është prezantuar nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë Damian Gjinkuri bashkë me Ministrin e Financave dhe Ekonomisë Arben Ahmetaj, të cilët zhvilluan një takim me përfaqësues nga Qarku i Kukësit, ku prezantuan paketën e negociuar me kompaninë koncesionare për skemën lehtësuese tarifore të kalimit në aksin Milot-Morinë për banorët.

## TARIFIMI I AUTOMJETEVE TË BANORËVE TË QARKUT TË KUKËSIT

Tarifë prej 100 lekë me TVSH për 1 kalim për të gjithë automjetet e regjistruara në Qarkun Kukës.

Tarifa e reduktuar do të jetë e kufizuar për jo më shumë se 44 kalime në

muaj dhe e vlefshme për tu përdorur brenda peridhës 1 mujore nga data e kryerjes së pagesës për këto kalime. Përdoruesit e Qarkut Kukës do të parablejnë në mënyrë të përshkallëzuar deri në 44 kalime me këtë tarifë të reduktuar. Kjo skemë tarifore do të aplikohet për klasën e automjeteve A dhe B për përdorim vetjak, të regjistruara në Qarkun Kukës. Për automjetet e cilësuar më lart, të regjistruara në Qarkun e Kukësit, do të marrin falas pajisjen elektronike Telepass dhe përmes saj do bëjnë rimbushjen e vlerës së kalimeve mujore sipas nevojës;

## TARIFIMI I AUTOBUSËVE TË LINJËS

Janë identifikuar 11 Linja të licencuara autobusësh që kryejnë udhëtimet nga dhe për në qytetin e Kukësit. Për të eliminuar efektin e tarifës në koston e udhëtimit të banorëve të Qarkut Kukës, këto linja do përfshihen

në skemën preferenciale. Këto mjete do të kenë tarifë Kalimi prej 100 lekë me TVSH për 1 kalim.

Tarifimi i përdoruesve të shpeshtë të rrugës pavarësisht vendosjes së tyre (kryesisht bizneset nga Shqipëria dhe Kosova): Nga 20 deri në 30 kalime në muaj, përdoruesi i shpeshtë do të përfitojë një zbritje në masën 10%. Mbi 30 deri në 50 kalime në muaj, përdoruesi i shpeshtë do të përfitojë një zbritje në masën 20%; Mbi 50 deri në 60 kalime në muaj, përdoruesi i shpeshtë do të përfitojë një zbritje në masën 30%; Mbi 60 kalime në muaj, përdoruesi i shpeshtë do të përfitojë një zbritje në masën 40%;

Efekti financiar në Buxhetin e Shtetit për këtë paketë lehtësuese: Shteti shqiptar duhet të paguajë koncesionarit në 30 vitet e kontratës 48.5 milion Euro si rezultat i zbatimit të këtyre tarifave të reduktuara për banorët e Qarkut Kukës, mjetet e transportit publik në këtë zonë dhe përdoruesit e shpeshtë.

Shteti shqiptar duhet të paguajë koncesionarit në 30 vitet e kontratës 48.5 milion Euro si rezultat i zbatimit të këtyre tarifave të reduktuara për banorët e Qarkut Kukës, mjetet e transportit publik në këtë zonë dhe përdoruesit e shpeshtë.

# Në cilat vende punohet më së shumti nga shtëpia?

Kjo shifër ishte më e larta në Holandë (13.7%), pasuar nga Luksemburgu (12.7%) dhe Finlanda 12.3%), dhe më të ulëtat në Bullgari (0.3%) dhe Rumaninë (0.4%)

Përqindja e personave të punësuar nga 15 deri në 64 vjeç në Bashkimin Evropian (BE), të cilët punojnë nga shtëpia, ishte në 5.0% në 2017. Kjo shifër ishte më e larta në Holandë (13.7%), pasuar nga Luksemburgu (12.7%) dhe Finlanda 12.3%), dhe më të ulëtat në Bullgari (0.3%) dhe Rumaninë (0.4%). Punësimi nga shtëpia ishte më pak i zakonshëm në zonën e euros (5.7% e të punësuarve) sesa në BE në tërësi, shkruan 'monitor'.

Përqindja e personave të punësuar në BE që ndonjëherë punojnë nga shtëpia është rritur vazhdimisht gjatë viteve, nga 7.7% në vitin 2008 në 9.6% në vitin 2017, megjithëse shifra në vitin 2017 ishte pak më e ulët nga viti 2016 (9.8%).

Në BE, më shumë të vetëpunësuar zakonisht punonin nga shtëpia (18.1%) sesa pu-

nonjësit (2.8%). Kjo ishte në të gjitha shtetet anëtare, përcjell albinfo.ch.

Në vitin 2017, një përqindje pak më e lartë e grave në BE zakonisht kanë punuar nga shtëpia (5.3%) sesa burrat (4.7%). Megjithatë, në disa shtete anëtare, situata ishte e kundërta, me më shumë burra zakonisht punonin nga shtëpia sesa gratë. Kjo ishte dukshëm në Holandë (14.7% e meshkujve, krahasuar me 12.6% të femrave) dhe Danimarka (9.5% në krahasim me 7.6%).

Frekuenca e punës nga shtëpia rritet me moshën. Vetëm 1.6% e 15-24 vjeçarëve në BE zakonisht punuan nga shtëpia në 2017, duke u rritur në 4.7% të 25-49 vjeçarëve dhe 6.4% të 50-64 vjeçarëve. Përqindja më e madhe e 15-24 vjeçarëve që punonin rregullisht nga shtëpia u regjistrua në Luksemburg (10.4%), përpara Holandës (4.2%).

Për kategoritë e tjera të moshës, Holanda kryeson (14.8% e 25-49 vjeçarëve dhe 16.6% e 50-64 vjeçarëve), e ndjekur nga Finlanda (13.1% e 25-49 vjeçarëve dhe 13.6% e 50-64 vjeç).

Publicitet

Në bazë të neneve 156, 157, 158, 159, 160 dhe 161 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë 43/2012; 145/2012; 87/2013; 164/2013; 39/2014, 43/2014, 132/2014, 188/2014, 10/2015, 61/2015, 154/2015, 192/2015, 17/2016 dhe 37/2016), nenit 7, paragrafi 1 e Marrëveshjes kolektive për veprimtari shëndetësore në Republikën e Maqedonisë" nr. 60/06 dhe 60/10), Rregulloren për organizim dhe sistematizim të vendeve të punës të IPSH Shtëpia e shëndetit Strumicë dhe pëlqimit për punësim nga Ministria e financave me nr. 18-6494/2 të datës 06.06.2018 dhe pëlqimit nga Ministria e shëndetësisë nr. 09-4082/2 të datës 21.05.2018, drejtori i IPSH Shtëpia e shëndetit – Strumicë publikon.

## SHPALLJE PUBLIKE Për punësim të punëtorëve shëndetësor

**IPSH Shtëpia e shëndetit Strumicë** ka nevojë për themelim të marrëdhënies së punës për kohë të pacaktuar të punës për vendin e punës në vijim.

### 1. Doktor të medicinës – shtatë (7) realizues

Kandidatët e interesuar për paraqitje në shpallje duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme dhe të posaçme për punësim në pajtim me Ligjin për mbrojtje shëndetësore:

#### Kushtet e përgjithshme

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- të jetë i moshës së rritur
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore
- të mos i është kryer ndalese e plotfuqishme për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose obligimit

#### Si dëshmi për përmbushjen e kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të parashtrorin dokumentet në vijim:

- Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- Certifikatë të mjekut jo më të vjetër se 6 (gjashtë) muaj (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalese e plotfuqishme për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose obligimit jo më të vjetër se 6 (gjashtë) muaj (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)

#### Kushtet e posaçme

- Arsim sipëror të mbaruar – Fakulteti i medicinës (shkalla VII/1) ose 240 kredi sipas SETK
- Provim të dhënë profesional
- Posedim të licencës për punë
- Njohje të një gjuhe të huaj (angleze, frënge ose gjermane)

#### Si dëshmi për përmbushjen e kushteve të posaçme, kandidatët duhet të parashtrorin dokumentet në vijim:

- Fletëparaqitje me të dhëna për kontakt
- Biografi të shkurtër (CV)
- Vërtetim për provim të dhënë profesional (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- Licence për punë si doktor i medicinës (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- Deklaratë për njohje të një gjuhe të huaj (angleze, frënge ose gjermane)

#### Kandidatët të cilët kanë mbaruar arsimin përkatës jashtë vendit duhet të parashtrorin:

- Diplomë të nostrifikuar me arsim përkatës
- Dokument me ekuivalencë të notave, të dhënë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Orari i punës është 40 orë në javë, pagesa do të paguhet sipas marrëveshjes kolektive për shëndetësi. Pagesa fillestare është 25.970 denarë (për vendin e punës nr. 1)

Afati për paraqitje të shpalljes publike është **5 (pesë) ditë pune** nga dita e shpalljes.

Si ditë e parë e publikimit do të konsiderohet dita e publikimit të fundit në gazetën ditore.

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e nevojshme të parashtrorin në arkivin e IPSH Shtëpia e shëndetit Strumicë ose përmes postës rekomanduese në adresën IPSH Shtëpia e shëndetit Strumicë rr. Mladinska nr. 2 Strumicë, me shenjë "për shpallje".

Dokumentacioni jo në kohë, i pakompletuar dhe jo i rregulluar nuk do të jetë lëndë për shqyrtim nga ana e komisionit për selektim të kandidatëve.

Përzgjedhja dhe zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në pajtim me nenet 160 dhe 161 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 43/2012; 145/2012; 87/2013;164/2013; 39/2014, 43/2014, 132/2014, 188/2014, 10/2015, 61/2015, 154/2015, 192/2015, 17/2016 dhe 37/2016).

Pas përzgjedhje së kandidatëve të paraqitur që kanë përmbushur kushtet në pajtim me shpalljen publike do të realizohet test kualifikues në pajtim me nenin 160 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore.

IPSH Shtëpia e shëndetit Strumicë  
Drejtor



REPUBLIKA E MAQEDONISË  
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nënpusëve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nënpusëve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rejshe gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

## SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 84/2018

për punësimin e 2 nëpunësve shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Komunën e Delçevës” për vendet e punës në vijim:

1. UPR0101B04000 Udhëheqës i njësisë së menaxhim me resurset njerëzore 1 realizues(ë)

#### Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

#### Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkenca juridike ose punë sociale dhe politikë sociale
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

#### Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij

- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësims strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

#### Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

#### Orari i punës :

- Diët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00

Rroga neto: 28.309,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

2. UPR0101B02000 Udhëheqës i sektorit për çështje finansiare 1 realizues(ë)

#### Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

#### Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkenca ekonomike
- më së paku 5 (pesë) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 2 (dy) vjet udhëheqës në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 8 (tetë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 3 (tre) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

#### Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësims strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

#### Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

#### Orari i punës :

- Diët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00

Rroga neto: 35.872,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 20 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit të Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit të Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.


Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejt në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.



# Identiteti kombëtar e besimi fetar 1:0 për përçarësit



nga  
Mirishahe Limani Hiler

Dy gola të shënuara nga Zvicra u festuan nga lojtarët duke i bashkuar të dyja duart për të formuar një shqiponjë me dy koka, simboli i flamurit të Shqipërisë. Që të dy golshenuesit, lojtarë zviceranë, në një moment gëzimi ekstrem, kanë shprehur në mënyrë simbolike identitetin e tyre të dyfishtë, shprehje, që është liria e tyre më e pastër. Por kjo çoi në këmbë nacionalistët zviceran në UDC (Unioni demokratik qendror) të acaruar të mbyten para këtij simboli, duke e parë shprehjen e tyre si sjellje të keqe, ose më keq një tradhëti të ngjyrave zvicerane, duke kërkuar një polemikë që është rrenjosur kryesisht në mendjengushtësinë e tyre.

Kësaj euforie nacionaliste të një formacioni politik të se djathtës extreme ketu, i kanë ndihmuar me shkrimet e tyre në rrjete sociale edhe disa zviceran me origjinë nga Kosova të cilët në shtetin helvetik të ngjajnë të jone « me katolik se Papa ».

## MEDIAT ZVICERANE

Shumica e mediave vendore dhe popullata zvicerane janë shprehur njezërit: Lojtarët tanë janë të lirë për të festuar qëllimin e tyre ashtu siç e shohin të arsyeshme. Ata janë të lirë të thërassin shpirtrat dhe identitetet që i frymëzojnë. Disa ngrenë dy gishta në qiell, të tjerët bëjnë një shenjë të kryqit, të tjerë hjekin bluzën e tyre për të treguar vizatimin « tatouage » e fytyrës së femijes së tyre të porsalindur; ose përkujtojnë një të dashur të ndjerë, kur disa thërassin Allahun Akbhar në momentin kur ata shënojnë goal. E cka tani?

Duhet të jesh me të vërtetë mendjengusht për tu thirrur në sekularizem e për të kritikuar një lojtar futbollit i cili do të bëjë shenjën e kryqit kur hynë në fushë, apo edhe në atë që është një shenjë individuale e që i përket atij. E gjithë kjo mund të jetë sulm kundër çdo grupi ose feje që i takon ai.

Ti takosh një apo me shumë grupe identitare, secili është i lirë t'i jetojë ato siç edhe e sheh të arsyeshme për t'i shprehur, përveç nëse duam lojtarë të tipit robotik dhe të sanitar. A mendoni ju se mund të ndodhë që partia nacionaliste e Zvicres mund të bëjë një mocion në parlament duke i kërkuar policisë federale të kontrollojë përmbajtjen e tatuazheve të lojtarëve tanë? Qesharake, apo?

Në të njëjtën mënyrë, do të ishte absurde të mendosh se do ta tradhëtonte Zvicrën nëse një lojtar do t'i bënte një shenjë zemre gruas së tij në vend

që të vë dorën e tij në fanelën e tij, në gjoksin e majt, në vendin e kryqit zviceran.

Anetarët e kesaj partie nacionaliste, idete e të cileve i perqafojnë dhe i manifestojnë edhe disa nga të migruarit e Kosovës duan që lojtarët e ekipit të tyre shtetëror të jenë ushtarë të mirë, të paktën të gjithë identikë dhe të fillonin me ideologjinë e tyre totalitare.

## LOJTARËT NUK JANË BAGËTI NË PRONËSI TË NJË KLUBI APO VENDI

Xhaka dhe Shaqiri sot janë zviceran që të dy nga një shtet i ri që sot është Kosova, prej nga kanë rrenjet e origjinës së tyre. Të dy kanë zgjedhur të luajnë për Zvicrën. Këta janë lojtarë profesionistë të cilët janë trajnuar në kete shtet dhe me të cilët të gjithë jemi krenarë. Ata tani praktikojnë profesionin e tyre në Angli, duke u endur me identitete të shumta, e gjithashtu supozojmë se ata do të kërkojnë t'i njohin edhe ato identitete.

Sulmet e atyre që sot drejtohen kah Shaqiri apo Xhaka tregojnë mbi të gjitha: karakter nacionalist, jotolerant dhe totalitar të partive extreme të djathta, karakter ky që sot nuk është më në linjë me popullsinë zvicerane dhe as me atë kosovare ku kerkohet të krijohen probleme nderfetare.

Është e lodhshme të shihet se për

disa, në Zvicër ka ende klasë të ndryshme, sidomos të atyre që fatmirsisht janë të pakte, që kanë problem me afirmimin e identitetit të tyre të dyfishtë. Zvicranet e « gjenerates se dyte » « secondos », ata të natyralizuar, zviceranet me origjinë të huaj, ata që bëjnë shqiponjën dhe ata që nuk e bëjnë, të dyshohet se nuk janë zviceran të denjë është pretendim për tendosje, pak a shumë për të mos i respektuar ata dhe arritjet e tyre.

Të gjitha këto dallime janë absurde dhe të parëndësishme për shumicën e shoqërisë zvicerane. Ashtu siç është absurd edhe reagimi i gazetarit Enver Robelli kur cenon të drejtën personale të besimit fetar të Xherdan Shaqirit.

Kur një njëri është zviceran, është zviceran, pikë. Kur një njeri është shqiptar, është shqiptar pikë. Të gjithë mund të hani Fondue apo Flija ose jo, të beni shenjën e kryqit apo jo, të kryeni obligimet e Ramazanit apo jo, të bartni shqiponja, lule të vogla ose lotus me gishta të tij, secili sipas besimeve të tij, lirisë, kreativitetit, dhe shtetit që i takon por e gjithë kjo nuk autorizon askënd për kategorizim dhe të bëjë dallimin në mes asaj çfarë është thelbësore e Zvicrës apo jo.

Mbi të gjitha kjo nuk autorizon askënd për të degraduar apo kritikojnë

**Shumica e mediave vendore dhe popullata zvicerane janë shprehur njezërit: Lojtarët tanë janë të lirë për të festuar qëllimin e tyre ashtu siç e shohin të arsyeshme. Ata janë të lirë të thërassin shpirtrat dhe identitetet që i frymëzojnë. Disa ngrenë dy gishta në qiell, të tjerët bëjnë një shenjë të kryqit, të tjerë hjekin bluzën e tyre për të treguar vizatimin « tatouage » e fytyrës së femijes së tyre të porsalindur; ose përkujtojnë një të dashur të ndjerë, kur disa thërassin Allahun Akbhar në momentin kur ata shënojnë goal.**



Shaqirin e Xhaken për simbolikën e identitetit të dyfishtë të tyre, duke pretenduar të jetë norme jo standarde e këtij shteti.

Ka partie në Zvicër që gjithëmonë ka kërkuar të krijojë ndarje midis zviceranëve dhe të huajve. Tani në mesin tone ka zë që po kërkon të krijojë ndarje midis shqiptarëve të Ballkanit në momentin kur të gjithë komunikojnë me gëzim.

Liria e shprehjes tënde është deri aty ku fillon të preket liria e shprehjes time.

Është pjesa më e madhe e popullatës zvicerane, që me gjithë zemër dëshiron për ekipin tonë kombëtar të futbollit më shumë fitore dhe gëzime, më shumë diversitet dhe më shumë liri, sepse ato janë energji pozitive, fryt i punës së vështirë dhe qëllimeve të larta.

Atyre që nuk e kuptojnë llojllojshmerinë kulturore në Zvicër dhe atyre që i pengon shprehja e simboleve të origjinës apo të besimit të tyre fetar, mundemi vetëm t'i japim një « karton të kuq » që më në fund të dilte nga fusha ku loja e tij agresive dhe e vogël është një burim trazire dhe përçarjeje.

Kjo është gjëja më e mirë që ne mund të dëshirojmë për Kosovën dhe Zvicrën tonë të bukur, aq të pasur në diversitetin e saj.

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e diel 24 qershor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006  
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA  
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221  
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772



# Faktorizimi i shqiptarëve të Zvicrës

Nga  
Daut DAUTI/LONDËR



**P**a marrë parasysh se çka flasin injorantët, budalenjtë, gojëkëqinjët dhe anti shqiptarët dhe pa marrë parasysh se si do të përfundoj ky kampionat botëror i futbollit, Xherdan Shaqiri, sipas ekspertëve dhe shtypit britanik të sportit, i ka siguruar vehtes vend solid në 'Top World Players'. Prandaj, është paralajmëruar një garë e madhe në mes ekipeve angleze për marrjen e Shaqirit në mesin e tyre. Momentalisht çmimi i Shaqirit në tregun britanik është 123 milionë funta me tendencë të rritjes.

Ky fakt shënon histori jo vetëm për Shaqirin por edhe për Zvicrën dhe tërë shqiptarët. Gëzimi duhet të jetë edhe më i madh nëse e kemi parasysh që edhe Xhaka, Behrami e Xhemalji nuk janë larg Shaqirit.

Këta futbollist edhe një herë e sollën Kosovën në faqet e para të shtypit botëror duke bërë me dije për problemet të cilat ende i rëndojnë mardhëniet shqiptaro-serbe që po e mbajnë Ballkanin të tensionuar.

Por, pozitivitetin e këtyre futbollistëve duhet ta shohim në kontributin e tyre në Zvicër, në të cilin vend, komuniteti shqiptar është më i rëndësishmi në Evropë. Për



shkak të tyre, Zvicra për herë të parë, ka festuar privatisht nëpër shtëpi dhe publikisht nëpër shtete. Kjo është një shënjë e cila vërteton që shqiptarët në Zvicër nuk duhet të jenë inferiorë. Pa marrë parasysh se çka mendojnë djathtistët zviceranë, të cilët më shumë se shpesh kanë shfaqur tendencë fashiste ndaj shqiptarëve, komuniteti shqiptar është bërë faktor i rëndësishëm në këtë vend.

Në Zvicër shqiptarët nuk janë të rëndësishëm vetëm në futboll, në 'baushtella' e restorante. Ata, gjithnjë e më të rëndësishëm janë duke u bërë në të gjitha fushat tjera të ekonomisë dhe i gjenë duke

shënuar sukses në vendet më të specializuara, përfshirë edhe sallat e operacioneve të komplikuara të spitaleve me renome në këtë vend.

Edhe përkundër këtij suksesi, shqiptarët, pa nevojë, ende vuajnë nga barra e inferioritetit që e bartin nga e kaluara. Por, kjo nuk duhet të zgjas shumë pasi që gjeneratat e reja janë duke e thyer këtë barrierë. Barrierë do të thyhej më shpejt sikur shqiptarët ta kishin zërin e tyre në sferën publike të Zvicrës. Ky zë duhet të lajmërohet së shpejti dhe të bëjë me dije se shqiptarët e duan Zvicrën sikur zviceranët e shpesh më shumë se vetë zviceranët. Shqiptarët në Zvicër janë për të je-

tuar aty për gjithmonë dhe kjo duhet të pranohet nga zviceranët por edhe nga shqiptarët të cilët duhet ta ndjenjë veten zviceranë. Prandaj, shqiptarët në Zvicër duhet të pranohen si pjesë e plotësisë së shoqërisë zvicerane me të gjitha karakteristikat poseduese.

Derisa të ndodhë kjo, do të balafaqohemi ende me deklarata të individëve dhe organizatave që shkaktojnë pezmatim në të dyja anët. Por, kur shqiptarët e marrin vendin e merituar në Zvicër, më nuk do t'i shihni duart e tyre duke u bërë shqiponjën. Vizitat e tyre në Kosovë, së bashku me dërgesat e parave, do të rrallohen dukshëm

Në Zvicër shqiptarët nuk janë të rëndësishëm vetëm në futboll, në 'baushtella' e restorante.

Ata, gjithnjë e më të rëndësishëm janë duke u bërë në të gjitha fushat tjera të ekonomisë. Edhe përkundër këtij suksesi, shqiptarët, pa nevojë, ende vuajnë nga barra e inferioritetit që e bartin nga e kaluara. Barrierë do të thyhej më shpejt sikur shqiptarët ta kishin zërin e tyre në sferën publike të Zvicrës.

Ky zë duhet të lajmërohet së shpejti dhe të bëjë me dije se shqiptarët e duan Zvicrën sikur zviceranët e shpesh më shumë se vetë zviceranët.

# Dy duar për një ... SHQIPONJË

Nga  
Ardian Vehbiu



**P**ër gjestin e shqiponjës nga Xhaka dhe Shaqiri në ndeshjen mbrëmë kundër Serbisë dhe polemikat pasuese: Shqiponja është shenjë tribale, që i referohet përkatësisë etnike. Dy lojtarët gëzuan EDHE si shqiptarë që janë.

Me sa di unë, nuk është shenjë që i referohet dhunës; nën të nuk janë bërë gjekundi as vrasje as masakra.

Atë gjest e kanë bërë dhe vazhdojnë ta përfushin gjithfarë figurash të pashijshme, batakinj, hipokritë, parazitë, shfrytëzues – por le të mos e identifikojmë akoma me kombëtarizmin kitsch të anti-serbëve të kolltukut.

Le të mos e braktisim në DUART e tyre.

Nga ana tjetër, nuk mund t'u kërkosh as Shaqirit dhe as veçanërisht Xhakës të harrojnë se nga vijnë dhe cilët janë. Ndjenjat e



Ka një kulturë të tifozerisë dhe të futbollit serb, që themelohet mbi dhunën, fyerjen, racizmin dhe provokimin. E pamë para disa vjetësh, se çfarë ndodhi në Beograd, kur tanëve u thyen karriget në kokë. Futbollit nuk mbahet dot steril nga politika; përkundrazi, mund të na kujtojë se çfarë ka që nuk shkon në politikë, mes të tjerash, edhe RACIZMI anti-shqiptar i tifozerive serbe.

përkatësisë etnike nuk lihen siç lihet duhani.

Historitë e tyre personale etnike dhe familjare janë ndikuar – për keq dhe hidhtas – edhe nga politikat nacionaliste të Serbisë (lexoni).

Ne, që i pamë duke bërë shenjën, i pamë në televizion. Nuk ishim ATJE. Mbase edhe nuk e ndiem sa duhet atmosferën e neveritshme që kishin krijuar, në stadium, disa tifozë të Serbisë.

(Këtë e përmendi edhe Licht-

steiner, kapiteni i ekipit zviceran. Ky e ka mirë parasysh se, për qëndrime të tilla në Itali kundër lojtarëve me ngjyrë – nga Koulibaly te Niang dhe Matuidi, klubeve u janë vënë gjoba të rënda.)

Të vërehet edhe se gjesti i fundit i Shaqirit, që hoqi fanelën dhe u tregoi muskujt tifozëve, nuk ishte gjest vanitoz alla Cristiano Ronaldo, por citim i një gjesti të ngjashëm të Balotelli-t: statujë e revoltës anti-raciste.

Nëse na thonë se gjeste të tilla janë provokuese dhe duhen shmangur në një kompeticion sportiv, mua më vjen në mend që PROVOKACIJA, edhe në kontekste të tilla, zakonisht ka filluar nga ana tjetër.

Ka një kulturë të tifozerisë dhe të futbollit serb, që themelohet mbi dhunën, fyerjen, racizmin dhe provokimin. E pamë para disa vjetësh, se çfarë ndodhi në Beo-

grad, kur tanëve u thyen karriget në kokë.

Futbolli nuk mbahet dot steril nga politika; përkundrazi, mund të na kujtojë se çfarë ka që nuk shkon në politikë, mes të tjerash, edhe RACIZMI anti-shqiptar i tifozerive serbe.

Le që, si çdo sport tjetër kompetitiv, edhe futbollit është dhunë e ritualizuar, që shpesh rimerr – në trajta të pranueshme – rivalitetet që përndryshe do të ishin ndezur dhe shuar në fusha jo stadiumesh, por betejash.

Është gjithnjë më mirë që shqiptarët të ndeshen me serbët në futboll.

Dhe më në fund, si dikush që nuk impresionohet fort nga gjestet etnike teatrale, po e them se, po të kisha qenë mbrëmë në fushë dhe të kisha shënuar gol, do ta kisha bërë edhe unë shqiponjën.

Bravo Zvicra, për fitoren



## Rebiç refuzon fanellën e Messit

Lojtari i përfaqësueses kroate Ante Rebiç ka refuzuar të shkëmbejë fanellën me superyllin argjentinas Lionel Messi në përfundim të takimit të fituar 3-0 nga ballkanasit. "Të them të drejtën, kisha planifikuar përpara ndeshjes që të merrja fanellën e Messit. Për një mikun tim, i cili e admiron. Por argjentinasit më kanë lënë një përshtypje të keqe. Kështu që nuk e doja më atë fanellë," shprehet Rebiç për "goal.hr". "Ata më kanë befasuar me sjelljen e tyre dhe mungesën e 'Fair play'. Për të mos folur për provokimet e tyre gjatë gjithë ndeshjes. Duhet të dish edhe të humbasësh dhe në fund të ndeshjes të urosh kundërshtarin", deklaroi Rebiç.



## Kosta rrezikon Botërorin

Mesa duket Brazili gjithmonë do të vuajë në kompeticionet ndërkombëtare për shkak të dëmtimeve. Nëse në vitin 2014 ishte Neymar ai që e penalizoi ekipin brazilian për të ecur përpara, tani duket se do të jetë Douglas Costa ai që do të mungojë, një nga më të mirët në fushë në ndeshjen ndaj Kosta Rikës. Lojtari i Juventusit ka marrë një dëmtim në kofshë dhe nuk do të jete i gatshëm për ndeshjen e ardhshme dhe është në dyshim për gjithë Botërorin. Është vet mjeku i kombëtares që thotë: "Testet kanë treguar një dëmtim muskullor. Lojtari nuk do të udhëtojë me ekipin për ndeshjen e ardhshme, do të qëndrojë në Soçi për të punuar me qëllimin që të riaftësohet sa më parë. Një lajm shumë i keq ky për trajnerin Tite i cili e konsideron Kostën një titullar të padiskutueshëm pas paraqitjes që ky i fundit bëri në ndeshjen ndaj Brazilit."

# SIMBOLET E XHAKËS DHE SHAQIRIT DHE MUNDËSIA E DËNIMIT

Sipas "Telegraph", duke qenë se edhe Shqipëria edhe Kosova janë anëtare të FIFA-s dhe flamujt e tyre shpalosen në ndeshje ndërkombëtare, vështirë mund të ndodhë që dy futbollistët të dënohen për thyerje të rregullave duke shfaqur simbole politike. Megjithatë, Neni 54 i Kodit Disiplinor e konsideron të paligjshme atë që definohet si "provokim i publikut të përgjithshëm", një vepër që dënohet me dy ndeshje moslojë.



Ndeshja ndërmjet Zvicrës dhe Serbisë në kuadër të Kampionatit Botëror ka nxitur kundërtënie të ndryshme lidhur me simbolet e futbollistëve shqiptarë që përfaqësojnë Helvetikët. Në fitoren prej 2-1, golashënues ishin pikërisht Granit Xhaka dhe Xherdan Shaqiri, që të dy shqiptarë nga Kosova, të cilët në festën e tyre bënë simbolin e shqiponjës me duar. Për më shumë, në këpucët e Xherdanit, në njërin ndodhet flamuri i Zvicrës, kurse në tjetrën flamuri i Kosovës. Federata serbe e futbollit

ka kërkuar nga FIFA që dy lojtarët shqiptarë të dënohen për përdorimin e "flamujve të ndryshëm kundërtënes" në ndeshjen e të premtës mbrëma në Kaliningrad. Në ndërkohë është raportuar se organizata më e madhe e futbollit në botë ka nisur një hetim në lidhje me procedurat eventuale disiplinore kundrejt Xhakës dhe Shaqirit. Sipas "Telegraph", duke qenë se edhe Shqipëria edhe Kosova janë anëtare të FIFA-s dhe flamujt e tyre shpalosen në ndeshje ndërkombëtare, vështirë mund të ndodhë që dy futbollistët të



dënohen për thyerje të rregullave duke shfaqur simbole politike. Megjithatë, Neni 54 i Kodit Disiplinor e konsideron të paligjshme atë që definohet si "provokim i publikut të përgjithshëm", një vepër që dënohet me dy ndeshje moslojë. Në ditët në vijim pritet të shihet se cili do të jetë vendimi i FIFA-s për dy mesfushorët shqiptarë.

Ndërkohë, në lidhje me të njëjtën ndeshje, janë hapur procedurat disiplinore edhe kundër Federatës serbe "për turbullim të turmave dhe shfaqjen e mesazheve politike dhe fyese nga tifozët serbë". Për më tepër, është hapur një hetim paraprak kundër trajnerit Mladen Krstajić, për deklaratat e dyshuara të bëra pas ndeshjes së përmendur.

## RUSIA KALON BRAZILIN PAS PREZANTIMIT TË VAR?

### Botërori i penalltive

Kupa e Botës 2018 në Rusi ka parë më tepër penallti të dhëna sesa në komplet botërorin e kaluar. Goli i Karlos Velas që luan te Meksika ndaj Koresë së Jugut ishte i 14-i, një më shumë se i gjithë botërori i Brazil 2014. Me prezantimin e VAR për të parën herë në një Kupë Bote, një rekord i ri i penalltive mesa duket është duke u bërë, dhe shifra mund të jetë akoma më e madhe duke parë se edhe sa ndeshje na

kanë mbetur. Që kur filloi Opta të regjistronte statistikën e saj më 1966, rekordi i më shumë penalltive të akorduara është te 18-a, e cila ka ndodhur më 1990, 1998 dhe 2002. Nga 14 të akorduarat deri tani, 11 prej tyre janë realizuar – Messi, Sigurdsson dhe Kueva i Perusë e kanë humbur. Vetëm një penallti e akorduar nga arbitri në fushë është anuluar nga VAR, ajo e Neymar ditën e premtë ndaj Kosta Rikës.



## PORTIERI SERB TREGON HALLIN MË TË MADH PASI I SHËNAUN SHQIPTARËT

### Nuk e di çfarë t'i them mamasë

Serbia ka humbur me rezultatin 1-2 ndaj Zvicrës në takimin e djeshëm, në një takim që është përfolur prej shumë kohësh dhe shkaktoi polemika. Kjo pasi të dy golat e realizuar për zvicëranët, erdhën nga ana e futbollistëve shqiptarë, Xhaka dhe Shaqiri të cilët zgjodhën të festonin me shqiponjë realizimet e tyre. Në një intervistë për "B92", portieri i Serbisë ka treguar përjetimet e humbjes ndaj Zvicrës, ndërsa ka thënë se problemi i tij më i madh është përgjigja ndaj mamasë së tij. "Nëse dikush do të më thoshte atë që ndodhi para ndeshjes, nuk do ta besoja. Sa e vështirë është tani. Nuk di çfarë ti them mamasë sime tani. Le të përpiqemi të bëjmë një mrekulli. Kjo është një përgjegjësi



si e madhe. Ne nuk mund të dalim nga lëkura, nuk e di se çfarë po bëhet kështu, shumë gjëra të tilla na ndodhin. Por ne duhet të besojmë, si një ekip, të gjithë ne. Të gjithë 40 personat që jemi në ho-

tel duhet të besojmë, nuk na ka mbetur asgjë tjetër. S'ka dyshim se kjo është humbja ime më e keqe në karrierë. Unë nuk qaj lehtë, por dje nuk mund t'i ndalja lotët", tha Stojković.



## BOTËRORI PO HUMB “FENOMENËT”



# RONALDO “YLLI POLAR”

Botërori “Rusi 2018” duhet të ishte skena ku do të shkëlqenin katër futbollistë të jashtëzakonshëm, protagonistë absolutë gjatë sezonit me klubet e tyre. Të përherëshmit Ronaldo, Messi, Neymar dhe i katërti, ai që i mahni të gjithë, Mohamed Sallah. Perspektiva të ndryshme, ambicie dhe me një synim të vetëm, të dhurojnë spektakël, por deri më tani këto pritshmëri janë zbathur vetëm për gjysmën prej tyre, sepse Sallah dhe Egjipti i tij po bëjnë gati valixhet për t’u kthyer në shtëpi, ndërsa për Messin frika që t’i ndodhë e njëjta gjë është e madhe. Messi kundër

botës, që i ka sytë nga ai, madje edhe duke e kritikuar për formën e treguar. Jashtëtokësori e sheh veten në vështirësi. Problem taktik, i grupit të skuadrës dhe mbi të gjitha ka mbi vete presionin që i rivali i tij, Krisiano Ronaldo, ka arritur kuotën e katër golave në vetëm dy ndeshje. Sigurisht që aftësitë e tyre askush nuk ka guxim t’i vë në diskutim, pavarësisht se “yllit” të Barcelonës me kombëtaren i mungon shkëlqimi. Ndaj Islandës nuk mundi dot të finalizonte nga pika e bardhë e penalltisë. Neymar, ndërkohë, nuk shihet të jetë në formë, madje shpesh i kritikuar për

faktin se më shumë mendon për pamjen e tij, duke harruar që është një futbollist dhe jo një “pop-star”, si dhe për simulimet e panumërta. Ai që po shijon magjinë e Botërorit është Kristiano Ronaldo. “Ylli” i madrilenëve po përjeton një sezon të jashtëzakonshëm. Në moshën 33-vjeçare rendimenti i tij është përtej parashikimeve. Këta janë personazhet që kanë pasur edhe më shumë vëmendje mediatike gjatë sezonit, por, sigurisht, në këtë botëror ka edhe “yje” të tjerë si Harri Kin, Romelu Lukaku apo Diego Kosta, të cilët në ndeshjet e para kanë lënë gjurmët e tyre.

Perspektiva të ndryshme, ambicie dhe me një synim të vetëm, të dhurojnë spektakël, por deri më tani këto pritshmëri janë zbathur vetëm për gjysmën prej tyre, sepse Sallah dhe Egjipti i tij po bëjnë gati valixhet për t’u kthyer në shtëpi, ndërsa për Messin frika që t’i ndodhë e njëjta gjë është e madhe, Neymar, ndërkohë, nuk shihet të jetë në formë, derisa ai që po shijon magjinë e Botërorit është Kristiano Ronaldo. “Ylli” i madrilenëve po përjeton një sezon të jashtëzakonshëm



## KROOS I LUMTUR PËR GOLIN Të gjithë na donin të eliminuar

Ishte Toni Kroos në minutën e fundit shtesë ai që vendosi ndeshjen dytë të fazës së grupeve ndaj Suedisë me një gol magjik nga goditja e dënimit që erdhi nga një pozicion shumë i pjerrët, thuajse i pamundur. Ishin suedezët ata që kaluan të parët në avantazh, por në pjesën e dytë kampionët e botës arritën të përmbysin gjithçka, dhe Kroos është kthyer në hero pas gabimit që i dha mundësinë suedezëve të shënonin golin e parë. “Duhet ta fitonim patjetër këtë ndeshje dhe ia arritëm”, është shprehur Kroos. “Shumë njerëz donin që ne të largoheshim para kohe nga kjo Kupë Bote, edhe gjermanë, por nuk do t’ia bëjmë aq të lehtë. E merituar fitoren, ushtruar presion, dhe megjithëse nuk krijuam shumë, në fund mjaftoi për të fituar. Tani nuk kemi shumë kohë për të pushuar pasi kemi ndeshjen e radhës ndaj Koresë të cilën duhet ta fitojmë patjetër”, deklaroi Kroos. Në anën tjetër trajneri i Gjermanisë, Joakim Lev ka folur pas ndeshjes së fituar ndaj Suedisë. “Ky ishte një triler, i mbushur me emocione dhe një udhëtim me ‘rollercoaster’ deri në fishkëllimën e fundit”, ka thënë fillimisht Lev pas ndeshjes. “Pas pranimit të golit, ne kemi mbajtur nivelin, kemi thënë që na duhej të kalonim më shpejtë, të mbulonim terrenin për të lodhur Suedinë dhe pastaj të hapnim hapësira, të cilat ne ishim në gjendje të bënim. Në pjesën e dytë presioni që ne ndërtuam ishte gjithnjë e më i fortë. Ne natyrisht nuk kemi shënuar në disa mundësi të pastra, por ajo që vlerësova ishte fryma e ekipit. Kurrë nuk kemi humbur shpresën që ne të mund ta kthejmë rezultatin dhe të fitojmë këtë ndeshje”, përfundoi trajneri gjerman.

## Të gjithë kundër Sampaolit, vjen vendimi i federatës

Nuk është një Botëror normal për Argjentinën. “Albiceleste”, në fakt, është në kaos total. Lajmi që qarkulloi mbrëmjen e së shtunës ishte i bujshëm: lojtarët kanë kërkuar zyrtarisht largimin e Sampaolit nga kombëtarja para ndeshjes me Nigerinë. Presidenti i Federatës Argjentinase të Futbollit, Klaudio Tapia, ka pranuar fillimisht kërkesën e lojtarëve, por ka ndryshuar mendim më



mbropa pas një takimi me vetë trajnerin, duke e konfirmuar këtë të fundit. Në fakt Tapia ka mbledhur bordin drejtues dhe më pas u ka komunikuar disa prej lojtarëve kryesorë të ekipit që është vendosur që Sampaoli të mos shkarkohet, të paktën derisa të mbarojë Rusi 2018. Një situatë e më shumë unike se e rrallë, që nuk ishte verifikuar kurrë më parë. Grupi nuk ka më besim tek trajneri dhe lojtarët, pasi kanë kuptuar se trajneri nuk mund të shkarkohet (do të përfitonte një dëmshpërblim prej 16 milion eurosh), i kanë kërkuar federatës që ta marrin ata kontrollin e ekipit nga ky moment e në vazhdim. Kaosi është total dhe të martën është ndeshja me Nigerinë. Kush do ta drejtojë ekipin?

## ASNJË REZULTAT 0-0 NË 26 NDESHJET E PARA



# Botërori i golave

Golat janë ingredientit më i dashur në futboll dhe kur në Botëror shënohet shumë atëherë evenimentit i injektohen dozat e duhura të bukurisë. Rezultati më i urryer për fansat është 0-0. Të shohësh më shumë se 90 minuta futboll dhe të mos përjetosh emocionet e një goli nuk është entuziazmuese. Për fat të mirë Kupa e Botës deri më tani nuk i ka dhënë këtë pakënaqësi askujt. Për herë të parë në një Botëror nuk është regjistruar asnjë rezultat i bardhë në 26 ndeshjet e para të kompeticionit. Janë realizuar 58 gola gjithsej, për një mesatare prej 2.23 golash për ndeshje, një statistikë e ëmbël për të gjitha

ata që e duan futbollin spektakolar. Natyrisht mund të ketë edhe persona të apasionuar pas lojës mbrojtëse, të cilët janë të lumtur kur një ndeshje nuk ka gola, megjithatë këta janë në minorancë. Ndërkohë që një tjetër e dhënë mjaft interesante ka të bëjë me golat e shënuar në 5 minutat e fundit. 11 gola janë shënuar në fragmentet finale, pra pothuajse 20% e tyre janë realizuar në mbyllje të takimeve. Një Botëror që ndoshta nuk ka një skuadër superfuqi si Spanja në 2010 apo edhe Gjermania 4 vite më parë, por që po dhuron magjinë e golave, me shpresën që kjo tendencë tërheqëse të vijojë deri më 15 korrik.



Skuadra e Azerbajxhanit, Karabag, i ka ofruar 600 mijë euro klubit italian dhe një kontratë të rëndësishme portierit, mirëpo Fiorillo këtë ofertë e ka refuzuar derisa ka shpjeguar arsyet e vendimit të tij me një postim në "Instagram"

"Paratë nuk janë gjithçka", këto janë fjalët e Vincenzo Fiorillo, portieri 28-vjeçar i Peskarës, kur i është paraqitur mundësia për të shkuar te një skuadër që luan në "Champions League". Skuadra e Azerbajxhanit, Karabag, i ka ofruar 600 mijë euro klubit italian dhe një kontratë të rëndësishme portierit, mirëpo Fiorillo këtë ofertë e ka refuzuar derisa ka shpjeguar arsyet e vendimit të tij me një postim në "Instagram". "Nuk i kam pëlqyer kurrë postimet të tilla, por sot kam qenë i detyruar ta bëj një të tillë. Luftoj prej katër vitesh me këtë fanellë, duartrokitje, kritika, kundërshti. Kam humbur një finale në sekondat e fundit, kam fituar një kampionat, kam qenë protagonist në disa momente dhe kam kaluar disa momente muti!", shkroi në fillim portieri 28-vjeçar,




## Interi përgatiti goditjen e radhës në merkato

Mousa Dembele është objektiv numër një i Interit në mesin e fushës tani që marrëveshja për Ragja Nainggolan përfundoi, por "Sky Sport Italia", ka zbuluar se zikaltrit gjithashtu po studiojnë mundësinë e blerjes së Uilliam Karvalo. Mesfushori portugez është ndër lojtarët që ka prishur kontratën me Sporting Lisbonë pas një sulmi në qendrën stërvitore të tifozëve ultras disa javë më parë. Megjithatë 26-vjeçari është një lojtar i lirë, eksperti i merkatos Di Marzio paralajmëron se Interi dhe çdo klub tjetër që kërkon të nënshkruajë me lojtarin mund të përballet me gjyqin e Sportingut, që do të refuzojë prishjet e kontratave të lojtarëve. Interi i Inter për Karvalon ka kohë që dihet pas zikaltrit kanë provuar edhe herë të tjera për të blerë mesfushorin defensivë.

## HISTORIA E RRALLË

# I THOTË JO PARAVE DHE ÇAMPIONSIT PËR SERINË B

Instagram



për të vazhduar më pas: "Por e kam respektuar gjithmonë këtë fanellë në të gjitha këto momente. Kam bërë disa deklarata të rëndësishme dhe zakonisht nuk flas sa për të folur. Kam vetëm një siguri dhe një


ëndërr, madje dy: të kthehem në Serie A me këtë fanellë dhe të provojë veten nga fillimi në fund pa parë në sy askënd, siç kam bërë gjithmonë. Ndoshta një ditë mund të jem kapiten! Falënderoj skuad-

drën e Karabag që është mundur të më bindë në të gjitha mënyrat. Por mendoj se paratë nuk janë gjithçka, kur gjithçka që më duhet është në këtë qytet, në këtë stadium", ka shkruar Fiorillo.

## BOMBA E MERKATOS

# 100 mln për Barcelonën, 150 për lojtarin

Një bombë e merkatos ka ardhur nga Spanja. Sipas "Don Balon", Luis Suarez është gati t'i thotë lamtumirë Barcelonës. Një zgjedhje kjo që mund të ketë një efekt domino në merkaton. Edhe pse e ardhmja e sulmuesit do të ishte në Kinë, ku do të bëhej më i paguari në botë. Heber Fortune, skuadra e Maskeranos, mësohet të jetë gati të paguajë rreth 100 milionë euro për të siguruar Suarezin, i cili do të përfitonte edhe një rrogë marramendëse. Barcelona e ka marrë në konsideratë ofertën, sepse mendon se uruguaiani ka kaluar kulmin dhe është drejt rënies. Atëherë do të ishte më mirë të



shitej larg Evropës, veçanërisht nëse ky supozim i katalanasve do të ishte i gabuar. Suarez, nga ana e tij, do të fitonte 150 milionë euro në tre vite. Një shifër që do të linte në hije rrogën e Neymar dhe do ta

bëntë atë më të paguarin në botë. Për momentin, Suarez është i përqendruar tek Uruguai i tij dhe te Botërori. Por, me shifra të tilla në lojë, do të jetë e pamundur që të mos tundohej.

## NË RAST SE MILIARDERI AMERIKAN BLENË MILANIN

# Gattuso rrezikon shkarkimin



Tomas Ricketts, miliarderi 55-vjeçar amerikan që interesohet për të blerë Milanin, duket se nuk ka ndërmend t'i besojë Xhennaro Gattusos nëse bëhet pronar i kuqezinjve. Në harkun e pak ditëve, milanezët do të njohin emrin e ortakut të ri. Gjithçka do të ndodhë para afatit të vendosur nga fondi Elliot për kthimin e 32 milionë eurove të derdhura për rritjen e kapitalit dhe para udhëtimit në Lozanë për të apeluar vendimin e UEFA-s për përjashtimin e ekipit nga kompeticionet evropia-



## Liverpuli ofron 180 milionë euro për Asension

Liverpuli e ka bërë yllin e Real Madridit, Marko Asension, objektivin kryesor në afatin kalimtar të janarit. Skuadra e madhe angleze arriti në finale të Ligës së Kampionëve, por u mposht nga Real Madridi me rezultat 3-1. Kjo humbje e hidhur ka bërë që drejtuesit e Liverpoolit të mendojnë për përforsimin edhe më të madh të skuadrës për sezonin e ri. Pas transferimit të Naby Keitas nga Red Bull Leipzig dhe Fabinjos nga Monako, klubi anglez ka kthyer vëmendjen në La Liga te Reali. Është mesfushori me tipare sulmuese, spanjoll Asensio, i cili pëlqehet shumë nga skuadra nga "Anfield", të cilët kanë bërë një ofertë për shërbimet e tij. Sipas mediumit spanjoll "Mundo Deportivo", "Reds" kanë ofruar plot 180 milionë euro për mesfushorin e Mbretërve, Asensio. Mesfushori ka një klauzolë prej 700 milionë eurosh në kontratën e tij, ndërsa menaxheri i ri Julen Lopetegui është i prirë për të mbajtur 22-vjeçarin. Megjithatë, ata do të shqyrtojnë ofertën e Liverpoolit, me Jurgen Klopp që po kërkon më shumë ekspozitë dhe përforsime në mesfushë.

ne, që duket i pashmangshëm. Kështu, tifozët kuqezinj duhet të përgatiten për një tjetër përmbysje brenda ekipit. Ata që do të marrin drejtimin, në fakt, mund t'i japin jetë revolucionit të radhës dhe askush nuk do ta kishte vendin e sigurt. As Fassone me Mirabellin, por as Rino Gattuso, i cili, sipas mediave italiane, do të zëvendësohej nga Antonio Conte. Kjo situatë po ndiqet nga jashtë edhe nga Paolo Maldini, i cili mund të ketë një rol drejtuesi në klub nëse ndryshon pronësia.



Shkëndija ka barazuar 1:1 me skuadrën sllovene Domzhale në ndeshjen e parë kontrolluese të kësaj faze përgatitore. Elmir Asani i cili është në provë tek kuqezinjtë barazoi shifrat në minutën e 75-të, ndërsa debutuan përforcimet e reja

## SHKËNDIJA BARAZON NË TESTIN E PARË ME DOMZHALEN



## De Laurentis përfundimisht nuk e lëshon Hysajn

Elseid Hysaj nuk largohet nga Napoli. Është ky vendimi i presidentit të klubit jugor, Aurelio De Laurentiis, i cili nuk ka aspak ndërmend të humbasë mbrojtësin shqiptar. Madje, siç raporton gazeta italiane "Il Mattino", numri një i klubit po mendon edhe për rinovimin e kontratës së lojtarit, për të mos i lënë asnjë lloj hapësire çdo oferte që mund të vijë nga skuadra të tjera. De Laurentiis po punon që Hysaj të firmosë një kontratë të re me një klauzolë shumë më të lartë se aktualja (50 milionë euro). Ish-tekniku i Napolit, Maurizio Sarri, pritet që shumë shpejt të marrë drejtimin e Çellsit dhe një ndër emrat kryesorë që ai kërkon të marrë me vete në Londër është pikërisht mbrojtësi kuqez, me të cilin ka një bashkëpunim të hershëm që nga koha kur të dy ishin pjesë e Empolit. Ky interesim i vazhdueshëm duket se nuk i pëlqen aspak presidentit De Laurentiis, i cili është gati ta blindojë 24-vjeçarin. Hysaj gjithashtu shihet si i pashtishëm edhe për teknikun e ri të Napolit, Karlo Ancelotti, i cili beson shumë tek aftësitë e shkodranit.

# OSMANI VLERËSON PARAQITJEN E EKIPIT

Shkup, 24 qershor - Skuadra e Shkëndijës të shtunën zhvilloi ndeshjen e parë kontrolluese në kuadër të të përgatitjeve verore në Slloveni edhe atë para pjesëmarrjes në eliminatoret e "Champions League". Rezultati 1:1 me Domzhale sllovene sigurisht ishte në plan të dytë në një ndeshje ku stafi teknik testoi formën dhe nivelin momental të skuadrës në këtë periudhë kohore. Duke llogaritur ngarkesën që kanë futbollistët në seancat stërvitore shumë e natyrshme ishte të ndjehet lodhje, megjithëse skuadra solli momente të mira para se gjithash në kombinatorikë por që përfundonte pa sukses në fazën finale. Kuqezinjtë nisën në sulm dhe në dhjetë minutat e para u kanosën Radeskit dhe Junior por pa mundur të ndryshojnë rezultatin. Përgjigjet Domzhale që kërkon shansin e saj, ndërsa sjell ndryshim në minutën e 28-të kur Ibriçiç shënon për epërsi 1:0. Sllovenët kishin edhe një tjetër kanosje që ndalet nga Zahov, ndërsa deri në fund të

## IMERI I BASHKOHET SHKËNDIJËS

Pas largimit nga FC Shkupi, Omar Imeri i është bashkuar radhëve të kampionit aktual Shkëndija me të cilët ka nënshkruar kontratë deri në vitin 2021. Lajmin për transferimin e 18-vjeçarit te skuadra tetovare e konfirmuan edhe nga klubi por edhe vetë futbollisti pasi u prezantua në fanellën kuqezi. "Jam shumë i lumtur që më jepet rasti të firmos me Shkëndijën. Të gjithë e dinë se për çfarë ekipi



bëhet fjalë, skuadër që rritet nga viti në vit, sezonin e fundit dominuan kampionatin vendor duke fituar të dy titujt ndërsa tashmë ca vite përfaqësohet suksesshëm edhe në Evropë. Ndjehem krenar të jem në këtë mjedis, ku besoj të vazhdoj të zhvillohem si futbollist për të dhënë kontributin tim në sukseset e ardhshme dhe për të arsyetuar besimin e drejtuesve të klubit", deklaroi Imeri.

pjesës së parë kuqezinjtë nuk mundën të barazojnë përkundërtentimeve të Eminit, Bejtullait dhe Shefitit.

Në pauzën mes dy pjesëve trajneri Osmani bëri më shumë ndryshime, duke u dhënë në vazhdim mundësi të luajnë futbollistëve që kishte në bankinë ndërsa kanosjen e parë e sollën vendasit kur në minutën e 51 nuk mundën të realizojnë nga një situatë tejet ideale. Shkëndija shpejt u konsolidua dhe filloi të krijojë lojë, por nuk ishin konkretë në finalizim. Gjithsesi ba-

razimi do të vinte në minutën e 75-të kur goditja e Elmir Asanit përfundon në rrjetën e sllovenëve për 1:1.

Shefi i stafit teknik Qatip Osmani ka vlerësuar paraqitjen e ekipit në ndeshjen e parë kontrolluese në fazën përgatitore në Slloveni, duke potencuar se lodhja në këtë periudhë është normale. Ai beson se ekipi do të vazhdojë progresin për të qenë gati deri në ndeshjen e parë të eliminatoreve të "Champions League". "Ndeshja e parë kontrolluese ku pamë gabime të cilat janë rezul-

tat i fazës përgatitore, domethënë lodhjes. Edhe pse në pjesën e parë dhe të dytë luajtën dy ekiye, mendoj se duhet të jemi të kënaqur dhe prapë e përsëris edhe pse ka gabime, të njëjtat duhet ti përmirësojmë dhe të mos na përsëriten në ndeshjet tjera. Qëllimi i këtyre ndeshjeve është përgatitja fizike dhe në ditët në vazhdim me punën që na pret duhet të hymë në finalizimin e ekipit me të vetmin qëllim që sa më mirë ta presim ndeshjen me TNS në kuadër të ndeshjes së Ligës së kampionëve", deklaroi Osmani.



## Gashi asiston në fitoren e Kolorados

Shkëlzen Gashi po rigjen pak nga pak formën e tij më të mirë në "Major League Soccer". I aktivizuar në pjesën e dytë të sfidës, Gashi u bë protagonist në fitoren 3-2 të Kolorado Rapids ndaj Minnesota. Vetëm pesw minuta pasi kishte hyrë në fushë, futbollisti shqiptar shërbeu me një asistim perfekt Mason i cili realizoi duke barazuar shifrat në 2-2 dhe duke hapur rrugë suksesit të Kolorados. Jahmir Hyka ndërkohë u hodh në fushë vetëm në minutën e 78-të në barazimin që San Hose arriti në transfertë përballë Real Salt Lejk.

## Tirana zyrtarizon Bllazhevskin

Shkup, 24 qershor - Skuadra e K.F. Tirana ka përforcuar radhët e saja me ish-futbollistin e Vardarit, Dejan Bllazhevski. Sulmuesi 32-vjeçar maqedonas ka nënshkruar kontratë një vjeçare me 24-herë kampionët e Shqipërisë, bëri të ditur "SuperSport", transmeton gazeta KOHA. 32-vjeçari prej katër vitesh ka qenë titullar i padiskutueshëm tek Var-

dari duke u shpallur në tre raste kampion i Maqedonisë. Ndryshe, në edicionin e shkuar Bllazhevski gjeti rrugën e rrjetës në tetë raste, ndërsa gjithsej me fanellën e Vardarit ka realizuar 36 gola. Sezoni më i mirë në karrierë ka ardhur më 2013-2014-ën kur ishte pjesë e Turnovës, Bllazhevski e mbylli edicionin me 19 gola. Ai ka qenë edhe pje-

së e përfaqësueses së Maqedonisë ku është aktivizuar në pesë takime duke shënuar një gol. Numrat në karrierën e Bllazhevskit janë një kartëvizitë optimiste, megjithatë mbetet për t'u parë nëse ai do të përshtatet apo jo me kampionatin shqiptar. Ai pritet të formojë dyshen e sulmit së bashku me Mikael Ngoo duke qenë se Bllazhevski ak-




tivizohet edhe si anësor apo si sulmues i dytë. Klubi bardheblu ka nisur të vendosë në këtë mënyrë pike-tat në kuadër të rikthimit në Superiore.



FIBA përmes faqes zyrtare ka shprehur ngushëllimet familjes dhe miqve të basketbollistit

## FIBA ngushëllon familjen Sinani

Gazmend Sinani, që të shtunën ka vdekur në një aksident trafiku. "Me trishtim të madh FIBA mori lajmin për vdekjen e përfaqësuesit të Kosovës, Gazmend Sinani, 27 vjeçar, që vdiq në një aksident trafiku ku u lënduan edhe lojtarët Granit e Fisionik Rugova, Altin Morina dhe fiziote-rapeuti Kujtim Shala. FIBA iu shpreh ngushëllime familjes, miqve, bashkëlojtarëve dhe të gjithë të prekurve", thuhet në faqen zyrtare të FIBA-së, transmeton gazeta KOHA. Më tutje



FIBA shkruan se, "kjo është një goditje tragjike për Federatën e Basketbollit të Kosovës, hidhërimi i të cilit ndahet nga FIBA dhe gjithë komuniteti i basketbollit në të gjithë botën". FIBA shton se do të punojë me Federatën e Basketbollit të Kosovës për të ofruar të "gjithë ndihmën e nevojshme për familjen e Sinanit dhe të gjithë atyre që janë prekur nga kjo tragjedi". Ndërkohë, Gazmend Sinani të shtunën pasdite u varros në varrezat në Prishtinë.



Komisioni Evropian javën e ardhshme pritet të publikojë raportin vlerësues mbi progresin në drejtim të plotësimit të kushteve nga institucionet e Kosovës për liberalizimin e vizave. Drita e gjelbër finale për vizat varet shumë nga ky raport që do të tregojë nëse vendi e ka plotësuar kriterin e fundit për vizat – luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Në një përgjigje për IndeksOnline, zyrtarë nga Komisioni Evropian janë shprehur se vlerësimi për luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit është ende duke vazhduar.

“Në vitin 2016, Komisioni paraqiti propozimin e tij për liberalizimin e vizave për Kosovën, me kushtin se deri në ditën e miratimit të këtij propozimi nga Parlamenti dhe Këshilli Evropian, Kosova do të ketë ratifikuar marrëveshjen e demarkacionit të kufirit me Malin e Zi dhe përforcuar të dhënat e saj në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Kosova me 21 mars ka ratifikuar Marrëveshjen për Ndarjen e Kufirit me Malin e Zi. Kur bëhet fjalë për luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, vlerësimi vazhdon”, thuhet në

# KOSOVA KA ENDE PUNË NË KRITERIN E FUNDIT PËR VIZAT



këtë përgjigje.

Ndërsa, institucionet europiane kanë shtuar që nëse janë plotësuar kushtet, propozimi i Komisionit duhet të miratohet formalisht nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli.

Në anën tjetër, Komisioneri evropian për Migracion dhe Çështje të Brendshme, Dimitris Avramopoulos, nuk ka treguar ndonjë afat për liberalizimin e vizave, por është shprehur optimist që së shpejti edhe Kosova do të mund të udhëtojë lirisht nëpër zonën Schengen.

“Kosova i ka plotësuar disa kushte kyçe si demarkacionin, mirëpo ka akoma punë në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Ne jemi duke monitoruar dhe

është një proces që po vazhdon. Shumë shpejtë çështja e vizave do të përfundojë për gjithë rajonin perëndimor të Ballkanit”, ka thënë ai.

Këtë muaj zyrtarët politikë kanë lobuar në disa vende të BE-së për fituar mbështetje e tyre në procesin e liberalizimit të vizave.

Ndërkohë, Ministria e Integritetit Evropian, Dhurata Hoxha ka thënë se institucionet e Kosovës kanë arritur të bindin BE-në se Kosova ka kapacitet të kryejë detyrat e saj lidhur me procesin e liberalizimit të vizave. “Prej kur janë caktuar 95 kushte, institucionet e Kosovës kanë qenë subjekt i vlerësimit rigoroz, kemi arritur t’i bindim institucionet e BE-së se Kosova ka ka-

pacitet të zbatojë detyrat e saj. Tani me ratifikimin e demarkacionit procesi është në duart e Bashkimit Evropian”. “Ne synojmë të ofrojmë materiale shtesë dhe çfarëdo tjetër që gjatë këtij viti të kryhen procedurat institucionale për në BE, ky synim do hapa të sigurtë. Institucionet e Kosovës kanë kryer detyrat e veta, përgjegjësia është në duar të BE-së që në afat të shkurtër kohor të fillojë vendimarrja”.

Këto deklarata, ajo i bëri gjatë raportimit në Komisionin për Integritet Evropian. Kurse, sa i përket luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar nuk mund të ketë një përqindje të caktuar, sepse në vazhdimësi prodhohen rezultate.



## Edhe Pacolli pjesë e fazës finale të dialogut

Ministri i Punëve të Jashtme i Kosovës, Behgjet Pacolli, është duke marrë pjesë në takimin e parë të fazës finale për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Pacolli bashkë me presidentin Thaçi janë duke marrë pjesë në këto bisedime që janë duke u ndërmjetësuar nga përfaqësuesja e lartë e BE-së, Frederica Mogherini



## Sattler: Austria, pro hapjes së negociatave me Shqipërinë

Ambasadori i Austrisë në Tiranë, Johann Sattler, deklaroi në një intervistë për Agjencinë Telegrafike Shqiptare se java tjetër do të jetë një javë interesante në Bruksel.


“Është një votim vendimtar. Austria do të votojë në favor. Ne jemi në favor të hapjes së negociatave dhe mendoj se është e merituar”, ka thënë Sattler.

Por, sipas tij, kjo nuk do të thotë se Austria është e kënaqur me gjithçka që Qeveria shqiptare ka bërë këto vite. “Ka ende shumë fusha ku duam të shohim përparim. Por kjo do të thotë se është bërë mjaftueshëm për të votuar ‘pro’, absolutisht! Ne mendojmë se Shqipëria i ka përmbushur kushtet. Ne mendojmë qartësisht se gota është më shumë se gjysmë plot”, ka shtuar Sattler.

## Uashington: Pavarësia dhe sovraniteti i Kosovës janë të përhershme

Komiteti për Punë të Jashtme i Dhomës së Përfaqësuesve ka thënë se pretendimet e Serbisë se shtetet po ia kthejnë shpinën Kosovës, janë të rreme. Në një postim në Twitter, ky Komitet ka thënë se “pavarësia dhe sovraniteti i Kosovës janë të përhershme”.

“Pretendimet mashtruese të Serbisë se shtetet po ia kthejnë shpinën Kosovës janë të rreme dhe po shkaktojnë zemërim në mbarë botën. Serbia duhet të ndalë këtë dhe të kthehet në normalizimin e raporteve me fqinj e saj. Pavarësia dhe sovraniteti i



Kosovës janë të përhershme”, thuhet në postimin në Twitter.

Edhe Eliot Engel, anëtar i Komitetit për Punë të Jashtme i

Dhomës së Përfaqësuesve në SHBA, ka thënë se pretendimet “mashtruese” të Serbisë për tërheqje të njohjeve për Kosovën, janë

krejtësisht të rreme.

Në një postim në Twitter, Engel ka thënë po ashtu se shteti serb duhet të heq dorë nga kjo politikë pasi pavarësia e Kosovës është e pakthyeshme.

“Pretendimet mashtruese të Serbisë se vendet po ua kthejnë shpinën Kosovës, janë mashtruese dhe po shkaktojnë zemërim të madh nëpër botë. Serbia duhet të ndalojë këtë dhe t’i kthehet normalizimit me fqinjin e saj. Pavarësia e Kosovës dhe sovraniteti i saj janë të përhershme”, ka deklaruar Engel.

## “Pazari i Ri” merr çmimin si projekti i Rinovimit më i mirë për 2018

Pas çmimit për sheshin “Skënderbej”, vjen një tjetër çmim për kryeqytetin. Bëhet fjalë për “Pazarin e Ri”, i cili ka fituar çmimin si projekti i Rinovimit 2018 nga Emerging Europe Awards (EEA) në Londër. Çmimi u tërhoq nga nënkryetari i Bashkisë Arbjaz Mazniku, i cili shpjegoi projektin e rehabilitimit të Pazarit të ri.

“Për ne shqiptarët është inku-

rajuese që patëm në listën e shkurtër dy projekte, përfshirë edhe “Pazarin e Korçës”, një tregues i qartë se programi i Rilindjes Urbane ka dhënë efekte madhore në rivitalizimin e qyteteve tona”.

Pazari i Ri u përzgjedh fitues pas konkurrencës me nëntë kandidatë të tjerë, si qendra historike e Timishoarës, salla e tregut 100-vjeçar të Varshavës “Koszyki”, she-

shi Mynta në Lviv (Ukrainë) etj.

Juria vlerësoi ndërthurjen e trashëgimisë kulturore me arkitekturën moderne të Pazarit të Ri, ku shumë nga elementët tradicionalë të qytetit të vjetër janë ruajtur.

Gjithashtu, pazari i Ri u konsiderua edhe si një model inovativ i biznesit, pasi është një qendër tregtare që përfshin 308 biznese dhe siguron 1,007 vende pune.





Këto zgjedhje kanë një veçori tjetër dhe se aktualisht Turqia bashkë me këto zgjedhje po kryen një revolucion demokratik, u shpreh presidenti aktual Recep Tayyip Erdogan. Nuk ka pengesa për delegacionin e OSBE-së, ne vazhdojmë të vëzhgojmë zgjedhjet në metodologjinë që ne kemi përdorur gjithmonë, tha Shefja e delegacionit monitorues të zgjedhjeve të byrosë së Institucioneve Demokratike dhe të Drejtave të Njeriut të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), ambasadorja Audrey Glover

# TURQI, NË PRITJE TË ERDOGANIT



gjithë Turqia e tregojnë këtë. Teksa në zgjedhjet e kryer në botë pjesëmarrja është tek 30 përqindësi, Turqia i ka tejkaluar këto. Pjesëmarrja në 85 përqind në zgjedhjet e fundit tregon përparimin e demokracisë, nivelin e pjekurisë demokratike në Turqi", tha Erdoğan, duke folur për gazetaret, raporton Anadolu Agency. Sipas një njoftimi të KQZ së Turqisë, rreth 99% të qendrave janë mbyllur ne orën përcaktuar. Në garën presidenciale morën pjesë gjashtë kandidatë: Rexhep Taip Erdogan, Dogu Perinçek, Meral Aksener, Muharem Inxhe, Selahatin Demirtash dhe Temel Karamolaoglu. Përderisa në zgjedhjet parlamentare marrin pjesë tetë parti të bashkuara në dy koalicione pa-

razgjedhore. Njëra është Aleanca Kombëtare (apo Aleanca republikane) e përbërë nga Partia në pushtet e Drejtësisë dhe Zhvillimit dhe Partia e Lëvizjes Kombëtare, ndërsa jozyrtarisht është e mbështetur nga Partia e Unitetit të Madh. Në zgjedhje krahas partive të dy koalicioneve të mëdha morën pjesë edhe tre parti tjera - Partia Popullore Demokratike prokurde dhe Partia e Atdheut Huda-par. Koalicioni tjetër është Lidhja e Kombit, e përbërë nga Partia Republikane Popullore kryesore opozitare, Partia e Mirë dhe Partia e Lumturisë, ndërsa jozyrtarisht i mbështet Partia Demokratike.

Këto zgjedhje, në kombin e 81 milionë njerëzve, konsiderohen historike pasi hyjnë në fuqi ndryshi-

met kushtetuese duke transformuar sistemin qeverisës të Turqisë në një presidencë ekzekutive. Kjo do të thotë se zgjedhjet presidenciale dhe ato parlamentare mbahen në të njëjtën datë në çdo pesë vite.

Në pajtim me ndryshimet ligjore, Parlamenti turk do të ketë 600 në vend 550 anëtarë në të ardhmen. Mandati i presidentit dhe deputetëve zgjat pesë vjet. Ndryshe, në prill të këtij viti, parlamenti miratoi një projekt-ligj për shkuarje në zgjedhje të parakohshme më 24 qershor, duke synuar forcimin e sistemit presidencial të Turqisë të miratuar me referendum vitin e kaluar.

Më 16 prill të vitit 2017, Turqia mbajti një referendum që kërkoi nga votuesit të vendosin për ndryshime kushtetuese në 18 nene për të kaluar nga sistemi parlamentar në sistem presidencial. Sipas ndryshimeve të reja kushtetuese, zgjedhjet presidenciale dhe ato parlamentare mbahen në të njëjtën datë në çdo pesë vite. Shefja e delegacionit monitorues të zgjedhjeve të byrosë së Institucioneve Demokratike dhe të Drejtave të Njeriut të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), ambasadorja Audrey Glover, në lidhje me procesin e zgjedhjeve në Turqi, tha se nuk ka

pengesa për delegacionin e OSBE-së dhe vazhdojnë të vëzhgojnë zgjedhjet në metodologjinë që kanë përdorur gjithmonë. "Nuk ka pengesa për delegacionin e OSBE-së, ne vazhdojmë të vëzhgojmë zgjedhjet në metodologjinë që ne kemi përdorur gjithmonë. Nuk kemi përjetuar ndonjë problem", tha Glover, e cila pas deklaratave ka hyrë në qendrën e votimit dhe ka marrë informacione nga autoritetet rreth votimeve. Për monitorimin e zgjedhjeve presidenciale dhe zgjedhjeve të përgjithshme në Turqi janë me detyrë 415 vëzhgues nga 8 organizata ndërkombëtare. Vëzhguesit do të raportojnë për standardet ndërkombëtare në zgjedhje, pjesëmarrjen në zgjedhje. Ndërkaq, ministri i Drejtësisë i Turqisë, Abdulhamit Gül, tha se deri tani nuk kanë marrë asnjë informacion rreth parregullive në lidhje me zgjedhjet. Ai pasi votoi në deklaratën për gazetaret shprehu dëshirën që zgjedhjet të jenë në të mirë të vendit, popullit dhe demokracisë.

Ndërsa në lidhje me pyetjen nëse ka ndonjë vështirësi rreth zgjedhjeve, Gül tha se: "Deri tani nuk kemi marrë asnjë informacion rreth parregullive në lidhje me zgjedhjet. Të gjithë po votojnë në paqe".

## "Të mbyllen kufijtë e BE", kërkohet vendosja e ushtarëve në Ballkan

Para takimit të jashtëzakonshëm për politikën ndaj refugjatëve disa shtete kërkojnë një izolim më të madh të shteteve të tyre. Në takimin e Brukselit nuk marrin pjesë shtetet e Vishegradit



cron që Franca "nuk do ta transformojë dot Italinë në një kamp refugjatësh të Evropës".

Shtetet e Vishegradit të distancuara Liderët e të ashtuquajturit grup të Vishegradit—Hungaria, Polonia, Sllovakia dhe Republika Çeke nuk janë të pranishëm në takim. Këtë e bëri të ditur kryeministri i Hungarisë, Viktor Orban, pas një takimi me liderët e katër shteteve dhe me Austrinë të enjten. Të katra shtetet e Vishegradit e kundërshtojnë me forcë skemën e shpërndarjes së refugjatëve të BE në vendet e tyre, të propozuar në vitin 2015. Presidenti i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker e quajti takimin e sotëm "takim informal pune", në prag të samitit me rëndësi me të gjithë liderët e BE, i planifikuar të mbahet të enjten dhe të premten. Debatet e fundit në Gjermani dhe në Itali kanë shkaktuar një debat të nxehtë në këto shtete për temën e migrimit. Në takimin e sotëm, kancelarja e Gjermanisë Angela Merkel do të këmbëngulë për lidhjen e marrëveshjeve bilaterale për ripranimin e refugjatëve, për të shmangur me këtë hap veprime unilaterale të Gjermanisë në kthimin e refugjatëve, siç i kërkon ministri i Brendshëm gjerman, Horst Seehofer. /D.W/

Bullgaria që kryeson aktualisht Bashkimin Evropian pritet të propozojë në takimin e jashtëzakonshëm në 16 shteteve të BE për azilin që të mbyllen kufijtë e jashtëm të BE. Sipas medieve, Borisovi ka kërkuar "masa të menjëhershme për mbylljen e kufijve të jashtëm të BE dhe kontrole të rrepta në kufijtë e brendshëm të BE". Sipas gazetës Die Zeit, Borisovi ka thënë se Bullgaria nuk mund të jetë dakord si shtete të tjera që migrantët të rikthehen në ato shtete të BE ku janë regjistruar për herë të parë.

Austria: ushtarë në Ballkan, Itali e Greqi Ndërsa ministri i Mbrojtjes i Austrisë, Mario Kunasek (nga FPÖ ultra e djathtë) kërkoi që në kufijtë e jashtëm të BE të stacionohen ushtarë. Sipas tij, ushtarët mund të angazhohen në Ballkan, në Itali dhe në Greqi, shkruan Die Zeit. "Ushtarët do të kishin një komandë civile dhe mund t'i mbështesin policët me logjistikë, me zbulim dhe në rast nevojë me përdorimin e armëve", deklaroi Kunasek. Tema e ndjeshme e migrimit solli të shtunën deklarata të ashpra të Italisë në drejtim të Francës. Ministri i Brendshëm i Italisë, Matteo Salvini e paralajmëroi Presidentin "arrogant" francez Emmanuel Ma-

Publicitet

Në bazë të nenit 20-g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18), nenit 143 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e RM nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17 dhe 21/18) si dhe Vendimit për nevojën për punësim të punëtorëve nr. 04-222/1 të datës 22.06.2018 dhe pëlqimit të siguruar financiar nga Ministria e financave nr. 18-3960/2 të datës 04.04.2018, IPKÇF "Detska Radost" – Strumicë më datë 25.06.2018 publikon:

### SHPALLJE PUBLIKE nr. 01/2018 Për punësim të 2 (dy) realizuesve për kohë të pacaktuar të punës

**I.1. Shifra dhe titulli i vendit të punës:** 2215 DEZ 03 03 B1 001 Pedagog i muzikës -1 (një) realizues

**2. Kushtet e përgjithshme:** - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë

- Të njeh gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik

- Të mos jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit veprimtarisë ose detyrës

- Nuk i është shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën dënohet për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale të grupit të veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese dhe

- Të përmbushë edhe kushte të tjera të përcaktuara në aktin për sistematizim të brendshëm të vendeve të punës

**3. Kushtet e posaçme:**

- Arsimit sipëror – 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar arti muzikor – pedagog muzikor

- Licencë valide për bashkëpunëtor profesional

- Me dhe pa përvojë pune

**4. Orari i kohës së punës:** - ditët e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte

- orët e punës në javë: 40

- orari i punës prej ora 08 deri në ora 16

**5. Neto shuma e pagesës në të holla:** 19.998,00 denarë

**6. Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve:** 5 (pesë) ditë pune

**7. Afati në të cilin bëhet zgjedhja:** 5 (pesë) ditë pune

**II.1. Shifra dhe titulli i vendit të punës:** 2223 DEZ 03 03 V1 001 Edukator për qëndrim të fëmijëve të moshës prej 2-6 vjet

**2. Kushtet e përgjithshme:** - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë

- Të jetë i aftë psikikisht dhe fizikisht

- Të njeh gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik

- Të mos jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit veprimtarisë ose detyrës

- Nuk i është shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën dënohet për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale të grupit të veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese dhe

- Të përmbushë edhe kushte të tjera të përcaktuara në aktin për sistematizim të brendshëm të vendeve të punës

**3. Kushtet e posaçme:**

- Profesor i diplomuar për edukatë parashkollore, edukator i diplomuar për fëmijë të moshës parashkollore dhe pedagog i diplomuar për edukatë parashkollore - me 240 kredi sipas EKTS apo arsim të lartë të mbaruar shkalla VII/1 apo me arsim të lartë përkatës të mbaruar për edukatorë (pedagogji)

- Licencë të vlefshme për edukator

- Me dhe pa përvojë pune

**4. Orari i kohës së punës:** - ditët e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte

- orët e punës në javë: 40

- orari i punës me ndërrime:

Ndërrimi i I: -07:00 deri më 15:00

Ndërrimi i II - 09:00 deri më 17:00

**5. Neto shuma e pagesës në të holla:** 19.426,00 denarë

**6. Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve:** 5 (pesë) ditë pune

**7. Afati në të cilin bëhet zgjedhja:** 5 (pesë) ditë pune

Kushtet e theksuara në shpallje kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes. Kandidatët obligohen që fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, në mënyrë precize dhe me të dhëna të sakta. Fletëparaqitja e dorëzuar pas afatit, jo e plotë dhe e parregulluar nuk do të merret parasysh nga ana e punëdhënësit.

Procedura për përzgjedhje për punësim të ofruesve të shërbimeve në institucionin publik përbëhet me kontrollimin e të dhënave të shënuara në fletëparaqitjen për punësim me kushtet e theksuara në shpalljen publike dhe kontrollim të dëshmitë të parashtruara në fletëparaqitje.

Fletëparaqitja dhe dokumentacioni i kompletuar të parashtrihen në arkivin e IPKÇF "Detska Radost" – Strumicë rr. Mladinska nr. 1 2400 Strumicë, personalisht ose përmes postës.

**Kandidatët e refuzuar do të informohen me shkrim në afat prej 3 ditëve, pas çka kanë të drejtë për ankesë në afat prej 8 ditëve deri të Këshilli i shkollës së IPKÇF "Detska Radost" – Strumicë.**

IPKÇF "Detska Radost" – Strumicë  
u. d. Drejtor  
Tinka Markova



Në bazë të nenit 29 dhe nenit 38 të Ligjit për kulturë ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 24/07...11/18), nenit 50 paragrafi 1 pika 9 e Ligjit për vetëqeverisje lokale (Gazeta Zyrtare e RM nr. 05/2002),

Kryetari i Komunës së Kavadarit publikon,

### SHPALLJE PUBLIKE

#### Për zgjedhje të drejtorit të IPK Shtëpia e kulturës "Ivan Mazov – Klime" – Kavadar

1. Publikohet shpallje publike për zgjedhje të Drejtorit të IPK Shtëpia e kulturës "Ivan Mazov – Klime" – Kavadar.

Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune, kandidatët duhet të përmbushin edhe kushte e posaçme në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- në momentin e emërimit me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,

- ka arritur së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të arsimit sipëror nga (sfera e kulturës dhe veprimtarive shoqërore) të përcaktuara me Statutin e institucionit;

- ka së paku 5 (pesë) vjet stazh pune në sferën e kulturës ose pesë vjet përvojë pune të punëve ose projekteve në sferën e kulturës në batë të marrëveshjeve të lidhura për vepër,

- Kandidati për drejtor është e domosdoshme të parashtrorë propozim program të vet për punë dhe zhvillim të institucionit për periudhën prej katër vjet.

(vërejtje: kushtin për njohje të gjuhës angleze përmes posedimit të një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikata për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet edhe atë: TOEFL IBT – së paku 74 pikë, IELTS – së paku 6 pikë, ILEC (Cambridge English: Legal) së paku niveli B2, FCE (Cambridge English: First) të dhënë, BULATS – së paku 60 pikë ose APTIS – së paku niveli B2, kandidati i zgjedhur obligohet që ta përmbushë më së voni në afat prej një viti nga dita e emërimit. Drejtorit të cilit nuk do të përmbushë kushtin për njohje të gjuhës së huaj në afat prej një viti nga dita e emërimit i ndërpritet mandati).

2. Secili kandidat i interesuar duhet të parashtrorë Fletëparaqitje, CV dhe dokumente në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter, si dëshmi për përmbushjen e kushteve të lartpërmendura.

3. Konkursi publik do të zgjasë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.

4. Kandidatët i parashtrorë dokumentet e nevojshme në pajtim me Konkursin deri te Këshilli drejtues të IPK Shtëpia e kulturës "Ivan Mazov – Klime" Kavadar.

Dokumentet e arritura i shqyrton komisioni tre anëtarësh i formuar nga ana e Këshillit Drejtues të IPK Shtëpia e kulturës "Ivan Mazov – Klime" Kavadar dhe pas përfundimit të konkursit parashtron propozim të kandidatëve deri te Kryetari i Komunës.

Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit dhe i pakompletuar nuk do të shqyrtohet.

KOMUNA E KAVADARIT  
KRYETARI I KOMUNËS  
M-r Mitko Jançev



QYTETI I SHKUPIT  
KRYETARI I QYTETIT

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1, pika 9, të Ligjit për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e RM nr. 05/02), dhe në lidhje me nenin 29 paragrafi 3 të Ligjit për kulturë (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 31/98; 49/03; 82/05; 24/07; 116/10; 47/11; 51/11; 136/12; 23/13; 187/13; 44/14; 61/15; 154/15, 39/16 dhe 11/18) dhe në lidhje me Ligjin për biblioteka ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 66/04; 89/08; 116/10; 51/2011; 88/2015; 152/2015 dhe 39/2016), Kryetari i Qytetit të Shkupit publikon

### SHPALLJE PUBLIKE për zgjedhjen e drejtorit të Institucionit Publik Biblioteka e qytetit, Vëllezërit Miladinov – Shkup

1. Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- në momentin e zgjedhjes me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ose sanksioni kundërvajtës për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- të ketë fituar më së paku 240 kredi sipas ECTS ose të ketë përfunduar shkallën VII/1të arsimit të lartë të përcaktuar me statutin e institucionit;
- ka minimum pesë vjet stazh pune në fushën e kulturës ose pesë vjet eksperiencë pune në punë ose projekte në fushën e kulturës në bazë të kontratave për punë;
- ka një nga certifikatat e mëposhtme të njohura ndërkombëtarisht ose vërtetime për njohjen aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:
- TOEFL IBT – më së paku 74 pikë,
- IELTS (IELTS) - më së paku 6 pikë,
- ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) - më së paku nivel B2 (B2),
- FCE (FCE) (Cambridge English: First) – të përfunduar
- BULATS (BULATS) - më së paku 60 pikë ose
- APTIS (APTIS) - më së paku nivel B2 (B2)

2. Kandidatët janë të obliguar që përveç dëshmi për plotësimin e kushteve të lartpërmendura të deponojnë edhe dokumentet e mëposhtme:

- Fletëparaqitje me biografi të shkurtër
- Dëshmi për stazh pune
- Propozim-Program për punën dhe zhvillimin e institucionit

3. Dokumentacionin e nevojshëm kandidatët janë të obliguar ta deponojnë në origjinal ose kopje të vërtetuar te noter.

4. Afati për deponimin e dokumentacionit të nevojshëm është 10 ditë nga dita e publikimit të shpalljes publike në shtypin ditor.

5. Dokumentacioni i dorëzuar me vonesë, i pakompletuar dhe i parregullt nuk do të jetë lëndë e shqyrtimit. Fletëparaqitjet e shpalljes publike deponohen në adresën e mëposhtme:

Institucioni publik Biblioteka e qytetit, Vëllezërit Miladinov – Këshilli drejtues  
(për konkursin)

Adresa e institucionit: bul. „Aradhat partizane“ nr.22  
1000 Shkup. R. e Maqedonisë

Qyteti i Shkupit  
Kryetari i Qytetit të Shkupit  
Petre Shilegov



16 Makedonska brigada, 18  
1000 Skopje, Republic of Macedonia  
Tel: ++389(0)2/3287 024; 3287 149  
Fax: ++389(0)2/3287 090  
E-mail: info@makstil.com.mk  
Web: www.makstil.com  
MK 4030997338244

Në bazë të nenit 20, 21 dhe 22 të Rregullores për licenca për kryerje të veprimtarive energjetike (Gazeta Zyrtare e RM nr. 143/11, 78/13, 33/15 dhe 207/16) Shoqëria aksionare MAKSTIL – Shkup me seli në rr. 16-ta Makedonska Brigada nr. 18, Gazi Babë, Shkup, në vijim publikon:

### LAJMËRIM

Informohet opinioni se Shoqëria aksionare MAKSTIL – Shkup më datë 12.02.2018 ka parashtruar Kërkesë për dhënie të licencës për kryerje të veprimtarisë energjetike tregti me gaz natyror deri te Komisioni rregullator për energjetikë të Republikës së Maqedonisë të shënuar me numër arkivues UP1 nr. 11-08/18.

#### Emri i kërkesës:

Shoqëria aksionare MAKSTIL – Shkup

rr. 16-ta Makedonska Brigada nr. 18, Gazi Babë, Shkup

#### Lloji i veprimtarisë energjetike:

Tregti me gaz natyror

#### Rajoni ku do të kryhet veprimtaria:

Veprimtaria energjetike tregti me gaz natyror do të bëhet në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe jashtë vendit.

#### Përshkrimi i mënyrës, objekteve dhe mjeteve për kryerje të veprimtarisë:

Veprimtarinë energjetike, tregti me gaz natyror, do ta bëjmë përmes lidhjes së marrëveshjeve për shitblerje të gazit natyror nga vendi dhe jashtë vendit, marrëveshje me operatorët për përcim dhe distribuim dhe shërbime sistemore, si dhe marrëveshje për shitblerje të gazit natyror nga tregtarë, furnizues, prodhues të tjerë të energjisë elektrike dhe/ose të ngrohjes, konsumatorët që përmbushin kushtet për pjesëmarrje të pavarur në tregun e gazit natyror si dhe për nevoja personale, në pajtim me rregullat e tregut të gazit natyror.

#### Kohëzgjatja e licencës:

Kërkuesi kërkon licencë me kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) vjet.

#### Mënyra dhe afati përfundimtar për parashtrimin e propozimeve, mendimeve dhe sugjerimeve në lidhje me Kërkesën për dhënie të licencës:

Subjektet e interesuara juridike dhe fizike mund me shkrim të parashtrorë deri te Komisioni rregullator për energjetikë e Republikës së Maqedonisë mendimet dhe propozimet në lidhje me Kërkesën në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e publikimit të Lajmërimit për kërkesë në shtypin ditor.

#### Adresa e Komisionit rregullator për energjetikë të Republikës së Maqedonisë:

rr. Makedonija pn, Pallati Lazar Pop Trajkov, kati i 6, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë

SHA Makstil – Shkup  
Ivan Banovski, Drejtori gjeneral



REPUBLIKA E MAQEDONISË  
Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" – Shkup  
Fakulteti për shkenca informatike dhe inxhinieri kompjuterike



Në bazë të nenit 176 të Ligjit për arsim sipëror (Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë nr. 82/18) dhe Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" – Shkup (Fleta universitare nr. 274/13), Dekani i Fakultetit për shkenca informatike dhe inxhinieri kompjuterike në Shkup publikon:

### KONKURS Për zgjedhje në titujt

1. Zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor në të gjitha sferat mësimore-shkencore të fushës mësimore-shkencore informatikë dhe fushës mësimore-shkencore teknika kompjuterike dhe informatikë
2. Zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor në të gjitha sferat mësimore-shkencore të fushës mësimore-shkencore informatikë dhe fushës mësimore-shkencore teknika kompjuterike dhe informatikë
3. Zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor në të gjitha sferat mësimore-shkencore të fushës mësimore-shkencore informatikë dhe fushës mësimore-shkencore teknika kompjuterike dhe informatikë
4. Zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor në të gjitha sferat mësimore-shkencore të fushës mësimore-shkencore informatikë dhe fushës mësimore-shkencore teknika kompjuterike dhe informatikë

**Kushtet:** Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me nenin 166 të Ligjit për arsim sipëror (Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë nr. 82/18) kandidatët duhet ti plotësojë edhe kushtet e posaçme të parapara me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë dhe doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup Fleta universitare nr. 274/13).

**Orari i punës** do të përcaktohet në pajtim me orarin e orëve.

**Pagesa për pozitën 1** lëvizë prej 35.640.000,00 deri më 60.000,00 denarë.

**Pagesa për pozitën 2** lëvizë prej 32.400,00 deri më 58.000,00 denarë.

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë: fletëparaqitje sipas konkursit në të cilën do të qëndrojë se për cilën pozitë paraqiten, dokument për arsimin e mbaruar përkatës, (diplomat e huaja të jenë të nostrifikuara dhe të plotësuara me ekuivalencë të notave), biografi të shkurtër, certifikatë të shtetësisë, listë të punimeve të publikuara shkencore dhe profesionale (nga një kopje të punimeve);

Zgjedhja do të realizohet në afatin e paraparë me ligj.

**Dokumentet të dorëzohen në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter – fletëparaqitjet të cilat nuk janë të plotësuara nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.**

Fletëparaqitjet të dorëzohen më së voni 8 ditë nga dita e publikimit të konkursit në Dekanatin e Fakultetit për shkenca informatike dhe inxhinieri kompjuterike, rr. Rugjer Boshkoviq 16, Shkup.

Fakultetit për shkenca informatike dhe inxhinieri kompjuterike



BOTIME TË VEÇANTA

# ZBARDHJA E NJË PERIUDHE TË ERRËT PËR SHQIPTARËT

(Rreth librit "Burgu i jetës" të Elmaz Ademit, botoi Shtëpia botuese Tring Design, Tetovë, 2018)



Qerim LITA

Libri më i ri "Burgu i jetës" të autorit Elmaz Ademit, përbën një interes të veçantë për historiografinë shqiptare në përgjithësi, e të trevave verilindore në veçanti. Vepra është fryt i palodhshëm i autorit Ademi, i cili përmes përshkrimit kronologjik të jetës së tij dhe të bashkëveprimtarëve të tij, hedhë dritë mbi pozitën diskriminuese të shqiptarëve të trevave verilindore dhe jo vetëm. Që kjo vepër të merr karakterin e një monografie të mirëfilltë studimore, autori, përveç kujtesës historike ka shfrytëzuar edhe burime arkivore, kryesisht ato policore e gjyqësore si dhe materiale të botuara në shtypin e kohës.


Rrethanat politike në ish RSFJ-ë, të cilat u krijuan pas rënies nga skena politike të bashkëpunëtorit më të ngushtë të Josip Broz - Titos, ultranacionalistin dhe shovinistin e njohur serb, Aleksandër Ranković ( në mbledhjen e IV të KQ të LKJ-së të mbajtur më 1 korrik 1966 në Brione), në opinionin e atëhershëm shqiptar në Kosovë dhe në trevat tjera etnike shqiptare nën RSFJ-ë, se për ta do të vijë ditë më të mira, se ngjashëm si kombet tjera në atë shtet komunist, edhe kombi shqiptar do ta fitojë drejtën e republikës së vet etj. Mirëpo ky iluzion i cili qe krijuar asaj periudhe kohore, së shpejti u shua fare, për arsye se udhëheqja komuniste jugosllave, e posaçërisht ajo maqedonase, jo që ndërmoi ndonjë hap drejt përmirësimit të statusit tejet degradues e nënçmues të shqiptarëve, por madje shkuan aq larg sa që çdo kërkesë e shtruar nga ana e inteligjencës shqiptare e konsideronin si "nacionaliste", irredentiste", "armiçqësore" e shumë etiketa tjera, që siç thuhej në analizat dhe vështrimet e shumta të tyre "çojnë kah cenimi i integritetit shtetëror" si të RSFJ-së po ashtu edhe të RS të Maqedonisë.

Si rrjedhojë e një qasje të tillë ndaj problemit shqiptar, inte-

ligjenca e atëhershme shqiptare, e cila përbëhej kryesisht nga mësuesit dhe studentët, me vetëdije të plotë iu rrok veprimtarisë ilegale. Në kuadër të kësaj veprimtarie, gjatë viteve shtatëdhjeta në trevat etnike shqiptare nën Jugosllavi u krijuan disa organizata ilegale shqiptare, në mesin e tyre edhe organizata tashmë e njohur nga opinioni shqiptar dhe jo vetëm "Kushtrimi i Lirisë". Kjo organizatë, siç pohon autori, u themelua në prill të vitit 1972 në Prishtinë, nga studentët e atëhershëm në Universitetin e Prishtinës, shumica e tyre ishin nga rrethina e Tetovës: Rafi Halili, Gafur Loku, Rushit Nesimi, Xhevahir Aliu, Muhamet Saliu e disa të tjerë përfshi këtu edhe autorin e kësaj vepre Elmaz Ademin. Ngjashëm sikurse edhe organizatat tjera shqiptare, edhe Kushtrimi i Lirisë në programin e vet pati "çlirim dhe bashkimin kombëtar". Nuk kaloi shumë kohë, e njëjta u zbulua nga ana e shërbimit të atëhershëm sekret jugosllav UDB-ë, me ç'rast u arrestua e tërë udhëheqja e saj.

Pa dashur të futem në një analizë të thellë rreth politikës represive e të dhunshme të aparatit të atëhershëm policor jugosllav, ndaj këtyre figurave të shquara shqiptare, për arsye se këtë masë miri e përshkruan vet autori i kësaj monografie, desha vetëm të vë në dukje faktin se, politika represive e UDB-së ndaj tyre vazhdoi edhe pas vuajtjes së burgut, për ta arritur kulminacionin pas demonstratave studentore të vitit 1982.

Veprën, krahas parathënies dhe hyrjes, autori e ka pa të arsyeshme ta ndajë në 13 kapituj të veçantë. Kapitulli i parë për shkaqe praktike është ndarë në katër nënkaptuj, ku këtu veçmas duhet theksuar nënkaptulli i tretë dhe i katërt, për shkak se autori në mënyrë origjinale e të detajuar e përshkruan dhunën dhe terrorin e përjetuar gjatë procesit të hetuesisë e atë gjyqësor. Kapitujt dy e tre, autori ia përkushton jetës në bur-



gun e Idrizovës dhe lirimit, ndërsa te kapitulli katër hedhë dritë mbi jetën pas lirimit të burgut, që ai me të drejtë e emërton si "jeta në burgun e madh". Interes të jashtëzakonshëm për historiografinë më të re shqiptare paraqet kapitulli i shtatë i kësaj vepre, ku autori përmes fakteve të dokumentuara pasqyron dhunën dhe terrorin policor ndaj veprimtarëve të organizatës "Kushtrimi i Lirisë", veçmas ndaj dy udhëheqësve shpirtëror të saj: Gafur Loku dhe Rafi Halili. Kapitujt në vazhdim trajtojnë aktivitetin dhe veprimtarinë politike të autorit dhe bashkëveprimtarëve të tij në mërgim gjatë viteve tetëdhjeta dhe ato të nëntëdhjeta pas shpërbërjes së RSFJ-së, ku theks të veçantë i kushtohet themelimit të partive politike shqiptare siç ishin LDK-ë dhe PPD-ë, që sipas autorit të njëjtat nuk qenë në gjendje t'i mbronin interesat e përgjithshme kombëtare shqiptare. "Një popull i robëruar siç jemi ne shqiptarët - shprehet Ademi - nuk i duhen shumë

partit politike, por i duhet një trup udhëheqës, një strukturë e organizuar politike, një këshill, një komitet apo parti, që nuk është shumë me rëndësi si do të quhet. Është mirë që LDK-ja t'i formojë degët e saja në Maqedoni, Mal të Zi, dhe Preshevë dhe mos lejohet formimi i partive tjera..."

Më pas Ademi ndalet te lufta e cila shpërtheu gjatë vitit 2001 në trevat verilindore shqiptare, e cila përkundër faktit se e njëjta hasi në mbështetje të fuqishme nga mbarë populli shqiptar, përfshi këtu edhe mërgatën, e njëjta më pas u degradua nga ana e krerëve udhëheqës të saj. Auto i veprës "Burgu i jetës", Elmaz Ademi, ndalet edhe të Marrëveshja Kornizë e Ohrit, e cila siç do të shprehet: "mbeti një marrëveshje matrapazësh, ku u zgjodhën problemet e disa personave e asgjë më tepër". "Pas Marrëveshjes së Ohrit dhe pas dorëzimit të armëve - vazhdon autori - krahu ushtarak hoqi dorë nga profesioni dhe u kyç në politikë, gjeti përkrahës dhe formoi partinë politike me emrin "Bashkimi De-

mokratik për Integrim - BDI", largoi nga skena politike paraardhësit, përkatësisht PDSH-në dhe hyri vet në qeveri. Me këtë, ata nuk e eliminuan vetëm kundërshtarin politik, por i eliminuan edhe kundërshtarët nga radhët e veta si ushtarët dhe komandantët e padëgjueshëm, të cilët nuk pajtoheshin me veprimet e tyre, rrjedhimisht edhe pushteti u bë plotësisht maqedonas. Kurse shqiptarët dhe të drejtat e tyre u bënë dekor i gojës së tyre, përmes të cilave i mbulonin krimet e bëra ndaj tyre..."

Veprimtaria antikombëtare e "klikës politike shqiptare", vë në dukje autori në kapitullin e fundit "i detyroi shqiptarët të veprojnë sipas proverbrës popullore: 'për inat të vjehrrës do ta çajë b. Time', ku si hakmarrje ndaj politikës degraduese masovikisht ia dha votën një partie maqedonase". Një veprim i tillë, sipas autorit ishte tepër e dëmshme për kauzën shqiptare, sepse me këtë ata sh-

tatëdhjetëmijë shqiptarë, të cilët votuan një parti maqedonase, në fakt ujin e çuan në mullirin e "integristëve", duke "u integruar vullnetarisht drejt maqedonizimit, drejt shkrirjes, drejt asimilimit". Nisur nga kjo, ai i bën apel klikës politike shqiptare "të tërhiqet nga politika integruuese", përkatësisht "të tërhiqet nga vaji që bëjnë për Maqedoninë dhe maqedonasit", dhe t'i lënë vetë "ato të vajtojnë për veti", ndërsa ne shqiptarët "t'i vajtojmë hallet tona", sepse "mosekzistimi i Maqedonisë", nuk do të thotë edhe mosekzistimi i shqiptarëve, sepse "shqiptarët kanë qenë, janë dhe do të jenë gjithmonë në këto troje..."

Parë nga këndvështrimi realist dhe kritik, vepra është serioze, e shkruar me një stil tërheqës për lexuesit, ku nuk mungojnë as analizat dhe konkluzionet, prandaj jam i mendimit se me botimin e kësaj vepre, autori Elmaz Ademi ia ka dalë me sukses të zbardh një periudhë shumë të errët për shqiptarët, periudhë, e cila deri më tash shumë pak është trajtuar nga historianët shqiptarë.



Kreu i shtetit anglez kishte një marrëdhënie sekrete me Doris Delevingne, halla e madhe e modeles së famshme, Cara Delevingne. Një marrëdhënie "skandaloze" që mund ta kishte kompromentuar



Winston Churchill kishte një marrëdhënie të fshehtë, e cila mund të rrezikonte fatin e qeverisë së tij dhe madje edhe Luftën e Dytë Botërore. Kjo gjë është zbuluar nga një intervistë e pabotuar deri më tani, me asistentin e tij më të rëndësishëm.

Zbulimet, të cilat përshkruajnë marrëdhëniet e Churchill me gruan e tij, Clementine, shpesh të përshkruara si të pakundërshtueshme, në një dritë më komplekse, dalin në një dokumentar të serisë së "Historive sekrete të rrjetit anglez" në Channel 4, bazuar në hulumtimet e Richard Toye, profesor i historisë në Universitetin e Exeter dhe Warren Dockter, historian ndërkombëtar në Universitetin e Aberystwyth. Të dy akademikët zbuluan se në vjeshtën e vitit 1985, ish-sekretari privat i Churchill, Sir John "Jock" Colville, dha një intervistë të gjerë ndaj arkivistëve të "Churchill College" në Kembrixh, por që asnjëherë nuk është bërë publike deri më tani.

Kjo intervistë konfirmon faktin se Churchill kishte pasur një marrëdhënie të fshehtë me një aristokrate "joshëse", zonjën Doris Castlerosse, lindur në Delevingne dhe halla e madhe e supermodeles së famshme, Cara Delevingne. Kur filloi marrëdhënia, Churchill po kalonte një periudhë depresioni. Ishite jashtë Parlamentit pas humbjes së konservatorëve në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 1929 dhe kishte humbur një pasuri në rrëzimin e 'Wall Street Crash' të po atij viti.

Për pasojë u zhyt në një jetë intensive shoqërore: pinte dhe luante kumar, si dhe udhëtonte shpesh. Ndërsa ai ishte i ftuar në vilë në Francë, te Lord Beaverbrook, në vitin 1930, u prezantua me bukuroshen Doris Delevingne. Mes tyre do të lindte një histori seksi, e konsumuar në Ritz në Paris, ku duket se Churchill i ka thënë pas një nate dashurie, "Doris, ti do të ngrije përsëri



## DASHURIA SEKRETE E CHURCHILL QË MUND TË NDRYSHONTE FATIN E LUFTËS BOTËRORE

edhe një kufomë". Nuk është e lehtë të mendosh për Churchill, - heroi i ardhshëm i Luftës së Dytë Botërore, madhështia e të cilit është e përfaqësuar mirë në filmin "The Darkest Hour", si një playboy kushtuar aventurave jashtëmartesore. Por, tani dëshmia historike konfirmon episodin dhe si dhe shumë të tjerë të jetës aventureske të Delevingne.

Duket se fuqia e Lady Castlerosse mbi Churchill ishte e madhe dhe halla e madhe e Cara Delevingne u përshkrua nga një kushëri si "gruaja më arrogante, kapriçioze, më e paturpshme dhe estetikisht më e bukura në Londër". Doris Delevingne ishte në fakt një joshëse e gjykatës në brazdën e traditës së Lady Hamilton dhe Nell Gwyn, e cila lidhej me njerëz të pasur dhe jetonte në rehati që ata i jepnin gjatë përljes së tyre.

Duket se zonja i kishte vënë syrin edhe mbretit Edward VIII, por që nuk kishte pasur sukses, sepse ishte mundur nga Wallis Simpson, po aq ambicioze dhe agresive. Doris vinte nga një familje e vogël borgjeze nga Streatham, në jug të Londrës. Dhe vetëm përmes frekuenti-

meve të sakta, kishte arritur t'i afrohej aristokracisë angleze. Nga marrëdhëniet e saj me burrat e pasur ajo arriti të merrte para, bizhuteritë Cartier, rrobat e Schiaparelli dhe çizme mëndafshi në Paris. Reputacioni i saj i keq e paraprinte atë dhe e bënte edhe më interesante. Një e njohur i sugjeroi të shkruante një libër të quajtur "Rreth Botës në 80 shtretër".

Ajo ra në dashuri me një "playboy" të gjatë dhe të bukur amerikan, Laddie Sanford, i cili pastaj e la atë për gruan e Mountbatten. Edhe pas martesës në vitin 1928, ajo vazhdoi jetën e saj të lirë, të mbushur me sulme të rënda fizike nga burri i saj. Dy vjet më vonë, ajo joshi Winston Churchillin në vitin 1930. Më vonë thuhet se kishte një marrëdhënie edhe me djalin e tij, Randolph Churchill, i cili ishte vetëm 21 vjeç. Marrëdhënia e tyre u zbulua nga pronari i Cavalry Club, i cili hapi derën e një dhome dhe pa këmbët e pagabueshme të Doris ngritur në qiell, ndërsa Randolph Churchill i thirri atij: "Jashtë!" Shpejt, çështja ishte në domenin publik dhe babai - thotë Lyndy Spen-



ce në librin e tij mbi Doris Delevingne "The Mistress Of Mayfair", - i kërkoi djalit të tij t'i jepte fund lidhjes.

Doris dhe Randolph u ndanë. Megjithatë, ajo vazhdoi të mbante kontakte me Winston dhe kur u takuan përsëri në një festë në një vilë në jug të Francës, Churchill e mori atë në një foto, veshur me pantallona të shkurtra që shpesh i vishte për të treguar këmbët e saj të bukura. I tillë ishte besimi i saj në fuqitë e saj joshëse që çoi në shtrat edhe fotografimin e famshëm, Cecil Beaton, edhe pse sipas fjalëve të tij, ai ishte "tmerrësisht homoseksual". Besova se mund ta "kuroja", por dështova. Ndërkohë, në vitin 1938, martesa e saj përfundoi. Por ajo gjeti një adhuruese të re, Margot Hoffman, një pasanike amerikane, me

të cilën filloi një marrëdhënie homoseksuale.

Margot bleu një pallat në Veneçia për të argëtuar miqtë e tyre, por kur lufta shpërtheu në vitin 1939, Italia u bë një vend armik dhe Doris iku në Nju Jork me miken e saj. Megjithatë e mbante kontaktin me Churchill, edhe pse ajo filloi të bëhej një figurë e pakëndshme për miqësinë e saj intime me fashistin Oswald Mosley. Marrëdhënia me miken amerikane hyri në krizë dhe Doris i bëri thirrje Churchillit të kthehej.

Ajo kishte me vete atë portret të pikturuar prej tij në Francë dhe kreu i shtetit me siguri nuk dëshironte, në një moment delikat në marrëdhëniet me Uashingtonin, që në gazetë të shfaqej titulli "Winston dhe kurtizana". Operacioni i rikthimit, në kohë lufte, nuk ishte i lehtë. Në një udhëtim në Amerikë në vitin 1942, Churchill hipi në avionin e tij dhe e solli përsëri në Londër. Kthimi në atdhe nuk ishte, megjithatë, i lavdishëm dhe Doris duhej të shiste bizhuteritë e saj dhe të merrte çmime të ndryshme, një akt i paligjshëm në kohë lufte. Pak pas kësaj, në moshën 42 vjeçe, ajo u gjet në një hotel, e vdekur nga mbidoza. Me të u zhdukën edhe sekretet e marrëdhënies me udhëheqësin më të famshëm britanik në histori.





NË ARKIVAT E FSHEHTË TË CLINTONIT

# NJË PAKT EUROATLANTIK ME MOSKËN

Dokumentet e deklasifikuar dhe siguria e përbashkët dhe marrëveshjet ekonomike: planet e presidentit të SHBA

Moskë, 14 janar 1994. Presidenti amerikan, Bill Clinton, ai rus, Boris Jelsin dhe ukrainas, Leonid Kravchuk firmosin marrëveshjen e carmatimit bërthamor të Ukrainës. Është fillimi i kthesës në marrëdhëniet e vështira Moskë-Kiev, që do të çojë tek një tjetër firmë, atë të Memorandumit për garancitë e sigurisë, në 5 dhjetor 1994 në Budapest. Me atë memorandum, Amerika dhe Rusia angazhohen të respektojnë kufijtë ukrainas. Është një triumf për Clintonin, që nga njëra anë është i zënë me luftërat në Ballkan dhe nga ana tjetër me krizën e radhës izraelito-palestineze, që të dyja rrezikojnë rendin e ri evropian, që ai dëshiron të ndërtojë. Presidenti amerikan ka ndërmjetësuar për dy vite mes Moskës dhe Kievit, por e di mirë që ka fituar vetëm betejën e parë të një fushate shumë të vështirë.

E demonstrojnë dy dokumente të Shtëpisë së Bardhë, të dhjetorit 1993, të bërë publikë së fundi nga Biblioteka Clinton, me titull "Politika amerikane kundrejt Europës Qendrore dhe Lindore". Gati njëzetë e katër vjet më vonë, leximi i tyre të ndriçon jo pak. Pavarësisht mirëkuptimit mes Clintonit dhe Jelsinit, Shtëpia e Bardhë druhet se mos Rusia kërkon një lloj protektorati mbi Ukrainën dhe republikat e tjera sovjetike. Dokumentet nuk aludojnë për mundësinë e një ndërhyrjeje ushtarake ruse në Kiev në rast krize, por duke iu referuar në mënyrë eksplicite Moskës pohojnë nevojën për "të vendosur parimin që asnjë shtet nuk ka të drejtën të mbrojë minorancën e tij etnike në një shtet fqinj", pikërisht arsyeja që ka përdorur Putini për pushtimin e Krimesë në ditët e fundit.

## TË DREJTAT ENJERIUT

Sipas dokumenteve, është Organizata për Sigurinë dhe bashkëpunimin në Europë, OSCE me seli në Varshavë, që i takon mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe demokracisë në ata që i quajnë NIS (shtetet që sapo kanë fituar pavarësinë), mes të cilëve Ukraina. "OSCE duhet të ketë prioritetin në këtë drejtim, dhe Komisari i lartë për minorancat duhet që të mbështetet. Ndalohe ndërhyrjet e njëanshme... OSCE duhet të marrë pjesë gjithashtu në parandalimin e konflikteve dhe mi-



sionet e saj afatgjatë duhet të përfshijnë edhe ushtarakë. Duhet që të pajiset me shërbim të fshehtë, logjistikë dhe komunikime për të forcuar grupin e reagimit të shpejtë, për të cilin u diskutua në Romë". Operacionet shumëpalësh, bëjnë të ditur dy dokumentet, mund të jenë më efikas. Shtëpia e Bardhë, megjithatë është e vetëdijshme që OSCE mund të dështojë, dhe për t'i lehtësuar suksesin i propozon presidentit Clinton që "të krijojë një ndjesi stabiliteti dhe sigurie në Europën Qendrore dhe Lindore dhe të vendosë një urë mes saj dhe Ruisë, si dhe vendeve që sapo kanë fituar pavarësinë, duke mos lejuar ngritjen e barrierave të reja". Si? "Duke i integruar të gjithë. Rusia dhe Ukraina në krye, në një sistem euro-atlantik sigurie ku marrëdhëniet mes shteteve të jenë paqësore dhe konstruk-

tive, ashtu si ato të vendeve anëtarë të NATO-s".

## SHTETE SATELITË

NATO, shtojnë dokumentet, "në këtë kuadër mund të zhvillojë operacione paqeruajtës dhe menaxhimi krizash, tashmë jo vetëm me mandat të OKB, por edhe OSBE-së". Për këtë qëllim "është urgjente që ne të nxisim marrëveshjet mes qeverive të ndryshme". Në retrospektivë, këto propozime Clintonit iu dukën ambicioze. Por i përgjigjeshin asaj që presidenti amerikan e kishte pagëzua "demokracia e brezit të dytë", epoka e reformave politike, ekonomike dhe sociale në ish vendet komuniste, përfshirë Ukrainën. Shtëpia e Bardhë donte që të të gjithë këta vende "të shihnin që Amerika është me ta për një kohë të gjatë", dhe do i ndihmojë, ashtu siç



edhe nga Europa perëndimore, por, siç informohet Clintoni përmes dokumenteve, jo nga Europa Qendrore dhe Lindore, ish shtetet satelitet të BRSS. Disa prej tyre vazhdojnë të shohin tek Rusia një armik dhe në futjen e tyre në NATO, një garanci që nuk do i nënshtrohen më kurrë asaj. Për këtë arsye, Shtëpia e Bardhë kërkon "një koordinim në rritje mes BE dhe organizmave të tjerë rajonalë, si ai ekonomik i Detit të Zi, që udhëhiqet nga Rusia dhe nga Ukraina". Dhe nënvizon që "nga ana jonë nuk duhet të ketë dallim në trajtimin mes vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore si dhe shteteve që sapo kanë fituar pavarësinë. Veç kësaj, ashtu sikurse Rusia nuk mund të ketë të drejtën e vetos mbi vendimet e ish shteteve të saj satelitet, ashtu edhe ish shtetet satelitet nuk mund të vihen kundër Ruisë".

## JO PLANIT MARSHALL

Ai që dokumentet e përjashtojnë në mënyrë eksplicite është një Plan i ri Marshall që të përfshijë Europën Qendrore dhe Lindore si dhe shtetet që sapo kanë fituar pavarësinë, dhe që të hidhte themelet për një rimëkëmbje ekonomike paneuropiane dhe një paqe jetëgjatë. SHBA nuk kanë më mjete. Mund të nxisin vetëm investime privatë, të japin hua, të promovojnë ndërtimin e infrastrukturave transrajonale, e kështu me radhë. "Ndonëse në 1989 procesi i reformës ka patur progres të fortë - është konkluzioni - sidoqoftë sukcesi nuk është ende i sigurt". Shtëpia e Bardhë është e vetëdijshme që, nëse reformat do të ishin të pjesshme apo shumë të ngadalta, mund të shpërthenin konflikte. Por nuk ndalet në vatrë e mundshme të tensionit. Në periudhën menjëherë pas Luftës së Ftohtë, është e përqendruar në Europën lindore dhe Rusinë. Në dritën e kësaj dosjeje, administrata Clinton mund të shfaqet shumë optimiste, në mos jorealiste. Por në vitet nëntëdhjetë, vite lufte por edhe shprese, ndodhën ndryshime të mëdhenj. Ndër arsytet përse nuk vazhduan, përmenden padyshim terrorizmi dhe kriza financiare e vitit 2008. Por përmenden edhe ndryshimi i krerëve në Uashington dhe Moskë. Pas një muaji mjalti të shkurtër, marrëdhëniet mes Bushit të vogël dhe Putinit u prishën dhe Obama nuk diti t'i përmirësojë. Parandalimi i krizave nuk është shfaqur më në agjendën e Amerikës, aq më pak në atë të BE-së. Putini ka mundur kështu t'i rikthejë Ruisë ëndrrën e superfuqisë, dhe të vërë veton për shpëputjen e Gjeorgjisë dhe Ukrainës, nga sfera e tij e influencës. Tani, kriza vazhdon mes presidentit Donald Trump dhe, sërisht Putinit.



**E demonstrojnë dy dokumente të Shtëpisë së Bardhë, të dhjetorit 1993, të bërë publikë së fundi nga Biblioteka Clinton, me titull "Politika amerikane kundrejt Europës Qendrore dhe Lindore". Gati njëzetë e katër vjet më vonë, leximi i tyre të ndriçon jo pak. Pavarësisht mirëkuptimit mes Clintonit dhe Jelsinit, Shtëpia e Bardhë druhet se mos Rusia kërkon një lloj protektorati mbi Ukrainën dhe republikat e tjera sovjetike**

do i ndihmojë dhe Bashkimi Evropian. Në dokumente premtohet "krijimi i një Instituti të demokracisë, qeverisës dhe privat njëkohësisht, me seli në Uashington, dhe krijimi i një Komisioni të demokracisë në ambasadat amerikane në mbështetje të programeve ndëretnikë dhe ndërajonalë". Sugjerohet mobilizimi i shpejtë i OJF-ve. Projekti është ambicioz dhe i mbështetur



Mbase ju ka ndodhur shpeshherë që të harroni emrat e të saponjohurve në situata të ndryshme. Shkenca tashmë e ka gjetur arsyen se pse ndodh një gjë e tillë. Dhe ajo besohet se është: mospërqendrimi vetëm tek interesi juaj, por t'ua vini veshin edhe thënieve të tjetrit

Jeni në një festë. Ju prezantohen gjithë të ftuarit, shkëmbeni shtrëngimin e duarve dhe informacione të pakta: emri para së gjithash. Sigurisht që nuk mund t'i fiksoni të gjithë, por si është e mundur që keni harruar për më pak se gjysmë ore, emrin e vajzës/djalit që ju pëlqeu aq shumë e që dëshironit ta pyesnit për ta takuar edhe një herë? Megjithatë, jeni të ndërgjegjshëm për potencialin e kujtesës suaj: arini të kujtoni të gjitha ditëlindjet e miqve dhe të afërmeve, keni një prije të caktuar për të mbajtur mend datat e ngjarjeve më të rëndësishme historike. Por me emrat e keni të vështirë.

#### PËRSE NDODH KJO GJË?

Ekziston një shpjegim shkencor, të paktën nga ajo që është thënë nga Victoria Woollaston në "Daily Mail". Studiuesja thotë se truri ynë është i "shkathët" për të rinjohur detajet e fytyrës - ngjyrën e syve, gjatësinë e hundës, formën e buzës, por për emrat, që për ne janë thjesht tituj arbitrarë, ai kërkon një sforcë më të madhe. "Sepse, emrat janë rastësorë dhe

# PËRSE NUK I KUJTONI DOT EMRAT E TË SAPONJOHURVE?



nuk kanë informacione specifike", shpjegon ajo, "truri lodhet për t'i mbajtur në kujtesë. Dhe duke qenë se truri nuk mund të bëjë lidhjet midis pjesëve të shumta të informacioneve, ka shumë mundësi që emrat të mos i memorizojë aspak". Për këtë arsye, është shumë më e thjeshtë të kujtohen emrat e një atleteje të re të skuadrës së qytetit tuaj, ose titulli i suksesshëm i CD-së së re të artistit tuaj të preferuar. Pra, funksionet e trurit punojnë në mënyrë optimale kur mund të bëhen lidhje mes informacioneve që ju duken familjare; në këtë rast, qyteti juaj ose artisti i preferuar. Në të kundërt, kur disa persona takohen për herë të parë dhe kur për njëri-tjetrin dihet shumë pak ose aspak për atë se çfarë bëjnë ose çfarë janë, emrat e tyre nga njëri vesh hyjnë dhe nga tjetri dalin.

#### "FAJI" ËSHTË I TRURIT, THOTË SHKENCA

Pjesë e arsyes se përse kjo gjë ndodh kaq shpesh, është efekti "next-in-line", i cili shpjegon se përse trutë tanë nuk janë në gjende të marrin dhe të japin informacione të reja në të njëjtin moment. Woollaston thotë: "Në vend që të shohë dhe të dëgjojë të tjerët, truri fillon të përqendrohet mbi rutinën e tij. Mbi atë se çfarë do të thonë personat përballë dhe se çfarë duhet të 'thotë ai'". Kjo është ndoshta ajo që ndodh kur prezantoheni ndaj një të huaji: përqendroni aq shumë mbi atë se çfarë do të thoni, sa që nuk i kushtoni vëmendje të mjaftueshme asaj se çfarë thonë të tjerët—si për shembull, emrin e tyre. Një grup studiuesish kanë kryer një eksperiment në të cilin disa njerëz janë ndarë në disa grupe dhe janë

ngacmuar që të prezantohen. Më pas, atyre u është kërkuar që të rikuperonin informacione të tilla. Çuditërisht, pjesëmarrësit ishin në gjendje të kujtonin me saktësi informacionet mbi të gjithë pjesëtarët e grupit të tyre. Ishin shumë të përqendruar mbi atë se çfarë do të thoshin, menjëherë pasi nuk do të kishin për të marrë më informacion të ri. Woollaston flet edhe për rëndësinë e të vënit në punë të kujtesës: me fjalë të tjera, nëse një informacion nuk përsëritet disa herë, është i destinuar të harrohet me kalimin e kohës. Kështu që, herën tjetër kur të shkoni në një festë dhe të keni ndërmend të rishihni vajzën/djalin që ju pëlqeu aq shumë menjëherë, ju leverdis të përsërisni me mendje emrin e saj/tij, për mos ta harruar dhe për të mos bërë një figurë të keqe.



## Vegjetarianët janë njerëz më pak të lumtur dhe sëmuren më shpesh

Sipas një studimi nga Universiteti Bristol u konstatua se vegjetarianët dhe veganët kishin nivele të larta depresioni. Studimi përfshinte rreth 10,000 burra britanikë; 350 prej të cilave ishin veganë dhe vegjetarë. Njerëzit vegjetarian kishin një përqindje më të lartë depresioni se sa mesatarja në krahasim me pjesën tjetër të meshkujve, dietat e të cilëve përfshinin proshutë, sandviçë dhe pulë të skuqur. Sipas studiuesve, shkak i efekteve negative në shëndetin mendor të vegjetarianëve është mungesa e vitaminave dhe mineraleve në dietën e tyre. Mungesa e vitaminës B12 lidhet me mungesën e mishit dhe konsumimi i sasive të mëdha të frutave të thata mund të shkaktojë nivele më të larta omega-6, acide yndyrore të cilat janë të njohura për të ndikuar në gjendjen shpirtërore dhe janë të lidhura me problemet e shëndetit mendor.



## Dëshirë për ëmbëlsirë pas kafesë? Shkenca shpjegon arsyen

Kafe dhe biskotë, një binom që e shohim kudo. E keni pyetur veten se pse iu ndodh që të doni ëmbëlsirë pas kafesë? Nëse filxhani i kafes dhe ëmbëlsira shkojnë bashkë, është prej faktit se kafeina "nde" dëshirën për sheqer. Është ky pretendimi i një grupi studiuesish amerikan të Cornell University, autorë të një studimi të botuar në revistën shkencore "Journal of Food Science". Studiuesit kujtojnë se kafeina luan rol të rëndësishëm për relaksim dhe nxjerrjen e gjymit, por në të njëjtën kohë bën që të ndihet më pak shija e ëmbël, duke i shtyrë konsumatorët që të kenë më shumë dëshirë për ëmbëlsira. Po ashtu është vënë re se kur kafja shoqërohet me ëmbëlsirë, niveli i kthjelltësisë është më i madh.

## Fiku ul kolesterolin në gjak

Fiqtë janë pjesë tipike e ushqimeve të shëndetshme të Mesdheut. Ata përmbajnë minerale dhe si të tillë konsiderohen si ushqim, i cili ndihmon në parandalimin e sëmundjeve të ditëve të sotme. Një studim i fundit i shkencëtarëve izraelitë tregon për ndikimin e tyre si anti-oksidues në organizmin tonë. Ata me këtë rast kanë zbuluar se fiqtë ndikojnë në uljen e nivelit të kolesterolit dhe kanë ndikim pozitiv në sistemin kardiovaskular. Edhe më herët studime të kryera kanë dëshmuar se fiqtë janë burim i pasur i polifenolit. Madje, fi-

qtë janë më tepër të pasur me polifenol në krahasim me mollët, boronicat, portokajtë, kumbullat, dredhëzat dhe rrushin, madje edhe me verën e zezë dhe çajin. Fiqtë kanë veprim edhe kundër karcinomeve të ndryshme, si atyre të prostatës dhe lëkurës. Ekzistojnë 150 lloje të fiqve, të cilat dallojnë për nga ngjyra dhe jo për nga struktura. Llojet më të njohura janë Mission, Kadota, Calimyrna dhe ai i Adriatikut. Fiqtë janë të pasur me minerale, sidomos me kalcium dhe magnez. Po ashtu janë burim i pasur me fibra ushqyese, të ci-



lat ndihmojnë në uljen e glukozës dhe kolesterolit në gjak. Konsumimi i rregullt i fiqve pa dyshim ndikon pozitivisht në sistemin kardiovaskular dhe punën e zemrës. Polifenoli i pasur me veprim të fuqishëm anti-oksidues mbron lipoproteinat LDL nga oksidimi dhe në këtë mënyrë parandalohet atero-skleroza.

## Sa fëmijë duhet t'i keni për të qenë të lumtur si prindër

Të pasurit një apo dy fëmijë është gjë e cila mund t'ju shtojë lumturinë. Por çfarë nëse e lindni fëmijën e tretë? Jo edhe aq, sipas një studimi të vitit 2014 ku hulumtuesit e kanë matur nivelin lumturisë të prindërve britanikë dhe gjermanë para dhe pas lindjes së fëmijëve të tyre. Kjo nuk do të thotë se fëmijët e tretë, katërt apo pestë dashurohen më pak nga prindërit sesa fëmijët e parë. Por thjesht të qenit prind bëhet paksa rutinore pasi ta keni parë



mrekullinë e lindjes së një jete (dy fëmijët e parë) dhe keni ndërruar qindra pelena.

Gjithashtu, pasi të lindni më shumë se dy fëmijë, shpenzimet financiare do të jenë shumë më të mëdha dhe mund të jetë e papërbalueshme për ju. Një teori tjetër thotë se në familjet e mëdha fëmijët e vegjël mund të jenë të paplanifikuar, dhe kjo mund t'u shkaktojë stres prindërve. Hulumtimet gjithashtu sugjerojnë se aq më të vjetër që jeni kur e lindni fëmijën e parë, aq më të lumtur do të bëheni dhe aq më shumë do t'ju zgjas lumturia.



**DASHI** 21. mars - 20. prill  
Ata që janë në një lidhje do mendojnë t'i çojnë gjerat edhe me tej. Mund të planifikojnë sot fejsa apo edhe martesë. Pritet një periudhë e mrekullueshme. Beqaret do kenë flirte dhe takime me shumicë por që asnjëra nuk do të ketë të ardhme. Neptuni do ua shtojë dëshirën për shpenzime. Do blijnë veshje dhe produkte për plazh. Kujdes mos e kaloni kufirin sepse do ngeleni pa lek.

**DEMI** 21. prill - 21. maj  
Klima për jetën sentimentale ka rrezik të jetë pak e turbullt. Meqë nuk do arrini sot të vendosni qendrueshmeri në çift, mundohuni të pakten të ruani komunikimin. Beqaret duhet të bëjnë durim persë i perket jetës sentimentale. Në të kundërt mund të lidhen me dikë që nuk bën për ta. Do kenë një dëshirë të cmendur për të shpenzuar pa pushim sot.

**BINJAKET** 22. maj - 21. qershor  
Ambienti në jetën në çift do jetë i ngrohtë dhe i mbrojtur nga planetet. Do ndiheni mirë pranë atij që dashuron dhe do flisni hapur për gjithçka. Beqaret duhet t'i njohin mirë personat që do takojnë para se të fillojnë aventura. Është me mirë kështu në menyrë që të mos zhgenjeheni. Menaxhojini me kujdes financat. Të gjitha perpjekjet që do bëni sot do të shperblehen me vonë.

**GAFORRJA** 22. qershor - 22. korrik  
Edhe pse do kenë disa mosmarreveshje të vogla në mënjësi me partnerin tuaj, gjerat do stabilizohen me vonë. Do kaloni edhe disa caste romantike. Beqaret duhet të pranojnë ftesën për të shkuar në një festë. Atje do takojnë persona interesante dhe që ia vlen të krijosh një lidhje. Saturni do favorizojnë financat. Për disa mund të ketë edhe permiresime të ndjeshme.

**LUANI** 23. korrik - 22. gusht  
Sot për ata që janë në një lidhje, do jetë një nga ditet me të bukura dhe me me fat. Mundohuni ta shfrytëzoni sa më shumë të mundni dhe t'i shprehni ndjenjat. Beqaret do kenë fat dhe. Ka shumë gjasa që personi me të cilin të krijoni një lidhje të jetë i shenjës së ujjorit. Në sektorin financave kërkohej me shumë maturi. Mos u tregoni impulsive me shpenzimet sepse do kenë probleme.

**VIRGJERESHA** 23. gusht - 23. shtator  
Nën ndikimin e Marsit do perballeni me disa situata të sikletshme ju që jeni në çift. Gjithsesi mos u shqetësoni sepse do i kaloni pa problem ato dhe në mbremje do të rindizet pasioni. Për beqaret nuk do jetë dite me fat dhe nuk do ketë takime interesante. Ekuilibri buxhetor do të mbrohet. Disa do jenë me të favorizuar dhe do kenë një permiresim të ndjeshëm të të ardhurave.

**PESHORJA** 24. shtator - 23. tetor  
Ju që jeni në çift duhet të perfitonin nga kjo dite e bukur për dashurinë. Qendroni sa më shumë kohë bashkë dhe shkëmbeni puthje pafund. Beqaret do jenë gjithë kohës të rrethuar nga njëzëritë sot, por asnjëri prej tyre nuk do mund t'ua fitojë zemrën. Beni edhe pak durim. Në planin financiar do kenë goxha fat dhe papritur do merrni shumë të konsiderueshme. Perfitonin nga kjo!

**AKREPI** 24. tetor - 22. nëntor  
Sektori i dashurisë do marrë bekimin e yjeve sot. Të gjitha konfliktet do të zgjidhen dhe ju do vendosni baza me të forta në lidhjen tuaj. Për beqaret ka mundësi që një shoqëri e vjetër të kthehet në dicka me tepër. Mos enderroni të pamundurën, por dhe mos e lini këtë mundësi t'iu ike. Mos abuzoni me shpenzimet gjatë kesaj dite. Ruani një ekuilibër që të mos kenë probleme.

**SHIGJETARI** 23. nëntor - 21. dhjetor  
Dite pozitive për jetën tuaj në çift. Edhe ata që kanë qenë larg njëri-tjetrit do të afrohen dhe do e shtojnë bashkëpunimin. Ka ardhur momenti të bëni edhe plane për të ardhmen. Beqaret nuk do jenë të vendosur për të kërkuar personin e duhur. Cdo gjë do jetë në doren tuaj. Sektori i financave do jetë mjaft i qetë. Nuk do kenë probleme dhe mund të bëni ndonjë shpenzim me tepër.

**BRICJAPI** 22. dhjetor - 20. janar  
Gjerat do shkojnë mirë në planin sentimental për çiftet. Kujdes, nese filloni të flisni për cdo gjë tjetër përveç dashurisë ai edhe mund të merzitet. Tregohuni të matur! Beqaret do jenë në medysheje për të ruajtur lirinë apo për të perjetuar emocione të forta duke u lidhur me dikë. Reflektoni me kujdes! Me financat do kenë fat dhe do jeni të mbrojtur. Me në fund do ia plotësoni edhe qejfin vetes.

**UJORI** 21. janar - 19. shkurt  
Jeta juaj në çift do influencohet mjaft nga planetet sot. Ata do iu sjellin gezim dhe emocione. Beni vetëm kujdes që seksualiteti të mos dale mbi ndjenjat. Beqaret nën influencën e Merkurit do tregohen shumë kerkues dhe nuk do bien në dashuri me të parin që do takojnë. Me shpenzimet do tregoheni shumë të kujdesshem. Kjo do e mbajë situatën në ekuilibër.

**PESHQIT** 20. shkurt - 20. mars  
Jeta juaj në çift do jetë shumë e qetë gjatë kesaj dite. Do rivendosni bashkëpunimin dhe gezimi do iu pushtojë. Do jetë një nga ditet që kenë enderruar. Për beqaret do favorizohen dashuritë platonike, por jo ato reale. Prisni edhe pak për të bërë për vetë atë që doni. Në planin financiar do kenë probleme. Tregohuni shumë të kujdesshem dhe mos shpenzoni pa kufi.

PIKË NË KUPËN E QIELLIT, E KUNDËRTA E NADIRIT	E KUNDËRTA E SINTEZËS	VEPËR E AUTORIT NË FOTO	SHKO	E VEÇANTËJA E DALLUESHMËJA VEPRA LETRARE	D
N					
ISH BASKETBOLLISTI GREK, GALIS					
ASTATI			MAQEDONIA VEPËR E AUTORIT NË FOTO		
SHFAROS, ZHDUK (KRAHIN.)					
NJË GJUHË QË FLITET NË BOLIVI					
LËSHOHET TEPOSHTË TRAJNERI GJERMAN, KRISTOF					
D				JODI AUTORI ANGLEZ NË FOTO	
POP MUZIKOR AMERIKAN I '80-AVE (WORD UP)	ISH BASKETBOLLISTI KROAT, DINO ELEKTRODË E POLIT POZITIV				
K					ONOMATOPE E TË QARIT
BOTIM PËR VEPRIM-TARINË E NJË TË SAPOVDEKUR PRODHUES BOZË					
B					FILOZOFI MARKS ARSYE SHKAK
AUTORI ANGLEZ, DANIEL (ROBINZON KRIZO)				SHOQATA AKSIONARE AUTORE AMERIKANE, FERBER	KATËR ROMAK RROGA
ANGSTREMI	FILM I NJOHUR I ANIMUAR (OGRE) "MBRETI" I SHEKSPIRIT				NDAJFOLJE PYETËSE EKIPË
AKTOR AMERIKAN	LAVDËRIMI TINKA KURTI				OKSIGJENI KAMPION
S					
FLOKË TË DREDHUR, KAÇURRELA					PESHA



ZGJIDHJET: D, NADIRI, NIKOS, AT, MK, LËFAR, ITENE, ZBRET, DAUM, J, RAXHA, KAMEO, NEKROLOGJIA, BOZAXHI, KARL, DEFO, SHA, IV, A, SHREK, PSE, LËVDATA, O, STIVEN SIGAL, KRELA, MASA.

**Shumë i lehtë** **Sudoku** **mesatar**

						5	9			9		6		1		8	7
8		1									5				6		
9			1		6		7						7			4	1
			8	3		5	4			5				3			6
					4						3		6		9		
			6	2		8	7			8		4					5
					8		9				8			2			
1		9					5			9		2			1		
5	6									3		6	1		9		7

Shumë i lehtë: 623784159, 871593624, 954126378, 718365492, 235947861, 496218735, 347859216, 189672543, 562431987, Mesatar: 294631587, 715284693, 638975241, 527893416, 143567928, 869412735, 481726359, 972358164, 356149872.



## Njerëzit që flasin dy gjuhë të huaja e përjetojnë kohën ndryshe

Njerëzit që flasin dy gjuhë të huaja janë magjepsës, sepse shpesh herë na bëjnë të mendojmë se në cilën gjuhë mendojnë ata. Në cilën gjuhë ëndërojnë? Në cilën preferojnë të jetojnë përditshmërinë? Sipas studimeve të fundit, njerëzit që flasin dy gjuhë e përjetojnë kohën në një mënyrë tjetër. Një studim i kryer nga Universiteti i Lancaster dhe Universiteti i Stokholmit, kanë ardhur në përfundim se njerëzit që flasin dy gjuhë të huaja mendojnë për kohën ndryshe varësisht nga konteksti gjuhësor në të cilin ata vlerësojnë kohëzgjatjen e ngjarjeve. Përveç kësaj, gjuhë të ndryshme shpesh i referohen kohës ndryshe. Për shembull, folësit në gjuhën suedeze dhe angleze i



referohen distancave fizike, prandaj që flasin gjuhën spanjolle i referohen bëjnë një pushim kur flasim, ndërsa ata vëllimit dhe sasisë fizike



### Qyteti ku mbi 30% e njerëzve i kanë buzët e fryra me injeksion

Kirurgjia plastike është përhapur shumë kohët e fundit. Shumë vajza, por edhe djemtë nuk mbeten mbrapa, zgjedhin të përmirësojnë pamjen e tyre të jashtme përmes ndërhyrjeve plastike. Në këtë formë kanë më shumë besim në vetvete që i bëjnë të ndihen më mirë teksa janë të rrethuar nga njerëzit. Një tjetër kategori e operacioneve plastike janë edhe rastet si psh: zmadhimi i buzëve, i gjoksit apo i të pasmeve. Kur përmendim këto të fundit personi i parë që na vjen ndërmend është Kim Kardashian ose edhe motra e saj e vogël Kylie Jenner. Le t'i harrojmë për një moment ato. E dini cili është vendi ku operacioni plastik, kryesisht fryrja e buzëve është më i kërkuar? Nuk është as LA apo Njy York, por Phoenix, kryeqyteti i Arizonës. Një rezultat vërtetë befases dhe studiuesit nuk e kanë zbuluar ende arsye përse njerëzit më qytetin e shkretëtirës shfaqin kaq shumë interes për ndërhyrjet plastike. Më shumë se 30% e banorëve të Arizonës ishin më të interesuar për injeksionet e buzëve, megjithëse LA dhe San Diego nuk ishin shumë prapa (29.8% dhe 26.3% respektivisht). "RealSelf" gjithashtu publikoi të dhëna që përfshijnë procedurat e tjera të kirurgjisë plastike ku kanë dalë disa rezultate të habitshme. Banorët e Miçiganit nuk pranoni në asnjë mënyrë operacionet plastike, duke treguar diversitetin që kanë amerikanët në përcaktimin e asaj ç'ka është e bukur. Sigurisht këto shifra nuk janë një tregues totalisht i saktë, pasi gjithmonë ka përjashtime, por janë një pasqyrim i përgjithshëm i mendësisë së popujve. Duket sikur rritja e procedurave të kirurgjisë plastike po përhapet kudo me një shpejtësi të madhe.

## Sa orë duhet të flejë një grua shtatzënë?



Nevoja për gjumë në shtatzëni fillon të bëhet e dukshme menjëherë pas rezultatit pozitiv të testit. Nëse ndiheni e lodhur gjatë ditës, duhet të dëgjoni sinjalet e trupit tuaj dhe të shkoni të pushoni. Gjatë shtatzënisë ka edhe shumë gra të cilat vuajnë nga pagjumësia si një faktor natyral, ndërsa disa të tjera nuk mund të flenë si pasojë e angazhimeve të tyre në familje apo punë.

- Për sa orë gjumë ka nevojë një grua shtatzënë? Në shtatzëni trupi nuk ka nevojë për 2-fish kalori apo 2-fish gjumë. Gjëja më korrekte është t'i jepni mundësinë trupit të rekuperojë energjitë e humbura, për

një mirëqenie të përgjithshme. Që ta bëni këtë do të ishin të mjaftueshme rreth 10 orë gjumë.

- Po nëse gruaja ka disa shqetësime? Zakonisht gruaja nuk mund të flejë si pasojë e krampeve, të cilat mund të luftohen duke konsumuar ushqime të pasura me magnez dhe kalium si: kikirikët, bananet, kajsitë e thata dhe peshku. Gjithashtu mund të vuani edhe nga mpirja e duarve. Në këtë rast duhet të hapni dhe mbyllni grushtat ose vendosni duart tuaja në ujë të ngrohtë dhe të ftohtë, pra duke i alternuar. Këto veprime bëhen para gjumit.



## Personat e sjellshëm janë humbës!

Teoria e evolucionit e Darvinit shpesh herë përmbledhet me terma si "mbijetesat e më të fortit", sipas të cilëve disa gjene "egoistë" favorizojnë organizmat e këqij në vend të atyre të mirë. Megjithatë në realitet shumë organizma - përfshirë ata të qenieve njerëzore - mund të mbijetojnë lehtësisht nëse bashkëpunojnë dhe janë altruistë. Disa biologë e kanë studiuar këtë fakt, në dukje ilogjik, falë simulimeve të kompjuterizuar, që krijojnë grupe virtuale organizmash në gjendje të shfrytëzojnë strategji të ndryshme bashkëpunuese. Pasi këta grupe janë shumëfishuar për mijëra breza sipas ligje-

ve të "luftës darviniane", biologët kanë vërejtur nivelin e përparimit të bërë. Rezultatet konfirmojnë që është më e mundur që organizmat bashkëpunues të mbijetojnë, se sa ata egoistë, por vetëm nëse përftojnë edhe disa karakteristika të tjera. Për shembull, duhet të jenë edhe të gatshëm të besojnë tek të tjerët, edhe të falin në raste të caktuar, por në të njëjtën kohë duhet të jenë edhe të gatshëm të kundërsulmojnë, nëse është e nevojshme. Megjithatë, studimi tregon gjithashtu që as edhe shoqëritë "e të mirëve" nuk zgjasin përgjithmonë: ndonjëherë janë pikërisht "egoistët" që dominojnë.

524 - Beteja e Vezeroncës: Frankët mundin Burgundët.

1096 - Masakra e Kryqëzatës së I ndaj hebrenjve të Uerelangen në Gjermani.

1607 - Perandori i sëmurë mental Rudolf II nënshkruan Traktatin e Libenit duke dhënë Austrinë, Hungarinë dhe Moravinë.

1638 - Eklipsa e hënës është ngjarja e parë astronomike e regjistruar në Amerikë.

1667 - Dr Zhan Baptist Danjes, doktor francez, realizon transfuzionin e parë të gjakut.

1678 - Elena Kornaro Piskopia është gruaja e parë që i jepet doktrata për filozofi.

1905 - Varshava dhe Lozhi shprehin revoltën kundër okupimit rus.

1916 - Cari Nikolla II largon ministrin e punëve të jashtme, Sazonov.

1918 - Formohet partia komuniste turke - Baku

1940 - Adolf Hitler viziton Kullën e Ajfelit dhe varrin e Napoleonit në Francë.

1941 - Finlanda i shpall luftë Bashkimit Sovjetik

1949 - Zgjedhjet presidenciale në Siri (disa grave u lejohet të votojnë).

1950 - Fillon konflikti korean: Korea e Veriut pushton Korenë e Jugut.

1960 - Madagaskari fiton pavarësinë nga Franca.

1967 - Muhammed Ali dënohet me 5 vjet burg.

1991 - Sllovenia dhe Kroacia shpallin pavarësinë nga Jugosllavia.

E keni dëgjuar shumë herë, se kush tradhton njëherë mbetet përherë tradhtar. Ka të vërtetë nga kjo. Sipas një studimi të kryer në Universitetin e Denverit, ku pjesëmarrës kanë qenë 484 njerëz, 68 për qind prej tyre kanë qenë gra, e që janë pyetur për se paku dy romanca të ndryshme. Nga të gjithë pjesëmarrësit në studim, 44 për qind e tyre kanë thënë se kanë pasur marrëdhënie seksuale me dikë jashtë lidhjes që kanë pasur. Sipas studimit ka dalë që njerëzit që tradhtojnë partnerin një herë janë të prirur që deri tri herë më shumë ta përsërisin atë edhe herëve të tjera.



### PSE PO GËNJEN?

Gruaja: Pse po gënjën, ti ishe duke shkuar 70 km/h.

Burri: Mojt ti, mos fol!

Polici: Po ju s'keni vënë as rripin e sigurisë.

Burri: Por unë e hoqa tani, pasi më ndalua ju.

Gruaja: Prapë po gënjën ti, rripin nuk e kishe.

Burri: Mbylle gojën.

Polici: Gjithmonë flet ky me ju kështu?

Gruaja: Jo jo, vetëm kur është i dehur!



Arsyeja pse e quajnë "Ëndrra amerikane" është se duhet të jesh në gjumë ta besosh.

(Xhorxh Karlin)